



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

MIRATOHET

~~KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT~~
~~Z. EDI RAMA~~

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

Z. DAMIAN GJIKNURI

Kryetar i Këshillit Bashkiak

Z. Pjetër Pjetër

Miratur me Vendim të Këshillit Bashkiak
Nr. 50 Datë 20.04.2018

Kryetar i Bashkisë

Z. Ndoc Dedaj

PLANI I PËRGJITHSHËM VENDOR I BASHKISË MIRDITË

STRATEGJIA TERRITORIALE

Miratur me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 2, Datë 20.06.2018

DPKZHT: Z. Altin Marashi

KONSULENT "GAIA S.A. MELETON", Dimitrios Mamounis, Nr. Liç.554





Small dark smudge or mark at the bottom left corner.

TABELA E PËRMBAJTJES

HYRJE	3
1. STRATEGJIA TERRITORIALE	5
1.1. Udhëzime të detyrueshme dhe dispozita	5
1.2. Rezultatet nga konsultim publik	8
1.3. Analiza e metabolizmit dhe vlerësimi i përgjithshëm i territorit të njësisë	11
1.4. Përcaktimi i territorit sipas pesë sistemeve	33
1.5. Identifikimi i nevojave, potenciali dhe kufizimet	37
1.6. Vizioni i Zhvillimit dhe Strategjia Territoriale	43
1.6.1. Vizioni i zhvillimit	43
1.6.2. Strategjia e Zhvillimit dhe Objektivat	44
1.6.3. Parimet dhe politikat kryesore për çdo sistem.....	49
1.6.4. Parashikime demografike.....	57
1.6.5. Rezervat e strehimit.....	65
1.6.6. Parashikimet financiare	80
1.6.7. Struktura e ndërtimeve	91
1.6.8. Niveli i cilësisë së mjedisit.....	94
1.7. Ndryshimete mundshme të sistemeve	98
2. PLANI I VEPRIMEVE STRATEGJIKE/ PRIORITARE DHE PROJEKTET PILOT TË ZHVILLIMIT	101
2.1. Plani i Veprimit	101
2.2. Projekte prioritare / Pilote të zhvillimit	126
REFERENCAT	163
ANEKS	164
1. Konsultimi me grupet e interesit dhe aktorë të ndryshëm	165
2. Këshillimi publik e dytë	169
3. Konsultimi me biznset e Bashkisë Mirditë	177
4. Takim e Forumit të Bashkëndimit të Planifikimit Vendor (FBPV)	180
5. Treguesit e monitorimit dhe vlerësimit	183





HYRJE

Ky material paraqet raportin teknik për Fazën e II-të të studimit "**Hartimi i Planit të Përgjithshëm Vendor për Bashkitë Mirditë**", i cili u rishikua në bazë të shkresës me nr. prot. 1185/02/8.11.2017 të AKPT mbi "Raportin e Vlerësimit Teknik të Dokumenteve të Fazës II". Pikërisht paraqet Dokumentin e Strategjisë Territoriale së Zhvillimit, i cili është qasja e parë fiziko-hapësinore me Planin e Përgjithshëm Vendor (PPV) të kësaj bashkie, si shprehja më e lartë e planifikimit të territorit, që pasqyron përparësi e qëllime strategjike, objektiva, mjete e rezultate të pritshme, për të orientuar, drejtuar dhe nxitur proceset e mëtejshme të planifikimit të territorit. Në këtë fazë është hartuar Strategjia Territoriale e Bashkisë Mirditë, ku përfshihen vizioni i zhvillimit të Bashkisë për vitin 2032, objektivat strategjike, akset prioritare, si edhe plani i veprimit me projektet e propozuara për Bashkinë.

Për studimin "**Hartimi i Planit të Përgjithshëm Vendor për Bashkitë: MIRDITË, PUKË**", u nënshkrua një kontratë më 04-07-2017 ndërmjet Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe GAIA SA, ndërsa, në të njëjtën kohë, u nënshkrua marrëveshja trepalëshe ndërmjet Ministrisë së Zhvillimit Urban, Bashkisë Mirditë dhe kompanisë GAIA SH.A. STUDIME, më 06-07-2017.

Pas nënshkrimit të kontratës, u realizua takimi për fillimin e procesit të hartimit të Planit të Përgjithshëm, ditën e Enjte, më 06.07.2017, ku edhe u prezantuan pikat kyçe dhe hapat për përgatitjen, analiza e tendencave të zhvillimit në vitet e fundit në të dhënat sociale, ekonomike e demografike të mbledhura në fazat e parë, u analizuan rolet e të gjitha palëve të përfshira dhe u hartua dokumenti strategjik thelbësor që udhëzon zhvillimin fiziko hapësinor të njësisë së qeverisjes vendore dhe shërben si bazë për zhvillimin e Planit të Përgjithshëm Vendor. Në kuadër të takimit hapës, u realizua takimi i parë njohës ndërmjet kryetari të Bashkisë Ndrec Dedaj dhe stafit të saj, z. Altin Marashi (Drejtor i Urbanistikës), znj. Adelina Dukaj (urbaniste e qytetit) dhe z. Blenard Dudi (GIS ekspert), me përfaqësuesit e studiuesve të Shoqërisë GAIA SH.A. STUDIME. Në vazhdim, filluan punimet për grumbullimin dhe analizën e të dhënave. Faza A u prezantua më 15 Shtator 2017 në një konsultim publik të organizuar në Rrëshen dhe u dorëzua më 18 Shtator 2017. Në këtë Fazë B, e cila është faza e vlerësimit të rezultateve të analizave, identifikohen problemet dhe mundësitë e zonës së studimit dhe bëhen disa parashikime të popullsisë, si edhe parashikime ekonomike për një periudhë kohore të 15 viteve të ardhshme. Qëllimi i kësaj faze është hartimi i planit të veprimit të bashkisë dhe programet kryesore pilote të zhvillimit, me qëllim përmbushjen e vizionit të zhvillimit dhe strategjisë së bashkisë.

Në këtë pikë dëshirojmë të falënderojmë kryetarin e Bashkisë së Mirditë z. Ndrec Dedaj për bashkëpunimin dhe sigurimin e informacionit të nevojshëm për vizionin e qytetit.

Gjithashtu, do të donim të falënderonim të gjithë stafin e Bashkisë, z. Pjetër Pjetri Kryetar i Këshillit Bashkiak, z. Mëhill Paçuku, Ing. dhe N/Kryetari i Bashkisë,



Altin Marashi, Ing. dhe Drejtor i PZHTS, z. Alban Marku, Arkitektin Specialist i DPZHTS, z. Klajdi Dodaj, Ing Specialist i Kadastrës, z. Gjovalin Nikolli, Ing. Përgjegjës Sektori për Pyjet, z. Gjok Vuka, Administrator i Njesisë Administrative Rrëshen, z. Malvina Marku, Juriste në DPZHTS dhe në veçanti z. Blenard Dudi, Ing. Specialist GIS në DPZHTS, mbikëqyrës i studimit në emër të Bashkisë, me të cilët kemi pasur një komunikim të vazhdueshëm, bashkëpunim dhe shkëmbim të të dhënave dhe pikëpamjeve përgjatë Fazës A dhe Fazës B

Gjatë gjithë zhvillimit të përgatitjes së Fazës A dhe B të studimit, kishte një bashkëpunim të plotë dhe komunikim të dyanshëm me AKPT dhe z. Taulant Dano dhe z. Ermal Pashollari, të cilët janë mbikëqyrësit e përgjithshme dhe koordinorët e planit «Hartimi i Planit të Përgjithshëm Vendor për bashkitë: MIRDITË, PUKË», të cilin do të dëshironim ta falënderonim për kontributin e tij të rëndësishëm në hartimin e Fazës A dhe B të studimit.

Së fundi, do të donim të falënderonim të gjithë anëtarët e Grupit të Studimit GAIA SH.A. STUDIME dhe veçanërisht partnerët vendorë:

znj. Diana Bardhi, Inxhinierë Civile, Udhëheqëse e Ekipit, Zyra Vendore e Tiranës

znj. Borianë Golgota, Arkitekte & Urbaniste, Zyra Vendore e Tiranës

z. Elton Toska, Arkitekt, Koordinator i të gjitha Ekipëve Vendore në bashkitë Pukë dhe Mirditë

znj. Etmira Kanani, Eksperte Ligjore



1. STRATEGJIA TERRITORIALE

1.1. Udhëzime të detyrueshme dhe dispozita

PROJEKTET KOMBËTARE

Legjislacioni kombëtar urban, konkretisht Ligji nr. 107, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” parashikon materializimin e Planit të Përgjithshëm Kombëtar (PPK), Planeve Kombëtare Sektoriale (PKS) për të gjithë territorin kombëtar ose pjesëve të tij dhe të Planeve të Detajuara për Zona me Rëndësi Kombëtare (PDZRK), si mjete bazë të planifikimit hapësinor kombëtar.

Në kuadër të zhvillimit të qëndrueshëm dhe të integruar të Bashkisë, objektivat dhe politikat strategjike bazohen në udhëzimet e detyrueshme të parashikuara nga Plani Kombëtar i Rregullimit të Territorit. Në veçanti, rëndësia e tij analizohet në nivel politik, institucional dhe ekonomik, përfitimet e shumta (ekonomike, sociale dhe mjedisore) nëpërmjet qëllimeve të mëposhtme:

- Promovimi i kohezionit territorial përmes zhvillimit të balancuar ekonomik dhe social të rajoneve dhe përmirësim të konkurrencës.
- Nxitje e zhvillimit të gjeneruar nga funksionet e përziera urbane dhe përmirësimi i marrëdhënieve midis zonave urbane dhe rurale.
- Promovim të aksesit.
- Përmirësimi i aksesit me njohuritë dhe informacionin
- Reduktimi i ndikimit negative ndaj mjedisit Mbrojtja e burimeve natyrore dhe kulturore.
- Forcimi i trashëgimisë kulturore si faktor i zhvillimit.
- Zhvillimi i burimeve të energjisë duke ruajtur, paralelisht, sigurinë e energjisë.
- Promovimi i cilësisë dhe turizmit të qëndrueshëm.
- Ulja e ndikimit të fatkeqësive natyrore.

PPK identifikon pesë sistemet territoriale me objektivat specifike dhe politikat, të cilat janë të organizuara veçmas me ndihmën e qendrave, akseve dhe zonave. Bëhet fjalë për sistemin urban, sistemin agrar, sistemin natyror, sistemin hidrik dhe sistemin e infrastrukturës.

Për sa i përket **sistemit urban**, propozohet konsolidimi dhe zhvillimi policentrik i sistemit urban, i cili do të largojë përjashtimet dhe do të zbusë pabarazitë. Promovohen, gjithashtu rajonet e fuqishme që komunikojnë me njëri-tjetrin dhe kanë marrëdhënie plotësuese.

Për sa i përket **sistemit bujqësor**, propozohen politika për mbrojtjen e tokës bujqësore ndaj zhvillimit urban. Objektivi kryesor është rritja e efikasitetit dhe produktivitetit të një sektori të prodhimit bujqësor. Kjo duhet të arrihet përmes politikave të mëposhtme të PPK: ruajtje, stabilizim (konsolidim), modernizim.



Në të njëjtin kontekst, është parashikuar mbrojtja dhe promovimi i **sistemi natyror** me prezantimin e duhur të tij.

Me rëndësi të veçantë gjykohet **sistemi ujqor**, në lidhje me të cilën identifikohen disa dobësi dhe probleme që lidhen me çështje të caktuara: (a) të menaxhimit, (b) sasisë së burimeve ujore, (c) cilësinë e burimeve ujore, (ç) ndotjen nga burime të ndryshme. Në dritën e këtyre çështjeve, në PPK janë përcaktuar rekomandimet përkatëse si përdorimi racional i ujit, kontrollin e aktiviteteve ilegale, koordinimi dhe bashkëpunimi midis shërbimeve lokale, rajonale dhe qendrore, përmirësimi i kuadrit institucional për monitorimin, menaxhimin e qëndrueshëm të ujërave nëntokësore, duke përfshirë puset, kontrollin dhe shfrytëzimin e ujërave të shiut, investimet në kërkime dhe njohuritë e resurseve ujore.

Në lidhje me **sistemin infrastrukturor**, objektivi i PPK është mbështetja e zhvillimit të integruar të rrjeteve të infrastrukturës që përbëhen nga transporti, energjia dhe komunikacioni. Me fjalë të tjera, gjykohet zhvillimi i një sistemi transporti multimodal, të integruar dhe miqësor me mjedisin, i cili do të sigurojë lidhjen dhe aksesin në nivel kombëtar, do të zhvillojë lidhjen ndërkufitare, do të promovojë transportin publik dhe mjetet alternative për të lidhurakset rrugore drejt zhvillimit të rrugëve turistike dhe historike.

Për sa i përket Bashkisë për të cilënpo hartohet studimi, bazuar në hartat e PPK, ajo ka një pozicion kyç në lidhje me zhvillimin e rrjeteve energjetike, pasi përshkohet nga linjat ekzistuese të transmetimit të energjisë të llojeve të ndryshme si edhe nga gazësjellësi i propozuar i gazit natyror IAP-Kosovë. Gjithashtu, është një zonë me rezerva të shumta të mineralit të bakrit dhe minerale jo-metalike. Referohet si qendër e nivelit kombëtar për zhvillimin e industrisë përpunuese (është një midis njëmbëdhjet të tillave në total). Së fundi, konstatohet se nuk është rajon me prioritet të zhvillimit të energjisë së rinovueshme, por ndërkohë disponon potencial për prodhimin e energjinë eolike dhe energjisë nga biomasa.

Zona e studimit është pjesë e zonës së veçantë të zhvillimit Pukë - Mirditë - Fushë Arrëz. Tipare të rëndësishme të kësaj zone janë nxjerrja e mineraleve dhe përpunimi i tyre, zhvillimi i industrisë përkatëse dhe teknologjisë. Në veçanti, ka rezerva të konsiderueshme të bakrit në pjesën veriore të Bashkisë Mirditë, në lindje të Bashkisë Pukë dhe në Bashkinë Fushë Arrëz, dy miniera në Lakrosh dhe Munellë, si edhe uzinën e pasurimit të bakrit. Minierat e bakrit kanë një ndikim të drejtpërdrejtë negativ në lumenj, për këtë arsye, duhet të merre, masa për rehabilitimin dhe minimizimin e ndotjes. Përveç kësaj, rajoni disponon elementë natyrorë dhe peizazhe të cilat duhet të ruhen dhe zhvillohen më tej. Ka mundësi për prodhimin dhe kultivimin e lajthisë, arrave dhe gështenjave, dhe për këtë arsye ka nevojë për forcimin e një zinxhiri të integruar të prodhimit: kultivim-mbledhje-përpunim.

Gjithashtu, ndodhet në zonën e menjëhershme të ndikimit të polit Shkodër-Lezhë, i cili shërben si porta perëndimore e rajonit maloro verior të vendit. Prioritet përbën përmirësimi i lidhjes së tij me këtë dipol - portë hyrëse e vendit dhe promovimi i bashkëpunimit të tyre. Është e rëndësishme afërsia e bashkisë me dy zona



ndërkufitare të bashkëpunimit që përfshijnë edhe nyje multimodale të transportit ndërkombëtar: Kukës-Prishtinë dhe Shkodër-Podgoricë. Aks kryesor i zhvillimit është rruga kryesore me rëndësi kombëtare/ndërkombëtare E851 (Rruga e Kombit), e cila do të bëhet një aks i integruar i infrastrukturës dhe i përket rrjetit kryesor rrugor kombëtar, që lidh Shqipërinë me Kosovën dhe bën pjesë në rrjetet trans-evropiane. Ky aks duhet të përmirësohet nga ndërtimi i një terminali me synimin për të përmirësuar transportin publik të njerëzve dhe mallrave. Krahas tij pritet të ndërtohet dega kryesore e rrjetit hekurudhor me drejtim nga Kukësi në Kosovë, si edhe degë që do të lidhin Rrëshenin me Klosin. Gjithashtu, në një zonë më të gjerë të tij do të kalojë tubacioni i gazit IAP Kosovë. Pranë tij do të gjendet selia e Bashkisë e cila është një qendër e nivelit të tretë bazuar në hierarkinë e rrjetit kombëtar të vendbanimeve, si edhe Rubiku i cili është një qendër e kualifikuar lokale, një epiqendër e zhvillimit të industrisë dhe përpunimit. Për forcimin e Rubikut propozohet rigjallërimi i zonës industriale dhe ndërtimi i stacionit të mallrave dhe lidhja e tij me vijën hekurudhore Durrës-Kukës. Gjithashtu, krijohet edhe një aks i dytë i një zhvillimi të butë me drejtim Veri-Jug përmes rrugëve më peizazheve të bukura natyrore dhe krijimi i rrugëve për biçikleta, të cilat do të lidhin bashkinë me Bashkitë Pukë dhe Mat duke krijuar një qasje drejtburime të reja dhe destinacioneve. Për më tepër, forcimi i bashkëpunimit me bashkitë fqinje dhe kryesisht me Bashkinë Pukë, Mat, Fushë Arrëz dhe Kukës është një përparësi për PPK.

Vlen të theksohet se planet e aprovuara kombëtare sektoriale (**Plani i Integruar Ndërsektorial i Bregdetit, Plani i Integruar Ndërsektorial**), si edhe **Plani Sektorial Kombëtar i Turizmit për Alpet**, i cili është në proces miratimi, nuk kanë ndikim në zonën e studimit.

PROJEKTET RAJONALE DHE LOKALE

Më poshtë janë përfshirë dhe po paraqiten të gjitha drejtimet nga planet rajonale që prekin dhe ndikojnë zonën e studimit.

“Plani Rajonal i Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave për Qarkun e Lezhës”, i hartuar në vitin 2009 nga Këshilli i Qarkut Lezhë, në kuadër të zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin e Pyjeve dhe Kullotave në Shqipëri, propozon masa për të luftuar ilegalitetin e gjuetisë dhe parandalimin e zjarreve në pyje.

“Koncepti Strategjik i Zhvillimit Rajonal, Qarku i Lezhës”, i hartuar në vitin 2010 si një bashkëpunim Bashkisë Lezhë dhe GTZ, përqendrohet në sipërmarrjen e sektorit primar (agrobiznesin), në turizëm dhe infrastrukturë. Zhvillimi i turizmit dhe promovimi i trashëgimisë kulturore mund të arrihet përmes një sërë projektesh dhe veprimesh, si për shembull përmirësimi dhe rindërtimi i muzeut të Rrëshenit, krijimi i objekteve informative dhe informacioni për vizitorët dhe promovimi i prodhimeve vendore.

“Skenarët e Zhvillimit Nënrajonal në Qarkun Shkodër” (2015) i japin përparësi edukimit (krijimit të potencialit të fuqisë punëtore të kualifikuar), infrastrukturës dhe shërbimeve, turizmit, agroindustrisë dhe mbrojtjes nga përmytjet. Konsideron si



shtylla zhvillimi në rajon sektorin bujqësor (bujqësi dhe blegtori), turizmi dhe industria.

Në veçanti, për aksin e parë, propozohet shtimi i sipërfaqeve të kultivuara, marketingu i produkteve kryesore (si vera), informimi i fermerëve, krijimi i infrastrukturës adekuate për mbështetjen e zinxhirit të prodhimit dhe mbrojtjen e biodiversitetit.

Për turizmin, Bashkia e Mirditës është nënrajoni i bukurive të natyrës, por jo vetëm, dhe theksi vihet në: (a) projektimin dhe promovimin e të gjitha peizazheve (si Kroi i Bardhë, shpella karstike në Kthellë, Kulla, Burgu i Spaçit), duke u fokusuar dhe në ekoturizëm si edhe) krijimin e rrugëtimeve/monopateve të organizuara (p.sh. për këmbësorë dhe biçikleta).

Në lidhje me industrinë, Bashkia përbën një nga dy nën-zonat ku propozohet ripërdorimi i zonave të braktisura industriale dhe zonave të minierave, adresimi i problemeve mjedisore të shkaktuara nga aktiviteti i mëparshëm, menaxhimi i mbeturinave minerare dhe mbrojtja e ujërave nëntokësore.

1.2. Rezultatet nga konsultim publik

Gjatë fazës A' të studimit dhe në një periudhë kohore shumë pranë përfundimit të fazes A, në Bashkinë e Mirditës u zhvillua një konsultim publik, në datë 15 Shtator 2017, për të paraqitur, tek grupet e interesit, rezultatet e kësaj faze. Përveç konsultimit, u shpërndanë pyetësorë tek të pranishmit me qëllimin që secili të përfshihej në këtë proces dukeshprehur pikëpamjet dhe sugjerimet e tyre në lidhje me studimin, si edhe për të listuar problemet më të rëndësishme që ata mund të kenë identifikuar në bashkinë e tyre dhe që nuk ishin përmendur në këtë konsultim të hapur për publikun. Në total janë plotësuar 25 pyetësorë. Pyetësorët përbëheshin nga 11 pyetje të hapura, kryesisht që kanë lidhje me mundësitë për zhvillim ekonomik si edhe pikat e dobëta të Bashkisë. Nga pyetësorët rezultuan konkluzionet e mëposhtme, të cilat japin një pamje më të përgjithshme se si publiku në këtë bashki, grupet e ndryshme të interesit dhe palë të tjera të interesuara e shohin dhe do ta donin Bashkinë, por për shkak se numri i pyetësorëve ishte i vogël, nuk mund të arrijmë të japim konkluzion sasiorë.

Nga pyetja e parë, në lidhje me fushat në të cilat bazohet zhvillimi ekonomik, shumica e të anketuarve janë përgjigjur për sektorin e bujqësisë, blegtorisë, turizmit, tregtisë dhe shërbimeve. Është po aq e rëndësishme dhe fusha e zhvillimit të ekonomisë, kontributi i infrastrukturës së duhur në këtë zhvillim, si edhe përdorimi i mirë i burimeve natyrore të rajonit. Megjithatë, referuar pyetjes, se cilët sektorë do të kishin dëshirë të zhvillohen më tepër, përgjigjet janë të ngjashme. Shumica e të anketuarve iu referua edhe një herë bujqësisë, duke theksuar hortikulturën, vreshtarinë, blegtorinë dhe shërbimet. Përveç kësaj, ata referuan zhvillimin e fushave të industrisë dhe minierave. Së fundi, ata theksuan se do të ishte i mundur që të



zhvilloheshin edhe infrastruktura teknike dhe sociale (transportet, kanalizimet, furnizimin me ujë, sportet, arsimit).

Në pyetjen për problemet më të rëndësishme të bashkisë, shumica e tyre konsiderojnë probleme kryesore atë të rrjetit të infrastrukturës, veçanërisht rrjetin rrugor. Në përgjithësi, ata i referohen autostradës së Reps-it që nuk është e asfaltuar dhe nuk ka hyrje të sigurt lidhëse me bashkinë. Përveç infrastrukturës së transportit, ato gjithashtu i referohen infrastrukturave tjera të tilla si ato të ujësjellësit, ujitjes etj. Probleme të tjera - gjithëpërfshirëse të rajonit, siç janë papunësia, ndotja e mjedisit dhe problemet që krijohen në ekosisteme, si dhe në sektorin e bujqësisë për shkak të ekzistencës së hidrocentraleve, mungesa e fondeve për menaxhimin e pyjeve të bashkisë. Përveç kësaj, rreziku për zonën konsiderohet ndërtimi arbitrar dhe mungesa e studimeve të duhura. Së fundi, ata përmendën mungesën e informimit dhe informacionit dhe marketingun e pamjaftueshëm që nuk promovon bashkinë.

Në lidhje me veprimet e reja që pritet të zbatohen në 5-10 vitet e ardhshme dhe që lidhen me shërbimin e palëve të interesuara, shumica janë përgjigjur për rritjen e investimeve. Investimet lidhen me infrastrukturën për shkollat, qendrat shëndetësore, banesat sociale, shërbimet publike, asfaltimin dhe ndërtimin e rrugëve të reja si në qendrat urbane ashtu edhe në fshatrat e largëta; Në vitet e ardhshme, rajoni gjithashtu duhet të kryejë studime mbi zhvillimin urban dhe rajonal në mënyrë që të ndjekë parimet e zhvillimit të qëndrueshëm. Një detyrë e rëndësishme është mbrojtja dhe rritja e pasurisë natyrore të zonës dhe promovimi i përgjithshëm i vendeve me interes turistik. Veprime të mëtejshme që dëshirojnë të zbatohen kanë të bëjnë me përmirësimin e arsimit në të gjitha nivelet, duke u kujdesur për grupet e ndryshme shoqërore siç janë personat me aftësi të kufizuar.

Këto projekte konsiderohen të nevojshme pasi ato do të ndikojnë pozitivisht në zhvillimin ekonomik të Bashkisë nëpërmjet zhvillimit të sektorëve të turizmit, tregtisë dhe bujqësisë. Kjo do të zvogëlojë papunësinë, do të rrisë të ardhurat dhe mirëqenien e banorëve, ndërkohë që do të dëshmojë për ekzistencën e stimujve për kthimin e atyre që janë larguar nga rajoni. Për zhvillimin ekonomik të rajonit, është e domosdoshme promovimi i prodhimeve vendore dhe rritja e turizmit, fakt ky që pritet të realizohet nga projektet që do të zhvillohen në 5-10 vitet e ardhshme.

Përveç zhvillimit ekonomik, projektet e përmendura më lart, do të ndikojnë pozitivisht në mjedisin e bashkisë. Të anketuarit u ftuan ti përgjigjen pyetjes se në cilën mënyrë do të ndikohet pozitivisht mjedisi i bashkisë. Në përgjigjet e tyre ata i referohen faktit të uljes së migrimit në qendrat e mëdha urbane, rritjes së të ardhurave që lidhen me tregtinë, përmirësimin e bujqësisë përmes shfrytëzimit më të mirë të tokës bujqësore që do të sjellë më tej rritjen e produkteve bujqësore, gjithashtu theksuan reduktimin e numrit të ndërtimeve të paligjshme, rritjen e punësimit etj.

Pyetjes se me cilën mënyrë ata besojnë se studimi PPV do të ndikojë në mjedis, shumica prej tyre kanë thënë se përmirësimi i rrjeteve të infrastrukturës dhe veçanërisht furnizimi me ujë (shërbimi cilësor për ujin e pijshëm), si edhe sigurimi i sistemit të ujitjes dhe trajtimit të mbetjeve të ngurta, do të kenë ndikime pozitive të



mjedisin. Përveç kësaj, ata listuan infrastrukturën e transportit dhe efektet pozitive në mjedis nga përmirësimi i rrjetit rrugor (mbrojtja më e mirë e mjedisit, mjedisi më i pastër, ulja e rreziqeve të tilla natyrore si zjarri, etj.) Ndërmjet efekteve pozitive që u përmendën më lart, përfshihet edhe rritja e produkteve bujqësore dhe përmirësimi i cilësisë së produkteve ushqimore, rritja e mirëqenies së banorëve të bashkisë. Së fundmi, ata iu referuan veprimeve specifike për mjedisin, siç janë ripyllëzimi i zonave të djegura, kultivimi i drurëve frutore, zgjerimi i sipërfaqeve të gjelbra dhe mbrojtja e burimeve natyrore si pyjet dhe uji.

Pyetja tjetër epyetësorit ishte rëndësia e objektivit kryesor mjedisor. Përgjigjet ishin të shumta, të ndryshme dhe gjithashtu po aq të rëndësishme. Të anketuarit përmendën identifikimin, njohjen e zonave të mbrojtura, rritjen e sipërfaqeve të gjelbra dhe mbrojtjen e tyre, rritjen e mbrojtjes së pyjeve nga rreziqet natyrore, zjarri, etj, mbrojtjen e tokës nga erozioni, penalizimin e atyre që nuk e respektojnë mjedisin por e dëmtojnë atë, përmendën gjithashtu edhe ripyllëzimin. Gjithashtu, ata propozuan ndërtimin e digave, mbrojtjen e lumit Fan, të mos ndërtohen më hidrocentrale dhe të ndërmerren studime me natyrë tekniko-ekonomike me qëllim identifikimin e zonat e rrezikshme të bashkisë. Së fundmi, duhet të ketë informim të nevojshëm dhe ndërgjegjësim të banorëve të bashkisë, lidhur me shërbimet e mbeturinave, ndarjen dhe trajtimin e tyre në nivel bashkie (riciklim).

Në vazhdim ata u pyetën për problemet e bashkisë të cilat janë të përbashkëta me bashkitë fqinje, si edhe për mënyrat e zgjidhjes së tyre. Për problemet e përbashkëta midis bashkive fqinje u raportuan: menaxhimi mbeturinave të ngurta, menaxhimi i mjedisit, krijimi i hapësirave të gjelbra, papunësia, çështje të zhvillimit ekonomik, hapja e rrugëve që lidhin vendbanimet e largëta, përmirësimi i transportit publik, përcaktimi më i mirë i kufijve administrativë të bashkisë. Si zgjidhje kryesore për të trajtuar problemet e përbashkëta konsiderohet konsultimi i mirë dhe bashkëpunimi midis bashkive, gjetja e veprimeve të përbashkëta për të adresuar rreziqe të caktuara, mbrojtjen e mjedisit dhe të burimeve ujore nga ndotja dhe krijimi i rrugëve ndër-bashkiake.

Pyetja e dhjetë lidhej me infrastrukturën, të cilën ata e konsiderojnë të rëndësishme dhe të nevojshme për bashkinë. Siç u përmend më lart, ka nevojë për përmirësim e rrjetit rrugor, sistemit të ujësjellësit, kanalizimit dhe ai i ujitjes. Përveç kësaj, nevojitet infrastrukturë në fushat e arsimit (shkolla) dhe shëndetësisë (qendra shëndetësore). Gjithashtu, ekziston nevoja për të kryer studime të ndryshme për pyjet, bujqësinë, ujitjen. Duhet të ekzistojnë mekanizma kontrolli në të gjitha fushat, të ketë specialistë në bashki në lidhje me shërbimet sociale dhe të ketë kushte të mira pune për nëpunësit civilë.

Në fund, atyre iu kërkua që të shkruanin çdo informacion të rëndësishëm që ata besonin se nuk ishte përfshirë në pyetjet e mësipërme të pyetsorit. Në këtë informacion të marr nga pyetsorët u prezantua mungesa e kontrollave në lidhje me ushqimin, kafshët, bimët, me kontrollin e përdorimit të pesticideve tek bimët, monitorim i vazhdueshëm të sistemit arsimor, u përmend strehimi, punësimi,



shërbimet sociale, tregtia e produkteve organike. Ata besojnë se duhet të ketë pjesëmarrje të komunitetit në vendimarrjen e Bashkisë, të realizohet një plan urbanistik për rajonin dhe të ketë një plan për zhvillimin ekonomik. Së fundi, ata përmendën fondet që u nevojiten fermerëve, bujqve dhe blegtorëve si një mjet për subvencionimin e tyre.

1.3. Analiza e metabolizmit dhe vlerësimi i përgjithshëm i territorit të njësisë

Të përgjithshme

Sipas VKM 671/2015, metabolizmi i një zone është modeli teorik që e trajton qytetin si një ekosistem, dmth, konsiderohet se qyteti ka një strukturë dhe funksion të ngjashëm me atë të ekosistemeve natyrore. Sipas këtij paralelizmi, qyteti i shndërron (metabolizon) lëndët e para (p. sh. ujin, karburantin) dhe prodhon emetime, ndotjeje dhe mbetje. Për herë të parë si përkufizim i metabolizmit urban u përcaktua "totali i materialeve dhe të mirave materiale që nevojiten për mbajtjen e banorëve të një qytetit në shtëpi, në punë dhe në argëtim"¹. Përkufizimi i mëvonshëm thotë se është "shuma totale e proceseve teknike dhe socio-ekonomike që realizohen në qytete dhe proceset janë përgjegjëse për zhvillimin, prodhimin e energjisë dhe realizimin e mbetjeve" (Kennedy et al., 2007).² Metabolizmi bazohet në identifikimin dhe analizën e proceseve që ndodhin nëpërmjet inputeve dhe outputeve të energjisë dhe burimeve brenda kufijve të qytetit, përmes ndërveprimit të natyrës dhe shoqërisë, të qytetit dhe të fshatit. Objektivi është që kuptueshmëria e sjelljes sezonës së studimit dhe përshtatja e saj në një bazë më të qëndrueshme. Rezultatet që dalin janë veçanërisht të dobishme për formulimin e strategjive të qëndrueshme, planeve dhe politikave.

Për analizën e metabolizmit urban janë zhvilluar ndërkombëtarisht metoda dhe mjete të ndryshme (p.sh. metoda e monitorimit urban të integruar (IUME), metoda e gjurmës ekologjike, etj). Tipar i përbashkët i të gjitha metodave është që të dhënat sasiore janë me rëndësi jetike, duhet të raportohen në shkallë të përshtatshme. Nga kërkimi i kryer në zonën e studimit, u konstatua se diçka e tillë nuk është e realizueshme. Të dhënat statistike të gjetura janë të paplota dhe të paqarta dhe me vlefshmëri dhe përfaqësim të panjohur. Më shumë të dhëna ka në nivel Qarku ose vendi. Megjithatë, u gjykua që reduktimi i madhësive nga nivelet e larta në Bashkinë në studim do të çonte në përfundime të gabuara, sepse mbizotërojnë qendra urbane shumë më të mëdha, të cilat kanë metabolizëm shumë të ndryshëm (më linear), me konsum më të madh dhe më pak prodhim burimesh dhe materialesh, ndërsa pesha e popullsisë në totalin e Qarkut është shumë e vogël. Përveç kësaj, dimensionet që përcaktojnë intensitetin e metabolizmit janë të shumta (p.sh. struktura e qytetit, sistemi i transportit, faktorët ekonomikë, qeverisja, mënyra e jetesës, klima) dhe bashkëveprojnë, duke krijuar një rrjet kompleks marrëdhëniesh dhe ndikimesh në

¹ Wolman A (1965), The metabolism of cities. Scientific American, vol. 213 (3), p.179-190.

² Kennedy C., Cuddihy J. and Engel-Yan J. (2007), The changing metabolism of cities. Journal of Industrial Ecology, vol. 11 (2), p.43-59.



sistemin urban. Prandaj do të nevojitet një studim i veçantë për përshkrimin dhe analizën e Bashkisë si ekosistem, duke përdorur mjetet, treguesit sasiorë dhe ato cilësorë.

Ndërkohë, përafrohet niveli dhe tendenca e metabolizmit të zonës së studimit brenda rrjedhës së energjisë, ujit, materialeve dhe mbeturinave. Analiza e këtyre komponenteve bazuar në informacionin sasior dhe cilësor të dhënë, bëhet me ndihmën e treguesve, të cilët përfaqësojnë katalizatorët metabolikë dhe cilësinë e jetës. Në këtë stad, duke përcaktuar bazën për përgatitjen e strategjisë, qëllimi është sqarimi i bashkëveprimit midis tendencave dhe të dhënave që karakterizojnë sistemin urban të Mirditës mjedisin e saj original. Me zbatimin e kësaj metode, identifikohen problemet e bashkisë në lidhje me cilësinë e jetës (atmosferën, zhurmat) dhe flukset e burimeve natyrore, energjinë dhe materialet. Në këtë mënyrë, përqendrohen sektorët, tek të cilët adresohen problemet dhe kërkohet përmirësimi i tyre në kuadër të projektimit të strategjisë territoriale. Në veçanti, është i nevojshëm propozimi i udhëzimeve indikative strategjike për rivitalizimin e metabolizmit urban në bashkinë e Mirditës, në përpjekjen për të arritur qëndrueshmërinë urbane.

Energjia

Një nga të mirat materiale më të rëndësishme që konsumohet nga njerëzit nëpërmjet komuniteteve të organizuara, është energjia. Energjia nuk humbet, por shndërrohet nga një formë energjie në një tjetër. Për këtë arsye, në vijim i jemi referuar përdorimit të energjisë dhe burimeve natyrore të rinovueshme (ose jo) që konsumohen për konvertimin e energjisë nga një formë në një tjetër. Energjia ka forma të ndryshme, si energjia elektrike, termike, të ndriçimit, mekanike (potenciale dhe kinetike), kimike, bërthamore dhe përdoret nga sektorë të ndryshëm brenda kufijve të një ndarje administrative, qoftë Shtet apo Bashki. Fushat kryesore të aplikimit janë ndërtesat civile, tregtare, industriale, , transporti, dhe bujqësisë.

Sektori i banimit dhe sektori i shërbimeve, përveç përqindjes të madhe të energjisë elektrike, konsumojnë edhe një pjesë të konsiderueshme druri dhe produkte të naftës për ngrohje. Megjithatë, sektori më intensiv në Shqipëri, është sektori i transportit. Në vitin 2008 ky sektor kapi 44% të përdorimit të përgjithshëm të energjisë. Nga viti 2000 e më pas ka një rritje të provuar të transportit, veçanërisht në lidhjet rrugore, që u shoqërua me një rritje në konsumit të karburantit.

Shpërndarja gjeografike e saj (Figura 1.3.1) tregon se 70% e totalit të energjisë përdoret në ultësirën bregdetare të Shqipërisë ku është përqëndruar pjesa më të madhe e popullsisë dhe e aktiviteteve të vendit.






Figura 1.3.1: Shpërndarja e konsumit të energjisë për çdo prefekturë të Shqipërisë.³

Energjia elektrike mund të prodhohet nga centralet me avull, hidro, bërthamore dhe nga parqet eolike dhe ato diellore. Një bashki mund të prodhojë energji elektrike që futet në rrjetin elektrik të vendit dhe shpërndahet në përputhje me rrethanat sipas zonës. Energjia elektrike përdoret në funksionimin e pajisjeve elektrike shtëpiake, të ndriçimit, në sistemet e ngrohjes të mjedisit dhe të ujit, etj.

Në Shqipëri është e rëndësishme sasia e energjisë elektrike e prodhuar nga hidrocentralet. Burimet e energjisë brenda kufijve të Bashkisë Mirditë nuk janë aq të pasura. Megjithatë, vlen të përmendet se në veri të Bashkisë gjenden tre hidrocentralet më të mëdha të vendit, të lumit Drin. Brenda Bashkisë është ndërtuar një hidrocentral i vogël, "HEC Klos", me fuqi 1520 KW.

Në lidhje me burimet e rinovueshme të energjisë (diellore, eolike) nuk janë regjistruar objekte përkatëse. Megjithatë, potencialet për shfrytëzimin e energjisë diellore janë të kënaqshme. Siç shihet në figurën 1.3.2b, zona e Bashkisë Mirditë paraqet një rrezatim diellor prej 3.83-3.97 kWh/m² (renditet në kategorinë e 6-të më të lartë). Përkundrazi lidhur me energjinë eolike, shpejtësia mesatare vjetore e erës është shumë e vogël (1,5-2,0 shpejtësia mesatare vjetore e erës) në këtë zonë, siç shihet në figurën 1.3.2 Bashkia Mirditë gjendet në një zonë që i përket dy kategorive më të ulëta të shpejtësisë së erës në vend.

Nga sa më sipër mund të konkludohet se energjia elektrike e përdorur për nevojat e Bashkisë dhe banorëve të saj realizohet nga zona të tjera. Për të përmbushur nevojat aktualisht të larta dhe gjithnjë në rritje, është ndërtuar kohët e fundit një nënstacion i ri i energjisë elektrike, duke përmirësuar dhe zgjeruar sistemin e gjerë të transmetimit të energjisë elektrike.

³ Burimi: Raport Vjetor, Gjendja e Sektorit të Energjisë dhe Veprimtaria e ERE-s gjatë Vitit 2010






Figura 1.3.2a: Rrezatimi diellor mesatar vjetor ⁴



Figura 1.3.2b: Shpejtësia mesatare vjetore e erës ⁵

Sipas të dhënave të Bankës Botërore, përdorimi i energjisë elektrike për banor në Shqipëri është rritur nga 1990 në 2012 (Figura 1.3.3). Në veçanti, për vitin 2012, përdorimi për banor ishte rreth 2118,26 kWh. Respektivisht për vitin 2011, përdorimi për banor ishte 2,205.7 kWh. Sipas të dhënave zyrtare të regjistrimit të vitit 2011, Bashkia e Mirditë ka një popullsi prej 22,103 banorësh. Në bazë të popullatës rezulton se Bashkia ka përdorur në total për vitin 2011 $(22,103 \times 2,205.7)$ 48,752,587.1 kWh energji elektrike. Për këtë studim u llogarit edhe konsumi i energjisë elektrike për vitin 2010, i cili për çdo banor ishte 1943,34 kWh. Gjithashtu, World Bank (Banka Botërore) kohët e fundit ka publikuar konsumin e energjisë elektrike për banor për vitin 2014 dhe në rastin e Shqipërisë rezulton të jetë 2,309.37 kWh / banor.

⁴ Burimi: Sustainable energy for Albania - <http://aea-al.org/>

⁵ Burimi: Sustainable energy for Albania - <http://aea-al.org/>






Figura 1.3.3: Progresi i konsumit të energjisë elektrike për banor në Shqipëri. Theksohet vlera për vitin 2011. (Burimi: <https://www.google.gr/publicdata>)

	Popullsia totale 2011	Konsumi i energjisë elektrike kWh
Rrëshen	8,803	19,416,777.1
Rubik	4,454	9,842,187.8
Selitë	745	1,643,246.5
Kthellë	2,209	4,872,391.3
Fan	2,977	6,566,368.9
Orosh	1,899	4,188,624.3
Kaçinar	1,016	2,240,991.2

Tabela 1.3.1 Konsumi i energjisë elektrike në Bashkinë Mirditë sipas konsumit për frymë nga të dhënat e Bankës Botërore.

Konsumi i energjisë elektrike është i lartë pasi popullsia e zonës është e madhe dhe përbëhet nga qytetit i Rrëshenit, i cili konsiderohet një qendër e madhe urbane në nivel qarku.

Energjia termike e përdorur është për ngrohjen e ndërtesave dhe ujit, përgatitjen e ushqimit etj. Parametri bazë i përdorimit për ngrohjen e ndërtesës është gjendja termike e cila në kushtet ekzistuese varion nga mesatare deri e keqe.. Veçanërisht për ngrohjen e ujit, është gjithashtu i kufizuar përdorimi i energjisë diellore me ngrohës diellorë shtëpiak. Për më tepër nuk shfrytëzohen në nivel Bashkie format e tjera të burimeve të rinovueshme, si biomasa ose energjia gjeotermale, nuk janë duke u



shfrytëzuar as në nivelin komunal. Në veçanti për energjinë gjeotermale nuk ka fushë të shfrytëzueshme të regjistruar në zonën e studimit.

Burimi kryesor që konsumohet për ngrohje është druri, me ndikim në mjedis dhe ndikim në shëndetin e qytetarëve nga shkarkimi i grimcave dhe blazës. Furnizimi me dru bëhet nga pikat e ligjshme të shitjeve, por edhe direkt nga sipërfaqet pyjore, prandaj përlogaritja e sasisë nuk mund të jetë e saktë. Gjithashtu, nuk ka të dhëna për përqindjet e drurit të konsumuar për sa i përket prejardhjes së tij (brenda ose jashtë Bashkisë).

Në Shqipëri dhe si rrjedhojë në zonën e studimit, nuk është e mundur të zhvillohet sistemi i gazit natyror në hapësirë afatshkurtër, i cili ka prodhim të papërfillshëm të gazit natyror endogjen dhe njëkohësisht nuk ka lidhje me rrjetin evropian të gazit natyror. Përveç kësaj, në sipërfaqen e Bashkisë Mirditë nuk ka ndonjë shoqëri që merret me nxjerrjen e hidrokarbureve për prodhimin e lëndëve djegëse.

Përsa i përket konsumit primar të energjisë, dmth para se të shndërrohet në lëndë djegëse për përdorim përfundimtar, i cili është i barabartë me prodhimin vendas plus importet dhe ndryshimet e rezervës, minus eksportet dhe karburantet që furnizojnë anijet dhe aeroplanët, të dhënat rezultojnë në bazë të konsumit për kg të ekuivalentit të naftës (O.E.) për banor nga Banka Botërore për vitin 2011.

Sipas Banka Botërore konsumi për banor ishte 729.154 kg O.E. në 2010, 764.969 kg O.E. në 2011., në 687.896 kg O.E. në 2012, në 801.33 kg O.E. në 2013 dhe në 808.456 kg O.E. në 2014.






Figura 1.3.4: Konsumi i energjisë primare në kg të ekuivalentit të Naftës për person për vitin 2011⁶

	Popullsia totale 2011	Konsumi i energjisë në kg OE
Rrëshen	8803	6,734,022.107
Rubik	4454	3,407,171.926
Selitë	745	569,901.905
Kthellë	2209	1,689,816.521
Fan	2977	2,277,312.713
Orosh	1899	1,452,676.131
Kaçinar	1016	777,208.504

Tabela 1.3.2: Konsumi i energjisë primare në Bashkinë Mirditë në bazë të konsumit për banor sipas Bankës Botërore.

⁶ Burimi: <http://data.worldbank.org/indicator/EG.USE.PCAP.KG.OE/countries/AL?display=graph>






Figura 1.3.5: Parashikimi i nevojave energjetike për sektor (2004)⁷

Bazuar në sa më sipër, sasia më e madhe e energjisë së konsumuar vjen nga zonat jashtë bashkisë, dhe kjo krijon probleme të varësisë nga stoku i energjisë. Prodhimi i decentralizuar i energjisë përbën tendencën e ardhshme me synim zgjidhjen e varësisë nga rezervat e energjisë të rajoneve të tjera. Këtu, ndërkohë, duhet theksuar se një pjesë e madhe e energjisë së prodhuar në Shqipëri vjen nga burime të ripërtëritshme të energjisë (hidrocentrale), fakt i cili kontribuon në efikasitetin e energjisë së metabolizmit. Përdorimi i energjisë së rinovueshme zvogëlon shanset për krijimin dhe shtrirjen e ndikimeve të rëndësishme mjedisore.

Theks i veçantë duhet të vendoset në kufizimin e djegies së drurit për ngrohje pasi ndikon në masë të madhe cilësinë e mjedisit për shkak të emisioneve.

Megjithatë, një problem me të cilin ballafaqohet Bashkia e Mirditës ka të bëjë me hapësirën e kufizuar të shfrytëzimit të burimeve të ripërtëritshme të energjisë brenda kufijve të saj administrativ. Në veçanti, stacionet më të mëdha të hidrocentraleve janë të vendosura jashtë kufijve të bashkisë.

Përdorimi më i madh i këtyre, kryesisht për ndërtesat, i kombinuar me zhvendosjen drejt shfrytëzimit të rrezatimit diellor për objektet brenda në qytet, do të mund të përmirësonte balancën e rrjedhës së energjisë.

Në përgjithësi, sektori i energjisë në zonën e studimit ka nevojë për modernizim dhe aplikim të teknologjive të reja, në mënyrë që të përdoren si mjete për të reduktuar konsumin dhe ngarkesën e energjisë. Në thelb, flukset e energjisë në sistemin urban të bashkisë përfshijnë faktorë të ndryshëm dhe kompleks, pasi janë të lidhura me ndikime të rëndësishme mjedisore, të cilat mund të tejkalojnë kufijtë e bashkisë. Kjo e bën menaxhimin e energjisë një sfidë të kohës. Riorganizimi urban, përdorimi i teknologjive të reja, sensibilizimi i banorëve dhe profesionistëve mund të kontribuojnë në kursimin e energjisë.

⁷ Burimi: Sustainable energy for Albania - <http://aea-al.org/>



Uji

Shqyrtimi i burimeve ujore, si komponent i flukseve në sistemin metabolik të qytetit të Mirditës do të bëhet në drejtim të sistemit të menaxhimit, kërkesës për konsum në lidhje me ofrimin dhe gjenerimin e mbetjeve. Komponenti i burimeve ujore trajtohet si një rrjedhë e vetme që ndjek rrjedhën dhe daljen e sistemit.

Uji i pastër është më i çmuari kundrejt të gjithë të mirave të tjera materiale. Gjithashtu qasja ndaj sasive të mjaftueshme të ujit të pastër përbën një tregues kyç të zhvillimit të një zone dhe një shoqërie. Mjaftueshmëria varet në shkallë të lartë nga prania e burimeve ujore, ujërave nëntokësore (aquiferëve) dhe ujërat sipërfaqësore (liqene, lumenj, etj), ndërsa cilësia/pastërtia e ujit varet nga shkalla e ndotjes dhe/ose ndotjes së tokës dhe sipërfaqes së ujit. Uji është i nevojshëm në sektorët jetik të banimit, bujqësisë dhe industrial, të shërbimeve dhe turizëmit.

Bashkia Mirditë ndodhet në veriperëndim të basenit Mat (Mat Basin). Bëhet fjalë për një basen me sipërfaqe relativisht të kufizuar, i cili shtrihet në rrethet Mat, Mirditë, Lezhë dhe Kurbin, dhe pjesërisht në rrethet e Pukës dhe Bulqizës, si dhe në një pjesë të vogël të qarkut Shkodër. Në veçanti, Bashkia e Mirditës shtrihet në basenin që formojnë lumenjtë e mëposhtëm: Fani i Madh, Fani i Vogël, Fani Rubik. Nënbaseni Fani i Vogël ka sipërfaqe 415 km² dhe lumi ka gjatësi 55 km. Nënbaseni gjendet në një lartësi mesatare prej 734 m, ndërsa burimet e lumit Fani i Vogël janë 1860 metra mbi nivelin e detit. Lumenjtë Fani i Madh dhe Fani i Vogël furnizojnë me ujë Njësinë Administrative më të madhe dhe më të populluar të Rrëshenit.

Në Bashkinë Mirditë konstatohet potencial i konsiderueshëm uji për shkak të rrejtës të gjerë hidrografik të zonës dhe burimeve që dalin aty. Burimet kryesore të Bashkisë Mirditë janë: Bargjani (që furnizon me ujë qytetin Rrëshen), Domgjon, Klos, Xhuxhë, Shëngjin, Ujë, Uraka, brenda Njësisë Administrative Kthellë ndodhet Liqeni i Ulzës, ku përfundojnë shumë nga përrenjtë e zonës. Liqeni i Ulzës, me thellësi mesatare 60 m, përbëhet nga një digë artificiale e ndërtuar për prodhimin e elektricitetit. Në përgjithësi, liqeni nuk karakterizohet “në gjendje të mirë ekologjike” për shkak të aktiviteteve njerëzore dhe niveleve të kontaminimit dhe ndotjes që janë regjistruar.

Për sa i përket ujërave nëntokësore nuk ka të dhëna të sakta sasiore. Përveç kësaj, akuiferet nëntokësore shpesh shtrihen dhe përtej kufijve të njësive administrative dhe baseneve të lumenjve. Në lidhje me cilësinë e ujërave nëntokësore, depozitat e gjera të bakrit në zonë duket se ndikojnë në ujërat e zonës.

Si lumenjtë ashtu edhe burimet e Bashkisë Mirditë janë mënyra kryesore e furnizimit me ujë të banorëve, por dhe e ujitjes së sipërfaqeve të kultivuara relativisht të kufizuara. Gjithashtu, një pjesë e rëndësishme e furnizimit me ujë dhe ujitjes përbëhet nga puse të përdorimit privat, shumica e të cilave janë me kapacitete të vogla (më pak se 1 l/s). Në përgjithësi, nuk ka tregues të presionit të fortë mbi rezervat e baseneve nëntokësore në zonë. Sipas studimit “Plani Pilot i Menaxhimit të Basenit të Lumit Mat”, furnizimi me ujë në pjesën veriore të basenit është 300l/s, nevojat për ujitje janë 500 l/s, ndërsa për përdorim privat 1.100l/s.



Rrjetet ujitëse nuk janë të sistemuara në këtë zonë. Gjithashtu, rrjeti i ujësjellësit mbulon një pjesë të nevojave të banorëve (kryesisht të qendrave më të mëdha të banimit). Në rrjetin ekzistues të Bashkisë, rrjedha e ujit nuk është e vazhdueshme. Për shembull, në vitin 2015, në Rajonin Njësinë Administrative të qendrës së Bashkisë (Mirditë-UK sh.a), rrjedha e ujit ishte e kufizuar në gjysmën e orëve të ditës (12.95 orë/ditë), kryesisht për shkak të pamundësive ekonomike dhe teknike. Megjithatë bën përjashtim zona e Njësisë administrative Rubik, ku furnizimi me ujë është i vazhdueshëm (24 orë/ditë).

Në përgjithësi, nuk ka të dhëna të hollësishme mbi kërkesën dhe konsumin e ujit për të gjitha kategoritë e ndryshme të përdoruesve, si në aspektin e rrjeteve të organizuara, ashtu edhe të shpimeve private të tokës. Gjithashtu mungon informacioni sistematik mbi të gjithë Bashkinë e Mirditës. Sipas të dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjellës kanalizimeve (www.dpuk.gov.al), në dispozicion (të përfshira në tabelën A, B dhe C) janë gjetur të dhëna të disponueshme vetëm për dy (2) nga shtatë (7) Njësitë Administrative të Bashkisë Mirditë (për Nj.A të qendrës së Bashkisë dhe Nj. A. Rubik) për periudhën kohore 2006-2015.

Sipas të dhënave për vitin 2015 (Tabelat B, C dhe D), në Nj. A. të qendrës së Bashkisë (T_Mirditë_UK sh.a) në vitin 2015, ndërmarrja ekzistuese e ujësjellësit nga totali prej 9,089 banorësh, furnizonte me ujë vetëm 6,074 banorë (përqindja 66,8%). Ky furnizim bëhej për 5,261 banorë të zonave urbane dhe 813 banorë të zonave rurale. Gjithashtu, konsumi total ditor ishte 107.74 litra/frymë/ditë, nga të cilat 73.94 konsumoheshin për përdorim shtëpiak, me fluks hyrjeje ditor total në sistemin e furnizimit me ujë në 718.400m³. Përkatësisht, në Nj.A Rubik, në vitin 2015, nga 7,931 banorë gjithsej, kishin lidhje me rrjetin vetëm 2,385 banorë, nga të cilët 2,225 në qendrat urbane dhe 160 banorë në vendbanimet rurale. Gjithashtu, konsumi i përgjithshëm ditor i ujit është 121 litra/frymë/ditë, nga të cilat 113 konsumohen për përdorim shtëpiak, me fluks hyrjeje ditor total prej 128,400 m³.

Për sa i përket daljeve nga sistemi i furnizimit me ujë (të cilat vlerësohen të jenë të njëjta si hyrjet), nuk ka asnjë parashikim për përpunimin e tyre dhe zakonisht derdhen në mënyrë të pakontrolluar së bashku me daljet e rrjetit të kanalizimit në rrjetin e afërm hidrografik dhe liqenet. Në tabelën 1.3.3 paraqitet në mënyrë përmbledhëse marrëdhënia ndërmjet aksesit ndaj ujit dhe nivelit të ndikimit ndaj shëndetit.

Niveli shërbimit	Mënyra e qasjes	Nevojat e plotësuara	Niveli i ndikimit ndaj shëndetit
Nuk ka qasje (sasia e grumbulluar shpesh nën 5 l / c / d)	Më shumë se 1000m ose 30 minuta totali i kohës së grumbullimit	Konsumi- nuk mund të sigurohet-Higjena- jo e mundshme (në qoftë se nuk praktikohet)	Shumë i lartë
Qasje bazë (Sasia mesatare 20 l / c / d)	Midis 100 dhe 1000m ose 5 deri 30 minuta totali i	Konsumi- duhet të sigurohet – higjena- larja e duarve dhe higjena bazë e ushqimit e	i lartë



	kohës së grumbullimit	mundhsme-Larja e rrobave/ banja personale e vështirë për tu siguruar nëqoftëse nuk kryhet në burim.	
Qasje e ndërmjetme (Sasia mesatare rreth 50 l / c / d)	Ujë i furnizuar nëpërmjet një çezme në parcelë (ose brenda 100m ose 5 minuta totali i kohës së grumbullimit)	Konsumi-i siguruar, higjena personale dhe e ushqimit e siguruar. Larja e rrobave/ njësi hidrosanitare duhet gjithashtu të sigurohen	i ulët
Qasje optimale (Sasia mesatare 100 l / c / d dhe më lart)	Ujë i furnizuar nëpërmjet shumë çezmave pa ndërprerje	Konsumi i të gjithë nevojave të plotësuara Higjena e të gjitha nevojave që duhet të plotësohen	Shumë i ulët

Tabela 1.3.3: "Përmbledhja e kërkesës për nivelin e shërbimit të ujit për të promovuar shëndetin"⁸

Banimi relativisht i kufizuar i Bashkisë Mirditë (me tendencë të uljes së popullsisë), veprimtaria e kufizuar bujqësore dhe veprimtaria industriale thuajse janë inekzistente, veprojnë në mënyrë favorizuese, të paktën në aspektin e mjaftueshmërisë së burimeve ujore. Megjithatë, ndërkohë që potenciali i ujit mund të mbulojë nevojat për furnizim me ujë, por edhe për ujitje të Bashkisë, mangësitë dhe pamjaftueshmëritë serioze të rrjetit të kanalizimit, si dhe pamundësitë për trajtimin e ujërave të ndotura urbane, dëmtojnë aspektet metabolike të zonës së studimit.

Një problem serioz për bashkinë është pamundësia për të shërbyer të gjithë popullsisë për shkak të infrastrukturës jo të plotë, fakt i cili është një pikë jashtëzakonisht e dobët dhe është i nevojshëm aktivizimi i menjëhershëm i bashkisë, për të plotësuar këto boshllëqe. Ripërdorimi i ujërave të shiut është një praktikë që së pari varet nga kushtet klimatike, njohuritë ekzistuese dhe mentaliteti i banorëve, dhe së dyti kufizohet nga struktura e mjedisit urban.



⁸ Burimi: Howard G. & Bartram J., "sasia e ujit për përdorim familjar, Shërbimi, Niveli dhe Shëndeti", WHO/SDE/WSH/03.02. ©Organizata Botërore e Shëndetësisë 2003
http://apps.who.int/iris/bitstream/10665/67884/1/WHO_SDE_WSH_03.02.pdf





Treguesit 2006-2014

T_Mirdite_UK sh.a		2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Treguesit	Njësia e matjes	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
1.1 Mbulimi me Ujësjellës	%	31,98	66,83	66,83	66,83	66,83	66,83	66,83	66,83	71,55
1.2 Mbulimi me Ujësjellës - Urbane	%	63,57	63,57	63,57	63,57	63,57	63,57	63,57	63,57	63,57
1.3 Mbulimi me Ujësjellës - Rurale	%	7,59	100,00	100,00	100,00	100,00	100,00	100,00	100,00	N/A
2.1 Mbulimi me Kanalizime	%	27,70	57,88	57,88	57,88	57,88	57,88	57,88	57,88	61,97
3.1 Prodhimi i Ujit (l.f.d.)	l/c/d	352,09	351,84	370,61	476,06	386,48	331,47	387,86	407,03	427,85
3.2 Prodhimi i Ujit (m3.lidhje.muaj)	m3/conn/m	53,31	53,54	58,97	77,70	61,93	52,99	60,18	63,36	65,55
5.1 Shitjet e Ujit (l.f.d)	lcd	120,88	133,90	226,96	247,61	165,75	117,77	106,58	115,14	107,74
5.2 Shitjet e Ujit (m3 lidhje muaj)	m3/conn/m	18,30	20,38	36,11	40,41	26,56	18,83	16,54	17,92	16,51
5.3 Shitjet e Ujit - Familjare (l.f.d.)	l/c/d	97,16	76,29	76,79	74,95	74,51	74,94	69,68	73,15	73,94
7.1 Përqindja e lidhjeve me ujëmatës	%	7,26	7,15	11,08	12,54	24,48	42,25	43,38	37,70	34,40
2.1.1 Vazhdimësia e Shërbimit (orë/ditë)	Orë/ditë	11,86	13,09	13,08	12,95	12,95	12,55	12,64	12,39	12,95

Treguesit 2006-2014

T_Rubik_UK sh.a		2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Treguesit	Njësia e matjes	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
1.1 Mbulimi me Ujësjellës	%	92,15	59,87	64,72	28,05	27,98	26,20	26,20	28,32	29,74
1.2 Mbulimi me Ujësjellës - Urbane	%	89,77	58,48	68,55	58,72	58,14	53,82	53,82	56,62	58,96
1.3 Mbulimi me Ujësjellës - Rurale	%	270,21	74,80	23,62	1,28	1,96	1,46	1,46	3,46	3,67
2.1 Mbulimi me Kanalizime	%	86,39	53,48	56,27	27,37	26,93	25,42	25,42	26,48	27,80
3.1 Prodhimi i Ujit (l.f.d.)	l/c/d	170,46	158,03	268,17	188,37	339,73	164,57	164,57	153,51	152,87
3.2 Prodhimi i Ujit (m3.lidhje.muaj)	m3/conn/m	33,17	24,37	29,98	24,46	46,39	22,27	22,27	20,01	19,41
5.1 Shitjet e Ujit (l.f.d)	lcd	105,57	126,53	177,01	153,04	142,16	144,26	144,26	132,62	121,05
5.2 Shitjet e Ujit (m3 lidhje muaj)	m3/conn/m	20,54	19,51	19,79	19,88	19,41	19,52	19,52	17,29	15,37
5.3 Shitjet e Ujit - Familjare (l.f.d.)	l/c/d	87,94	108,78	151,83	131,50	124,90	126,06	126,06	119,49	113,07
7.1 Përqindja e lidhjeve me ujëmatës	%	14,83	16,91	17,35	16,26	16,92	17,61	17,61	24,88	30,85
2.1.1 Vazhdimësia e Shërbimit (orë/ditë)	Orë/ditë	21,33	21,17	24,00	22,00	21,50	22,00	22,00	23,00	24,00

Tabela 1.3.4: Treguesit e ujit të ujësjellës për T_Mirditë_UK dhe T_Rubik_UK (periudha kohore 2006-2014).

(Burimi: <http://www.dpuk.gov.al/rub.php?idr=345&lang=1>, http://www.dpuk.gov.al/ndermarje_info.php?idn=33, http://www.dpuk.gov.al/ndermarje_info.php?idn=31)

Të dhënat e agreguara për periudhën 2008-2015

	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
të dhënat	T_Mirditë uk sh.a							
popullsia që jeton në zonën e juridiksionit- në qytet	8.276,0	8.276,0	8.276,0	8.276,0	N/A	8.276,00	8.276	8.276
popullsia që jeton në zonën e juridiksionit- në fshat	813,0	813,0	813,0	813,0	N/A	813,00	663	813
popullsia që jeton në zonën e juridiksionit- total	9.089,0	9.089,0	9.089,0	9.089,0	N/A	9.089,00	8.939	9.089
popullsia që faktikisht furnizohet me ujë nga shoqëria/nj.admn.- në qytet	5.261,0	5.261,0	5.261,0	5.261,0	N/A	5.261,00	5.261	5.261
popullsia që faktikisht furnizohet me ujë nga shoqëria/nj.admn.- në fshat	813,0	813,0	813,0	813,0	N/A	813,00	813	813
popullsia totale që faktikisht furnizohet me ujë nga shoqëria/nj.admn.- total	6.074,0	6.074,0	6.074,0	6.074,0	N/A	6.074,00	6.074	6.074
popullsia që shërbehet me lidhje në banesë	5.906,0	5.906,0	5.906,0	5.906,0	N/A	5.906,00	5.948	5.906
popullsia që shërbehet me çezma publike	168,0	168,0	168,0	168,0	N/A	168,00	168	168
vëllimi i ujit të prodhuar nga sistemet me rrjedhje të lirë (000 m3)	24,2	237,0	44,2	24,2	N/A	24,06	24,1	514,1
vëllimi i ujit të prodhuar nga sistemet me ngritje mekanike (000 m3)	806,4	830,0	822,0	718,7	N/A	888,22	934,8	204,3
vëllimi total i ujit të prodhuar nga dy llojet e sistemeve (000 m3)	830,7	1.067,0	866,2	742,9	N/A	912,28	959,0	718,4
vëllimi i ujit të blerë nga shoqëri apo njësi administrative të tjera (000 m3)	0,0	0,0	0,0	0,0	N/A	0,00	0,0	0,0
vëllimi i ujit të shitur me shumicë (000 m3)	0,0	0,0	0,0	0,0	N/A	0,00	0,0	0,0
vëllimi neto i ujit në sistemin e shpërndarjes së zonës së shërbimit (000 m3)	830,7	1.067,0	866,2	742,9	N/A	912,28	959,0	718,4
gjatësia totale e rrjetit të ujit (km)	19,8	19,8	19,8	19,8	N/A	19,80	19,8	19,8
nr. total i lidhjeve të ujit (me dhe pa matës) - total	1.173,8	1.144,3	1.165,5	1.168,3	N/A	1.199,92	1.219	1.360
nr. total i lidhjeve të ujit - qytet	1.024,8	1.016,1	1.023,8	1.046,8	N/A	1.093,25	1.107	1.200
nr. total i lidhjeve të ujit- fshat	148,8	127,8	141,8	121,5	N/A	106,67	112	160
vazhdimësia e shërbimit - nr. mesatar i orëve të furnizimit	13,1	13,0	13,0	12,6	N/A	12,39	13,0	13,7
nr. testimet për klorin mbetës	1.526,0	1.534,0	1.564,0	1.548,0	N/A	1.671,00	1.816,0	1.798
nr. kampioneve negative për klorin mbetës	1.514,0	1.534,0	1.564,0	1.548,0	N/A	1.671,00	1.816,0	1.793
sasia e klorit që konsumohet në secilin muaj (kg)	97,0	1.503,7	350,0	112,5	N/A	133,75	87,5	444,2
nr. testimet për koliform	1.527,0	1.518,0	1.564,0	1.548,0	N/A	1.672,00	1.816,0	1.798
nr. kampioneve negative për koliform	1.527,0	1.518,0	1.564,0	1.548,0	N/A	1.239,00	1.816,0	1.786

Tabela 1.3.5: Treguesit e ujit të ujësullësist për T_Mirditë (Uk) sh.a (periudha kohore 2008-2015).

Burimi: <http://www.dpuk.gov.al/rub.php?idr=345&lang=1>, http://www.dpuk.gov.al/ndermarrje_info.php?idh=33



Të dhënat e agreguara për periudhën 2008-2015

	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Të dhënat	T_Rubrik uk sh.a							
popullsia që jeton në zonën e juridiksionit- në qytet	2.719,0	3.063,8	3.752,8	3.824,0		3.831,50	3.765	3.736
popullsia që jeton në zonën e juridiksionit- në fshat	254,0	2.237,0	4.329,9	4.263,0		4.327,00	4.222	4.195
popullsia që jeton në zonën e juridiksionit- total	2.973,0	5.300,8	8.082,7	8.087,0		8.158,50	7.987	7.931
popullsia që faktikisht furnizohet me ujë nga shoqëria/nj.admn.- në qytet	1.778,7	2.026,6	2.194,8	2.164,8		2.115,00	2.218	2.225
popullsia që faktikisht furnizohet me ujë nga shoqëria/nj.admn.- në fshat	73,7	116,1	86,1	81,4		150,00	155	160
popullsisë totale që faktikisht furnizohet me ujë nga shoqëria/nj.admn.- total	1.852,3	2.142,7	2.280,9	2.246,2		2.265,00	2.372	2.385
popullsisë që i shërbehet me lidhje në banesë	1.843,0	2.112,7	2.250,9	2.206,2		2.265,00	2.372	2.385
popullsisë që i shërbehet me çezma publike	0,0	30,0	40,0	40,0		0,00	0	0
vëllimi i ujit të prodhuar nga sistemet me rrjedhje të lirë (000 m3)	143,8	121,5	269,3	120,7		128,30	133,8	128,4
vëllimi i ujit të prodhuar nga sistemet me ngritje mekanike (000 m3)	39,5	27,5	16,6	15,7		0,00	0,0	0,0
vëllimi total i ujit të prodhuar nga dy llojet e sistemeve (000 m3)	183,3	148,9	285,9	136,4		128,30	133,8	128,4
vëllimi i ujit të blerë nga shoqëri apo njësi administrative të tjera (000 m3)	0,0	0,0	0,0	0,0		0,00	0,0	0,0
vëllimi i ujit të shitur me shumicë (000 m3)	0,0	0,0	0,0	0,0		0,00	0,0	0,0
vëllimi neto i ujit në sistemin e shpërndarjes së zonës së shërbimit (000 m3)	183,3	148,9	285,9	136,4		128,30	133,8	128,4
gjatësia totale e rrjetit të ujit (km)	16,5	16,5	16,5	16,5		16,50	16,5	16,5
nr. total i lidhjeve të ujit (me, dhe pa matës) - total	509,6	507,3	513,7	510,5		534,25	575	578
nr. total i lidhjeve të ujit – qytet	486,4	491,6	498,4	495,1		509,92	545	546
nr. total i lidhjeve të ujit- fshat	18,3	15,8	15,3	15,4		24,25	30	32
vazhdimësia e shërbimit - nr. mesatar i orëve të furnizimit	24,0	22,0	21,5	22,0		23,00	24,0	20,7
nr. testimeve për klorin mbetës	244,0	756,0	792,0	753,0		720,00	716,0	510
nr. kampioneve negative për klorin mbetës	244,0	756,0	792,0	753,0		719,00	716,0	510
sasia e klorit që konsumohet në secilin muaj (kg)	101,3	135,0	144,6	125,8		54,17	50,0	50,0
nr. testimeve për koliform	0,0	567,0	792,0	753,0		720,00	716,0	510
nr. kampioneve negative për koliform	0,0	567,0	792,0	753,0		719,00	716,0	508

Tabela 1.3.6. Treguesit e ujit të ujësjellësit për T_Rubrik (Uk) sh.a (periudha kohore 2008-2015).

Burimi: <http://www.dpuk.gov.al/rub.php?idr=345&lang=1>, http://www.dpuk.gov.al/ndermarrje_info.php?idn=31



Materialet

Materialet përdoren në funksionimin dhe mirëmbajtjen e aktiviteteve, në përmbushjen e nevojave të popullsisë, në ndërtimin e infrastrukturave etj (p.sh. ushqim, ambalazhim, materiale ndërtimi) dhe pas përdorimit të tyre ose depozitohen si rezervë në sistemin urban, ose hidhen si mbetje. Për shkak të natyrës dhe shumëllojshmërisë të tyre dhe të tregut të lirë, nuk është e mundur që të identifikohen influkset në Bashki, ndërsa flukset dalëse janë më të njohura dhe të identifikueshme (si mbetje, do të shqyrtohen në paragrafin e ardhshëm).

Për sa i përket materialeve (produkteve) bazë që prodhon Bashkia Mirditë (dhe që konsumohen më shumë në Bashki), janë si më poshtë:

- Prodhimi bujqësor: 48% e Bashkisë Mirditë janë sipërfaqe të kultivueshme, ku mbizotëron kultivimi i frutave. Gjithashtu është i rëndësishëm produktiviteti i rajonit nga produkte si luçern, drithëra, patate dhe perime.
- Prodhimi shtazor: sasi më të mëdha i referohen shpesëve, dhive, derrave, deleve, lopëve, bletëve, nga të cilat prodhohen sasi të mjaftueshme të mishit, qumështit, leshit dhe mjaltit.
- Nxjerrja e mineraleve: nxjerrja e bakrit dhe kromit përbën një aktivitet të rëndësishëm ekonomik në Bashkinë Mirditë dhe në veçanti në Nj.A. Rubik. Megjithatë, ritmi i nxjerrjes dhe përpunimit të bakrit dhe kromit është shumë më e ulët se para viteve 1990.
- Prodhimi i drurit të zjarrit: sipas të dhënave të disponueshme prodhimi në vitin 2016 ishte 18.534.766 metra kub.

Bashkia Mirditë, për shkak të karakterit të saj malor, me sipërfaqe të kultivuara të kufizuara dhe me blegtori të kufizuar (kryesisht për qëllime shtëpiake), paraqet produktivitet relativisht të ulët në materiale dhe ushqime, të cilat konsumohen kryesisht brenda Bashkisë. Për shkak të karakterit të fortë pyjor, prodhimi i drurve të zjarrit (nga prerja e pemëve), është mjaft i zhvilluar. Druri i zjarrit ka për qëllim vetëm ngrohjen e banorëve të Bashkisë. Veprimtaria minerare që kryhet në zonë përbën një burim të rëndësishëm të kontaminimit të tokës dhe ujit në mungesë të përpunimit dhe disponimit të duhur, apo të përdorimit të teknologjive inovative në nxjerrjen e mineraleve. Ndërmjet bakrit dhe kromit që prodhohet në zonë, bakri shkakton probleme më të mëdha.

Mbetjet dhe emetimet

Në zonën e studimit, mbledhja, depozitimi dhe deponimi i mbetjeve tani është në kompetencë të Bashkive. Çdo Bashkie i është kërkuar të gjejë një vend të përshtatshëm për deponimin e tyre. Në Bashkinë e Mirditës, sipas të dhënave të Ministrisë së Zhvillimit Urban (<http://mbetjet.zhvillimiurban.gov.al>), funksionon një vend depozitimi sanitar i mbetjeve, i cili ndodhet pranë vendit të depozitimit të dikurshëm, të paorganizuar dhe josanitar. Landfilli për deponimin e pakontrolluar të mbetjeve në fjalë ka tendencë të braktiset (sot pranon vetëm mbetjet e ngurta urbane). Gjithashtu në bazë të autopsive të kryera, në të gjithë territorin e Bashkisë u



konstatuan dhe vende të tjera të vogla dhe të shpërndara të deponimit të pakontrolluar (sidomos në zonat Rubik dhe Rrëshen).



Figura 1.3.6: Vendet e depozitimit të mbetjeve të Bashkisë

	Popullsia e shërbyer (merr/konsidero het për shërbimin)	% e popullsisë që përjashtohet (e regjistruar, por jetonë jashtë)	Mbetjet e gjeneruara për person [kg/banorë]	Totali i mbetjeve të gjeneruar [t/vit]
Rrëshen (urban)	5.200	0%	0.8	1.518
Rrëshen (rural)	3.603	0%	0.3	395
Rubik (urban)	2.672	0%	0.8	780
Rubik (rural)	1.781	0%	0.3	195
Orosh (rural)	1.900	0%	0.4	277
Fan (rural)	2.977	0%	0.3	326
Kaçinar (rural)	1.016	0%	0.3	111
Kthellë (rural)	2.209	0%	0.3	242
Selitë (rural)	745	0%	0.3	82
TOTAL	22.103	0%	0.42	3.926

Tabela 1.3.7: Të dhëna për prodhimin dhe mbledhjen e mbetjeve në Bashkinë Mirditë
Burimi: Instituti i Modelimeve në Biznes, www.imb.al (Ministria e Zhvillimit Urban, 30/03/2017)
<http://mbetjet.zhvillimiurban.gov.al>,



	Mbetje Urbane (ton)	Mbetje Urbane për banorë (ton)	Mbetje Inerte (ton)
2015			
Lezhë	50.876	0,441	5.303

*Tabela 1.3.8: Të dhëna për prodhimin e materialeve inerte në nivel Qarku Lezhë (Mirditë)
Burimi: <http://www.instat.gov.al/en/themes/environment.aspx>
INSTAT -Vrojtimi vjetore mbi mbetjet urbane*

Qarku	Popullsia	Sasia vjetore / Ton / banorë	Sasia vjetore / Mb.urbane/ton	Sasia vjetore / Mb.inerte/ton
2013				
Lezhë	210748	0.312	65910	15945

*Tabela 1.3.9: Të dhëna për prodhimin e mbetjeve në nivel Qarku Lezhë (Mirditë)
Burimi: «Tabela e sasise se mbetjeve per vitin 2013» dhe përpunimin e saj
http://www.mjedisi.gov.al/files/userfiles/Monitorim_Mjedisor/Mbetjet.pdf.*

Në mungesë të të dhënave dhe regjistrimeve sistematike, nuk është e mundur të kryhen analiza dhe vlerësime të hollësishme të mbetjeve të krijuara (zona e shërbimit, viti, rrjedhat e mbetjeve etj.) dhe menaxhimin e tyre për zonën e studimit. Në bazë të të dhënave të INSTAT⁹, konstatohet një rritje konstante dhe e shpejtë e sasisë së mbeturinave në nivel qarku gjatë dhjetëvjeçarit të fundit (2006-2015). Përkundrazi, ka një tendencë të kufizimit të inerteve gjatë të njëjtës periudhë, veçanërisht gjatë dy viteve të fundit. Megjithatë, meqenëse në zonën e studimit (Bashkia Mirditë) banon vetëm 10% e Qarkut të Lezhës banojnë, përfundimet e mësipërme rreth sjelljeve dhe tendencave mund të jenë të gabuara. Gjithashtu, ka shumë të ngjarë që përbërja e mbetjeve të përfshijë lloje të ndryshme urbane (inerte, të rënda, mbetjet e kulturave, etj.).

Në përgjithësi, duke pasur parasysh natyrën kryesisht bujqësore dhe ekonominë lokale e familjare të zonës së studimit, vlerësohet se shumica e mbetjeve janë mbetje organike të ngurta. Këto mbetje, përkeqësojnë në masë të vogël ujin dhe nëntokën, ndërkohë që është e mundur që ato të përdoren përmes kompostimit për prodhimin e plehut, të dobishme për kulturatbujqësore. Dhe në këtë mënyrë të zhvillohet procesi i riciklimit në zonën e studimit. Aktualisht nuk funksionon asnjë impiant i përpunimit të mbetjeve.

Në lidhje me rrjetin e kanalizimeve të Bashkisë, të dhënat e disponueshme nga Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjetës kanalizimeve (www.dpuk.gov.al) janë fragmentare. Ashtu si në rastin e furnizimit me ujë, ato i përkasin Nj.A. më të populluara, të Rrëshenit (T_Mirditë UK_sh.a) dhe Rubikut, të cilat përbëjnë rreth 60% të popullsisë së Bashkisë. Megjithatë, sipas të dhënave të disponueshme, ka një rrjet kanalizimesh edhe një Nj.A. Selitë dhe Orosh.

⁹ <http://www.instat.gov.al/en/themes/environment.aspx>



Në bazë të këtyre të dhënave (Tabela 1.3.10), rezulton se në zonën T_Mirditë UK sh.a, ka vetëm 1,200 lidhje me rrjetin e kanalizimeve. Këto lidhje shërbejnë për 5,261 banorë nga 9,089 banorë gjithsej të Nj. A. Lidhjet përkatëse me rrjetin e ujësjellësit janë 1,360, duke krijuar prurje hyrjeje 718,400m³. Logjikisht edhe daljet janë përkatësisht. Në Njësinë Administrative Rubik, ka vetëm 546 lidhje me rrjetin e kanalizimit, që u shërbejnë 2,385 banorëve (vetëm në qendrat urbane) nga 7,931 banorë gjithsej që ka Njësia Administrative Rubik. Lidhjet përkatëse në rrjetin e furnizimit me ujë janë 578, duke krijuar prurje hyrjeje prej 128,400m³ (dhe rrjedhimisht dalje).

Në lidhje me mbetjet e lëngshme, aktualisht nuk ka asnjë njësi për përpunimin e tyre. Ndërkohë që dihet se mbetjet e lëngëta (veçanërisht të vendbanimeve rurale) shkarkohen direkt në mjedis (toka dhe rrjeti hidrografik i zonës), nuk ka të dhëna specifike të presionit të veçantë të ushtruar nga rrjedhjet në cilësinë e ujërave sipërfaqësore, nëntokësore dhe të tokës.



Të dhënat e agreguara për periudhën 2008-2015										
Të dhënat	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015		
	T_Mirditë uk sh.a									
popullsia që jeton në zonën e juridiksionit- total	9.089,0	9.089,0	9.089,0	9.089,0		9.089,00	8.939	9.089		
popullsia totale që faktikisht furnizohet me ujë nga shoqëria/nj.admn.-total	6.074,0	6.074,0	6.074,0	6.074,0		6.074,00	6.074	6.074		
popullsia totale me lidhje në sistemin e kanalizimeve	5.261,0	5.261,0	5.261,0	5.261,0		5.261,00	5.261	5.261		
popullsia me lidhje në sistemin e kanalizimeve-në fshat	0,0	0,0	0,0	0,0		0,00	0	0		
popullsia me lidhje në sistemin e kanalizimeve-në qytet	5.261,0	5.261,0	5.261,0	5.261,0		5.261,00	5.261	5.261		
vëllimi neto i ujit në sistemin e shpërndarjes së zonës së shërbimit (m3)	830,7	1.067,0	866,2	742,9		912,28	959,0	718,4		
numri total i lidhjeve me sistemin e kanalizimeve - total	1.060,3	1.011,1	1.017,7	1.044,1		1.093,67	1.106,6	1.200		
numri total i lidhjeve me sistemin e kanalizimeve-qytet	1.060,3	1.011,1	1.017,7	1.044,1		1.093,67	1.106,6	1.200		
numri total i lidhjeve me sistemin e kanalizimeve-fshat	0,0	0,0	0,0	0,0		0,00	0,0	0		
vëllimi i ujit që faturohet për kanalizimet - i matur - total (m3)	273,5	313,0	120,9	122,9		139,22	117,0	112,9		
vëllimi i ujit që faturohet për kanalizimet - të pamatur - total (m3)	119,8	118,3	101,9	71,7		101,67	106,7	99,8		
vëllimi total i ujit që faturohet për kanalizimet - total (m3)	393,3	431,3	222,8	194,6		240,89	223,7	212,7		
tarifa kanalizime- f (lekë/m3)	4,0	4,0	4,0	4,0		10,00	10,0	10,0		
tarifa kanalizime- ep (lekë/m3)	10,0	10,0	10,0	10,0		15,00	15,0	15,0		
tarifa kanalizime- in (lekë/m3)	8,0	8,0	8,0	8,0		15,00	15,0	15,0		

Të dhënat e agreguara për periudhën 2008-2015										
Të dhënat	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015		
	T_Rubik uk sh.a									
popullsia që jeton në zonën e juridiksionit- total	2.973,0	5.300,8	8.082,7	8.087,0		8.158,50	7.987	7.931		
popullsia totale që faktikisht furnizohet me ujë nga shoqëria/nj.admn.-total	1.852,3	2.142,7	2.280,9	2.246,2		2.265,00	2.372	2.385		
popullsia totale me lidhje në sistemin e kanalizimeve	1.722,6	2.020,8	2.194,8	2.164,8		2.115,00	1.722,6	2.020,8		
popullsia me lidhje në sistemin e kanalizimeve-në fshat	0,0	0,0	0,0	0,0		0,00	0,0	0,0		
popullsia me lidhje në sistemin e kanalizimeve-në qytet	1.722,6	2.020,8	2.194,8	2.164,8		2.115,00	1.722,6	2.020,8		
vëllimi neto i ujit në sistemin e shpërndarjes së zonës së shërbimit (m3)	183,3	148,9	285,9	136,4		128,30	133,8	128,4		





numri total i lidhjeve me sistemin e kanalizimeve - total	482,3	486,5	496,4	487,2	509,92	544,5	546
numri total i lidhjeve me sistemin e kanalizimeve-qytet	482,3	486,5	494,2	487,2	510,67	544,5	546
numri total i lidhjeve me sistemin e kanalizimeve-fshat	0,0	0,0	0,0	0,0	0,00	0,0	0
vëllimi i ujit që faturohet për kanalizimet – i matur - total (m3)	13,1	13,2	12,9	14,8	14,08	11,2	12,2
vëllimi i ujit që faturohet për kanalizimet - i pamatur - total (m3)	79,6	80,5	80,0	77,3	87,80	91,6	88,0
vëllimi total i ujit që faturohet për kanalizimet - total (m3)	92,7	93,6	92,9	92,1	101,88	102,8	100,2
tarifa kanalizime- f (lekë/m3)	7,0	7,0	7,0	7,0	7,00	7,0	7,0
tarifa kanalizime- ep (lekë/m3)	15,0	15,0	15,0	15,0	15,00	15,0	15,0
tarifa kanalizime- in (lekë/m3)	10,0	10,0	10,0	10,0	10,00	10,0	10,0

**Tabela 1.3.10: Treguesit e ujësjetësit dhe kanalizimeve për Mirditë (periudha kohore 2006-2014). (Burimi:
http://www.dpuk.gov.al/ndermarrje_info_fxt.php?id=943&idn=52 dhe <http://www.dpuk.gov.al/rub.php?idf=345&lang=1>,
http://www.dpuk.gov.al/ndermarrje_info.php?idn=33, http://www.dpuk.gov.al/ndermarrje_info.php?idn=31)**

Për emulsionet e gazta nuk ka të dhëna të hollësishme për shkak të mungesës së stacionit të regjistrimit. Ndotja e ajrit kryesisht i atribuohet ndikimit të aktiviteteve antropogjene. Në të ardhmen, me përfundimin e ndërtimit të autostradës Durrës-Kukës-Prishtinë, Oroshi mendohet të jetë burimi i ndotësve të gaztë të ajrit nga qarkullimi i shpeshtë i automjeteve. Gjithashtu edhe djegia e drurit (e cila është burimi kryesor i ngrohjes për banorët vendas) është përgjegjëse për lëshimin e sasive të konsiderueshme të grimcave dhe ndotësve të gaztë të ajrit, por nuk është i mundur vlerësimi përfundimtar i pasojave.

Fenomeni është gjithashtu i lidhur ngushtë me ndryshimet klimatike. Për këtë arsye monitorimi i ndotjes së ajrit është i domosdoshëm për të vlerësuar cilësinë e mjedisit urban.

Sipas Bankës Botërore emetimet e CO₂ për frymë për vitin 2011 arritën në 1.61 ton kubik. Në bazë të popullatës së Bashkisë për vitin 2011, emulsionet e dioksidit të karbonit janë vlerësuar në 22,103*1,61 = 35,585.83 tonë metrikë.

Njësia Bashkiake	Nivelet PM 2.5	NOx (ton/vit) - 2015	SOx (ton/vit) - 2015	CO ₂ 2013
Rrëshen	15 µg/m ³	61-100	16-30	14965.1
Rubik	16 µg/m ³	31-60	16-30	7571.8
Selitë	17 µg/m ³	16-30	1-15	1266.5
Kthellë	15 µg/m ³	3-15	1-15	3755.3
Fan	16 µg/m ³	16-30	1-15	5060.9
Orosh	15 µg/m ³	3-15	1-15	3228.3
Kaçinar	14 µg/m ³	16-30	1-15	1727.2

Tabela 1.3.11: Vlerësime për ndotjen atmosferike në Bashkinë Mirditë (Burimi: http://www.dpuk.gov.al/ndermarrje_info_txt.php?id=943&idn=52)

Ndotja e ajrit ndikon në metabolizmin e rajonit për sa i përket cilësisë së jetës dhe cilësisë së mjedisit. Eliminimi i fenomenit mund të arrihet me një sërë veprimesh në fusha të ndryshme të strukturës së qytetit. Mundësitë që Bashkia mund të shfrytëzojë janë integrimi i teknologjisë dhe promovimi i mjeteve alternative të transportit publik dhe transportit të materialeve.

Duke pasur parasysh sa më sipër, vlerësohet se mënyra aktuale e menaxhimit të mbetjeve është faktori më i rëndësishëm në përkeqësimin e metabolizmit të Bashkisë. Ekziston një mungesë e fortë e strukturave të posaçme të menaxhimit dhe përpunimit, ku vendet e deponimit të paligjshme të mbetjeve përkeqësojnë situatën. Për më tepër, dobësi e bashkisë është lejimi i vendvetëshumëfishta të hedhjes së mbetjeve të ngurta, të cilat degradojnë mjedisin natyror.

Përmirësimi i efikasitetit në rrjedhet nga mbetjet kërkon ndryshimin e modelit të menaxhimit duke rritur riciklimin dhe shfrytëzimin e teknologjisë për të përmirësuar efikasitetin. Një tipar i rëndësishëm i Bashkisë është tendenca për të zvogëluar vëllimin e mbetjeve të gjeneruara.



Bazuar në sa më sipër, vlerësohet se mënyra aktuale e menaxhimit të mbeturinave është faktori më i rëndësishëm në përqendrimin e metabolizmit të Bashkisë. Mungesa e objekteve të posaçme të menaxhimit, por edhe të trajtimit të këtyre flukseve shkaktojnë ndotje si të tokës ashtu edhe të sipërfaqes dhe të ujërave nëntokësore. Si rrjedhim, ka mundësi menaxhimi të mbeturinave përmes miratimit të një modeli, i cili do të përfshijë aktivitetet e grumbullimit dhe transportit, magazinimit të përkohshëm, objektit të depzimitit, aktiviteteve të riciklimit dhe impianteve, si edhe stacionet e ngarkimit.

Konkluzione

Metabolizmi urban përbën një mjet të rëndësishëm për analizën hapësinore dhe programimin. Megjithatë, studimet gjithëpërfshirëse që janë kryer deri më sot në nivel botëror janë të kufizuara dhe pilot. Dobësi kryesore në zbatimin e modelit, në përgjithësi dhe në veçanti në zonën e studimit, është mungesa e të dhënave dhe statistikave të vazhdueshme dhe analitike. Së fundmi, ka shumë parametra kyç që ndërveprojnë, siç janë rrethanat ekonomike, struktura urbane, shkalla e vetëmjaftueshmërisë së komunave, efikasiteti i burimeve dhe qasja, të cilat e bëjnë zbatimin edhe më të vështirë.

Për shkak të produktivitetit të kufizuar, banimit të kufizuar dhe mungesës së qendrave të mëdha urbane (shumica e tyre janë vendbanime shumë të vogla), hyrjet dhe daljet në sistemin e metabolizmit janë mjaft të kufizuara. Proçeset nuk arrijnë të jenë gjithmonë ciklike, sidomos për sa i përket mbetjeve dhe ujërave të zeza.

Për të vlerësuar sistemin metabolik të Bashkisë së Mirditës, përmes seksioneve tematike që u ndanë, u përzgjedhën treguesit më të rëndësishëm, të cilët karakterizojnë parametra të rëndësishëm të sistemit dhe nga ana tjetër kanë ndikimin më të madh. Vlerësimi ka lidhje me natyrën cilësore dhe lidhet me tendencat e zhvillimit të këtyre treguesve. Konkretisht, në çdo nënseksion vihen re një numër kompetentësh të qytetit, por edhe të rajoneve periferike, të cilat duhet të përmirësohen, në mënyrë që të reduktohet konsumi i burimeve dhe të zbuten fenomenet e ndikimit negativ.

Duke pasur si çështje kryesore përmirësimin e synuar të rrethanave patogjene që ndikojnë në metabolizëm për sa i përket cilësisë së jetës dhe cilësisë së mjedisit, propozohen veprimet e mëposhtme për Bashkinë:

- ndryshimi total i modelit të menaxhimit të mbetjeve (të lëngshme dhe të ngurta). Përpunimi (në impiante të përshtatshme) të ujërave të zeza urbane, shtrirjen e riciklimit të ambalazhimeve dhe mbetjeve organike të ngurta urbane, në mënyrë që në të ardhmen, deponimi i mbetjeve të kufizohet në ato që mbeten pas përdorimit të mënyrave alternative të menaxhimit.
- marrja e masa për të parandaluar dhe rehabilituar ndotjen e burimeve ujore (sipërfaqësore dhe nëntokësore).
- shfrytëzimi i Burimeve të Rinovueshme të Energjisë (p.sh. diellore, biomasa), veçanërisht për plotësimin e nevojave të ngrohjes (që të zvogëlohet në këtë



mënyrë ndotja atmosferike për shkak të djegies së drurit). Gjithashtu, shfrytëzimi i BRE për të përmirësuar cilësinë e jetës dhe shërbimeve të ofruara në të gjitha vendbanimet dhe veçanërisht për të arritur objektivat kombëtare të Shqipërisë për autonomi energjetike me importe enegjie zero në në ardhmen (National Energy Efficiency Action Plan).

- shfrytëzimi i ujërave të shiut (që nuk është një praktikë e zakonshme) për mbulimin e nevojave të furnizimit me ujë, por edhe të ujitjes (nëpërmjet rezervuarëve etj).
- informimi dhe sensibilizimi i banorëve dhe bizneseve për çështjet e metabolizmit urban, kursimit të ujit dhe mbrojtjes së rezervave të ujit, riciklimit etj.

1.4. Përcaktimi i territorit sipas pesë sistemeve

Në kuadër të hartimit të strategjisë territoriale, programohet përcaktim i territorit në përputhje me pesë sistemet: atë urban, natyror, bujqësor, ujqor dhe infrastrukturor. Në veçanti, duke përmbledhur regjistrimin analitik dhe rezultatet e fazës A, regjistrohen pikat dhe karakteristikat më të rëndësishme të sistemeve të territorit të bashkisë Mirditë, duke tentuar në një vlerësim fillestar.

Në Tabelën më poshtë tregohet niveli, përqindja e mbulimit të secilit sistem, në krahasim me sipërfaqen totale brenda kufijve administrativë të bashkisë.

SISTEMI TERRITORIAL	PËRQINDJA %
Sistemi natyror	90,54
Sistemi ujqor	1,28
Sistemi bujqësor	6,23
Sistemi Urban	1,17
Sistemi infrastrukturor	0,78

Tabela 6.1: Përqindjet e sistemeve territoriale në Bashkinë Mirditë

Tabela tregon se shumica e tokave në Bashkinë Mirditë janë të mbuluara nga sistemi natyror me 90,54%, të pasuar nga kulturat bujqësore me 6,23%. Sistemi ujqor arrin në 1,28%, ndërsa sistemet urbane dhe infrastrukturor mbulojnë respektivisht 1,17% dhe 0,78%.

Sistemi natyror

Sistemi natyror përfshin të gjitha ato sipërfaqje të mbuluara me pyje, kullota, livadhe, shkurre dhe tokë jopjellore. Ky sistem mbulon një sipërfaqe afro 90,54% të sipërfaqes totale të Bashkisë. Pjesë të sistemit natyror janë të integruara në statusin e mbrojtjes (Zona e Mbrojtjes së Burimeve të Menaxhuara Bjeshka e Oroshit, rreth 4691,2 ha).



Pjesa më e madhe e sipërfaqeve karakterizohet si kodrinore dhe gjysmëmalore dhe ka pjerrësi të madhe dhe relief të theksuar, si rrjedhojë rrjeti rrugor është jashtëzakonisht i kufizuar.

Aktivitetet e ushtruara në sistemin natyror janë të kufizuara dhe të lidhura me prejen e drurëve, kullotjen, bletarinë, mbledhjen e frutave. Gjithashtu ka edhe aktivitete turistike që lidhen me kampe dhe intinerare. Theksohet se kanë përfunduar studimet për përmirësimin e gjendjes së pyjeve në shumë zona, në të gjitha njësitë administrative. Ndërhyrjet e propozuara do të kenë ndikim pozitiv në gjendjen aktuale nëpërmjet rritjes së pemëve, strukturën e pyjeve, parandalimin, mbrojtjen nga zjarret dhe dëmtimet, cilësinë e drurit dhe shkallën e shfrytëzimit, në ekonomi dhe në vendet e punës për realizimin e tyre, duke ulur nivelin e varfërisë, si edhe për të rritur ndërgjegjësimin e komunitetit vendor në mbrojtjen e pasurisë pyjore.

Sistemi ujor

Bashkia përshkohet nga një rrjet i pasur dhe i dendur hidrografik, elementet kryesore të të cilit janë lumenjtë Fan, Fan i Vogël dhe Fan i Madh. Në pjesën më të madhe të tyre, ky sistem territorial zë 1,28% të sipërfaqes totale të zonës së studimit. Në pjesën më të madhe të gjatësisë së tyre rrjedhat kalojnë nëpër zonat e sistemit natyror dhe në një përqindje të vogël në ato bujqësore dhe urbane. Në këto rastet e fundit, duhet të merret parasysh fenomeni i erozionit të tokës.

Ujërat përdoren për prodhimin e energjisë hidrike, veç kësaj u konstatua se në shtratin e lumenjëve grumbullohen materiale inerte (rërë, zhavorr) realizohet aktiviteti i peshkimit, në raste individuale dhe të shpërndara, ndërsa noti ishte i kufizuar, në pjesën e Fanit në jug të Rubikut. Nuk janë regjistruar aktivitete të tjera, të organizuara ose e kundërta.

Në dy degët kryesore (Fan i Vogël dhe Fan i Madh) nuk kryhen aktivitete të tilla për shkak të gjeomorfologjisë. Megjithatë, janë ndërtuar diga me synim prodhimin e energjisë hidroelektrike (tre në të parin dhe dy në të dytin), ndërsa janë dhënë dhe disa leje të tjera për ndërtimin e tyre.

Paralelisht me lumin Fan i Vogël është ndërtuar autostrada E851 (Rruga e Kombit), ndërtimi i së cilës ka ndikuar në shtratin e lumit në mënyra të ndryshme dhe ka ndryshuar peizazhin përreth. Lumi i Fanit të Madh përfshihet pothuajse tërësisht në sistemin natyror.

Në jug të Bashkisë, në kufirin me Bashkinë e Matit, një sipërfaqe të rëndësishme zë Liqeni artificial i Ulzës, i cili është pjesë e Parkut Natyror Ulzë (kategoria IV). Si rrjedhojë përdorimi i tokës në zonën rreth liqenit është i kufizuar, konstatohen vetëm aktivitetet bujqësore me rendiment të ulët.

Megjithatë, vlen të theksohet, se sistemi hidrografik është nën presion të fortë si për shkak të rritjes së urbanizimit dhe menaxhimit të dobët të stokut ekzistues, p.sh. depozitimit të mbetjeve urbane dhe industriale të patrajtuara në lumin Fan në zonën urbane Rubik, të aktiviteteve tregtare dhe, në përgjithësi, të mos mbrojtjes së gjithë



sistemit përmes projekteve të duhura teknike(mbrojtja lumore). Faktor negativ për sistemin hapësinor ujon është gjithashtu aktiviteti i rritur i marrjes së zhavorrit dhe heqjes së agregatëve në segmente të papërshtatshme. Sistemi hidrografik është gjithashtu në presion të vazhdueshëm, edhe nga varrezat që ndodhen pranë lumenjve dhe ekziston rreziku i ndotjes së akuiferit.

Është e rëndësishme të kërkohen dhe të vlerësohen efektet e heqjes së rrës në anën tjetër të digave të mëdha në ekosistemin e lumenjve (fauna ujore, cilësia e ujit etj.), në derdhjet e lumit Mat dhe sistemet e mbrojtura të ligatinave të krijuara në bregdet.

Plani i Përgjithshëm Kombëtar (PPK) promovon mbrojtjen e burimeve ujore nga marrja e pakontrolluar e zhavorrit, hedhja e mbeturinave urbane dhe ndotja nga aktivitetet bujqësore dhe industriale, përmes përcaktimit të të ashtuquajturit linjë blu. Gjithashtu, përmendet si një prioritet modernizimi dhe forcimi i infrastrukturës ekzistuese të ujësjellësit dhe ujitjes me synim për të minimizuar humbjet e rrjetit dhe për ta udhëhequr dhe çuar rajonin në një menaxhim më të qëndrueshëm të burimeve.

Sistemi bujqësor

Në këtë sistem përfshihen të gjitha kulturat bujqësore që ndodhen brenda kufijve të Bashkisë dhe e gjithë infrastruktura e tyre mbështetëse, siç janë rrjetet e ujitjes, serat, depot dhe njësitë e mbarështimit të shpendëve/kafshëve. Ky sistem mbulon 6,23 % të sipërfaqes totale të zonës së studimit. Shumica e tokave bujqësore ndodhen në njësitë administrative Rrëshen dhe Kthellë.

Objektet e ndryshme mbështetëse të ndërtesës (depo, frigoriferë, sera, stalla, etj.) janë të kufizuara. Rrjeti i ujitjes përkundrazi është mjaft i zhvilluar, me rezervuare, kanale dhe depozita, në pronësi të bashkisë apo private, dhe në vitet e fundit kryhen vepra për përmirësimin e tij.

Për sa i përket pozicionit të tyre sipërfaqet e kultivuara (si ato të braktisura, por dhe ato me mundësi kultivimi) hasen në zonat anës brigjeve të lumenjve dhe përrenj dhe në zona të sheshta apo me pjerrësi të vogël të terrenit që krijohen në pjesët e ulta të maleve. Në të njëjtat zona krijohen shpesh vendbanime dhe shtëpi, të grumbulluara ose të izoluara. Kështu pamja e zakonshme është që sipërfaqet bujqësore rrethojnë zona të ndryshme banimi madje zhvillohen edhe midis ndërtesave. Bazuar në sa më sipër konstatohet se janë lehtësisht të arritshme pasi përshkohen ose janë brenda, në distancë të vogël, nga rrjeti rrugor kryesor dhe lokal. Për sa i përket madhësisë, pronat individuale janë të vogla. Gjithashtu, zonat e njësuara bujqësore kanë shtrirje të kufizuara, pasi ndërpriten vazhdimisht nga rrëketë dhe sipërfaqet natyrore për shkak të morfologjisë së gjeorelievit.

Theksohet se në sistemin bujqësor janë përfshirë edhe banesat individuale të vendosura brenda tokave arë ku gjenden kulturat bujqësore. Këto janë vendbanime të përhershme të bujqve. Së fundmi, sqarohet se, për shkak të madhësisë, rregullimit dhe shpërndarjes së sipërfaqeve bujqësore, siç u theksua më lart, nuk ka rrugë, vetëm për qëllimin, e shërbimit të kulturave bujqësore.



Pjesa më e madhe e kulturave bujqësore, kanë të bëjnë kryesisht, me kulturat e arave siç janë drithërat, misri, tërfili. Pjesa më e madhe e sipërfaqeve të këtyre llojeve janë regjistruar në njësinë administrative Fan dhe Kthellë. Mjaft më të vogla janë sipërfaqet e vreshtave dhe pemishteve, të cilat hasen kryesisht në njësitë administrative të Rrëshenit dhe Kthellës. Megjithatë nga pamja e përgjithshme, rezultojnë kultura të përziera, pasi ato kryesisht mbulojnë në shkallë të lartë nevojat shtëpiake të familjeve.

Zona e studimit nuk paraqet aktivitet të madh në sektorin e blegtorisë. Prodhimi më i madh është regjistruar në Rrëshen dhe Kthellë. Objektet përkatëse janë struktura të vogla, ndonjëherë të përkohshme, dhe janë të shpërndara si në zonat e banuara dhe në veçanti në zona më të largëta. Në disa vende është e pëhapur bletaria.

Sistemi urban

Sistemi urban mbulon 1,17% të sipërfaqes së përgjithshme të rajonit të studimit.

Zonat e destinuar për zhvillimin e organizuar të banimit, siç janë miratuar me Vendim të KKT 5 /29.12.2014, janë të shpërndara në të gjithë sipërfaqen e Bashkisë, megjithatë, me përqendrim më të madh në njësitë administrative Rrëshen dhe Rubik dhe sipërfaqe më të madhe në qendrën e Bashkisë, në qendrat e njësive administrative dhe vendbanimet e arritshme lehtësisht. Vendbanimet përbëhen nga zona banimi që nuk janë në vazhdimësi të njëra tjetrës, ato janë të lidhura me rrjetit rrugor kombëtar apo rural. U konstatua se kanë shtrirje më të gjerë se ndërtime të sotme dhe përfshijnë, sipërfaqe bujqësore apo natyrore të mëdha apo të vogla.

Të gjitha përdorimet, përveç banimit, që plotësojnë nevojat e përditshme dhe i shërbejnë jetës urbane (p.sh. shërbimet, tregtia, përdorime publike) gjenden brenda apo në afërsi të zonave të banuara. Në qytetin e Rrëshenit janë përqendruar lloje të ndryshme dyqane dhe zyra, hotele, klinika, etj, si edhe një numër i konsiderueshëm institucionesh bashkiake dhe publike. Të gjitha thuajse janë të vendosura në qendër. Pjesa tjetër e vendbanimeve përbëhet ekskluzivisht nga ndërtesa banimi dhe vetëm në vendbanimet më të mëdha ndeshen shërbimet bazë dhe shërbimet të tjera (p.sh. shkolla, ambulancat).

Objektet industriale ndodhen gjithashtu brenda apo pranë vendbanimeve pasi ndikohen dhe varen direkt nga ato, ndërkohë që përdorin të njëjtin rrjet bazë të transportit. Përfundimisht bëjnë ato njësi që kanë një varësi të drejtpërdrejtë hapësinore nga lëndët e para (rezervat minerare, shtretërit e lumenjve) që zakonisht janë më të largët (Rubik).

Sistemi infrastrukturor

Ky sistem territorial përfshin infrastrukturën e transportit, infrastrukturën energjetike, të telekomunikacioni, furnizimin me ujë dhe menaxhimin e mbeturinave. Ndër më të rëndësishmet konsiderohen rrugët ndërrbane, rurale dhe hidrocentralet, si për shkak të madhësisë ashtu dhe të rëndësisë për vendin e tyre në planin kombëtar. Ky sistem zë 0,78 % të sipërfaqes totale të zonës në studim.



Infrastruktura kryesore e gjendur në Bashki është Route 7 (E-851), e cila nga mbikalimi i Rrëshenit deri në kufirin verilindor të Bashkisë (Tuneli i Kalimashit në Thirrë) ka karakteristikat e autostradës (2 korsi për secilin drejtim dhe trafikndarës, ndërsa pjesa e mbetur është rrugë e gjerë me një korsi për secilin drejtim dhe pa trafikndarës.

Rrugë të tjera të rëndësishme të zonës së studimit janë rruga SH-30, rruga kryesore e vjetër që përshkon bashkinë, para ndërtimit të Rrugës 7 (E-851) për të cilën po kryhen përmirësime dhe rruga SH-34 që lidh selinë e Rrëshenit me njësitë administrative të Selitës dhe Kthellës (vetëm pjesa e Proçekut është e asfaltuar). Sistemi tjetër rrugor, me gjatësi pothuajse 400 km, përbëhet nga rrugë të pashtuara, me gjerësi të ngushtë, me përjashtim të rrugës së re për në Bukmirë. Pjesa më e madhe e rrjetit rrugor kalon përmes sistemit natyror dhe nëpër shumë zona rurale dhe urbane.

Për sa i përket infrastrukturës hekurudhore që funksionte më parë (për rreth një dekadë) në Bashki, kanë mbetur në gjendje të keqe disa pjesë të rrjetit, të cilat kryesisht kalojnë nëpër zonat bujqësore.

Në lidhje me objekte të tjera, janë regjistruar 6 hidrocentrale, kryesisht të përqëndruara në Orosh dhe në Fan. Gjithashtu, ka gjashtë nënstacione të energjisë elektrike të cilat gjenden kryesisht në vendbanimet më të mëdha, dhe në shumicën e rasteve brenda strukturës urbane: Rrëshen (2), Rubik, Kurbnesh, Repts, Kaçinar. Ka, gjithashtu, një stacion në jug të zonës së studimit, në kufi me bashkinë Mat. Brenda vendbanimeve dhe sidomos në seli është regjistruar infrastrukturë transmetimi të energjisë elektrike, të tilla si transformator dhe kabinë elektrike. Për më tepër, janë regjistruar depozita uji të pijshëm dhe stacione pompimi, kryesisht në Rrëshen, si edhe stacione antenash që i shërbejnë telekomunikacionit brenda bashkisë.

Në Bashki u regjistruan 2 vende të deponimit të mbeturinave, një është i ri i sapo përfunduar dhe një i vjetër që nuk është rikonstruktuar ende, të cilat rrethohen nga sipërfaqe natyrore.

Plani i Përgjithshëm Kombëtar (PPK) njih nevojën e përforcimit të menjëhershëm të rrjetit të infrastrukturës rrugore në të gjithë territorin Shqiptar dhe për këtë arsye propozon shtim të investimeve në këtë fushë duke vënë disa projekte specifike si prioritet të parë.

1.5. Identifikimi i nevojave, potenciali dhe kufizimet

Bazuar në gjetjet e analizës (faza A); karakteristikat kryesore të zonës së studimit, çështjet kryesore të identifikuar në diskutimin e parë publik, dhe programet e menduara e që po përpunohen dhe projektet që ndikojnë në zonën e studimit, kemi paraqitur analizën SWOT për secilin nga pesë sistemet territoriale, si më poshtë:

- Përparësitë krahasuese, faktorët e dobishëm endogjenë (Përparësitë)
- Mangësitë, probleme të qenësishme (Mangësitë).



- Mundësitë e jashtme dhe perspektivat (Mundësitë).
- Kërcënimet ekzogjene të origjinës dhe kërcënimet (Kërcënimet).

Analiza SWOT është bazë për planifikimin e strategjisë së zhvillimit territorial. Në bazë të analizës SWOT, strategjia i jep prioritet:

- Shfrytëzimit të përparësive të brendshme (S) për:
 - Përdorimin efektiv të mundësive (O) që ofron mjedisi i jashtëm.
 - Përballimit të kërcënimeve të jashtme (T).
- Pëballimit të dobësive të brendshme (W) dhe veçanërisht të atyre që:
 - Përgojnë shfrytëzimin e mundësive të jashtme (O).
 - Rrisin kërcënimet e jashtme (T).



Efekti pozitiv - faktorë përforcues	Efekti negativ - faktorë pengues	Efekti pozitiv - faktorë përforcues	Efekti negativ - faktorë pengues
PIKA TË FORTA	PIKA TË DOBËTA	MUNDËSI - PERSPEKTIVA	RREZIQE
Mjedisi natyror dhe kulturor			
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Mjedis mjaft i pasur natyror dhe gjeologjik (monumente natyrore, formacione gjeologjike, shpella, etj.). ▪ Potencial i rëndësishëm i ujit: lumenj të mëdhenj dhe ujëmbajtës nëntokësorë. ▪ Depozita të pasura të burimeve minerale. ▪ Zona të shumta me gjelbërim pyjor. ▪ Ekzistencë e zonave të mbrojtura të deklaruara (të nivelit kombëtar dhe rajonal) dhe monumenteve natyrore - planifikim përfshirjeje të zonave dhe elementeve të reja në sistemin kombëtar të mbrojtjes. ▪ Ekzistencë e monumenteve të deklaruara kulturore (arkitektonike dhe arkeologjike) dhe të zonave të tyre mbrojtëse. ▪ Trashëgimi të pasur historike dhe arkitektonike dhe ndërtesa të mirënjohura (kulla, kisha, kështjella, etj.) të shumë periudhave historike. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Mirëmbajtje dhe mbrojtje e pamjaftueshme e monumenteve kulturore. ▪ Braktisje - regjistrim jo i plotë i trashëgimisë kulturore. ▪ Mungesë ndërlidhjes dhe promovimit të mjedisit kulturor dhe natyror. ▪ Degradim i pyjeve (nga zjarret, shpyllëzimet, etj.). ▪ Mungesë - pamjaftueshmëri e sistemeve të menaxhimit të mbetjeve të lëngëta dhe të ngurta. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Shpallje e monumenteve të reja natyrore dhe kulturore. ▪ Zbatim i planeve të menaxhimit për zonat e mbrojtura. ▪ Promovim i turizmit alternativ në nivel qendror dhe rajonal dhe sigurimi i stimujve për të mbështetur sipërmarrjen përkatëse. ▪ Ndërhyrje të integruara të menaxhimit të trashëgimisë kulturore. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Fatkeqësi natyrore për shkak të ndryshimeve klimatike. ▪ Ndojtje e lumenjve nga minierat, aktivitetet bujqësore dhe zhvillimi urban. ▪ Presione të forta mjedisore për shkak të aktivitetit turistik, mbipopullimit të popullsisë - aktiviteteve në zonat e ndjeshme, kapacitetit të tepërt. ▪ Reduktim të sasisë - degradim i cilësisë së ujit për shkak të mbi konsumit dhe mbi nxjerrjes në aktivitetet ekonomike (ujtja, prodhimi i energjisë, minierat).





MJEDISI SOCIAL			
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Stabiliteti socio-ekonomik. ▪ Lidhje të forta shoqërore. ▪ Mungesë e grupeve sociale të marginalizuara – kriminaliteti. ▪ Formësim social i identitetit. ▪ Vetënjafvueshmëri e ekonomive familjare (kryesisht në fshatra) në prodhimin e ushqimit. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Reduktimi i popullsisë gjatë dekadave të fundit. ▪ Tendenca të përmbysjes së piramidës së moshës. ▪ Tendenca të braktisjes së fshatrave të largëta, ▪ kryesisht nga të rinjtë. ▪ Pabarazi midis qyteteve dhe fshatrave në aspektin e ofrimit të shërbimeve dhe kushteve të jetesës. ▪ Mungesë e stafit të kualifikuar dhe të punësuar në sektorë të ekonomisë. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Tërheqje e popullsisë për shkak të krijimit të vendeve të reja të punës. ▪ Përmirësim i aftësive të fuqisë punëtore lokale. ▪ Shfrytëzimi i teknologjive të reja, proceseve dhe metodave për edukimin e popullsisë ekonomikisht aktive, përshtatur me veçoritë lokale. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Intensifikim i fenomeneve të përjashimit social dhe të punësimit - pabarazive (p.sh. personat me aftësi të kufizuara, gratë). ▪ Rritje e indekseve të plakjes dhe varësisë. ▪ Forcimi i tendencës të braktisjes së vendbanimeve nga moshat prodhuese.
EKONOMIA			
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Pozicion kyç. ▪ Sektor i zhvilluar i shërbimeve (administrata publike, shërbimet sociale, tregtia) në selinë e Bashkisë. ▪ Produkte të pastra bujqësore/gastronomike dhe një sërë bimësh mjekësore. ▪ Aktivizim të ndërmarrjeve minerare. ▪ Investime në vreshtari dhe kantinat e verës. ▪ Përvojë dhe specializim në aktivitetet primare (p.sh. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Deindustrializim i gjerë, duke lënë inaktive dhe të degraduara ndërtesa dhe zona të shumta. ▪ Ekonomi rurale në shkallë të vogël dhe lokale që destinohet për konsum të brendshëm dhe familjar. ▪ Një pjesë e të ardhurave të rezidentëve bazohet në asistencën financiare të të afërmeve që punojnë jashtë shtetit. ▪ Mos ekzistencë e zinxhirëve 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Tendenca të situara të zhvillimit të ekoturizmit në vend dhe në aspektin ndërkombëtar. ▪ Hapësira të rëndësishme stimulimi dhe transformimi të aktivitetit rural (p.sh. prodhimin e produkteve tradicionale dhe me origjinë lokale). ▪ Potencial i madh për zhvillimin e bujqësisë organike të çertifikuar dhe blegtorisë. ▪ Stimulum - zhvillim i industrisë minerare për shfrytëzimin e bakrit, piritit, kromit dhe 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Konkurrencë nga rajonet fqinje me profile dhe burime të ngjashme. ▪ Interes i shtuar për turizmin bregdetar si në vend ashtu edhe atë ndërkombëtar. ▪ Pamundësi gjetje burimesh të mjaftueshme financimi. ▪ Vonesa të ndryshimeve të nevojshme strukturore në prodhimin bujqësor. ▪ Braktisje e Bashkisë nga njerëz të rinj dhe ekonomikisht aktivë me

<p>vreshtari, pemët frutorë, bimë medicinale) dhe sektori sekondar (nxjerrje minerare).</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Kushte të favorshme tokësore dhe klimatike për prodhimin e produkteve bujqësore (p.sh. rrushi). ▪ Kushte të favorshme për bletarinë. ▪ Rritje të investimeve të huaja direkte. ▪ Tokë e mjaftueshme dhe e lirë dhe kosto të ulëta të punës për zhvillimin e aktiviteteve bujqësore dhe blegtorale. 	<p>të rëndësishëm të prodhimit - mungesë të lidhjes midis sektorëve të prodhimit.</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Njohje e reduktuar turistike e rajonit/ vizitueshmëri e ulët dhe zhvillim i formave alternative të turizmit. ▪ Rrjeje e kërkesave për infrastrukturën urbane për shkak të shpërndarjes së madhe të ndërtimit dhe qasjes së vështirë. ▪ Mungesë e fuqisë punëtore të kualifikuar dhe specializimit të veprimitarisë sipërmarrëse në sektorë me avantazhe krahasuese. ▪ Konkurrencë e ulët e produkteve bujqësore, për shkak të pamundësisë për tu standartizuar dhe promovuar. 	<p>mineraleve të tjera të rralla (prioritet bazuar tek PPK).</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Zgjerim i Zonës Ekonomike të Përbashkët në lidhje me vendet e Ballkanit. 	<p>qëllim plotësimin e dëshirave personale dhe gjetjen e një pune.</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Konsolidim i shpërndarjes së ushqimit, i cili favorizon prodhuesit e mëdhenj dhe produktet e importuara.
<p>ZHVILLIMI URBAN</p>			
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Ndërtesa të veganta banimi. ▪ Zbatim i projekteve të rigjenerimit urban - Interesi i vazhdueshëm i Bashkisë. ▪ Hartimi i PPV. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Efikasitet i ulët i energjisë së ndërtimeve. ▪ Ndërtime të shpërndara - konsumim i burimeve jo të ripërtëritshme të tokës ▪ Mungesë e hapësira të përbashkëta në fshatra. ▪ Qasje e pamjaftueshme në 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Investime në përmirësimin e mjedisit urban - rinovime rezidenciale. ▪ Zhvillim i organizuar urban (përmes PDV) bazuar në projektimin bioklimatik. ▪ Programe përmirësimi të energjisë për ndërtesat 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Mungesë financimi. ▪ Degradim estetik dhe funksional për shkak të ndërtimeve dhe aktiviteteve ekonomik të pakontrolluar. ▪ Vonesa në miratimin dhe implementimin e PPV.





	<p>infrastrukturë urbane të kënaqshme (energjia elektrike, furnizim me ujë, kanalizime).</p> <ul style="list-style-type: none"> Dallime të forta mes qendrave urbane dhe fshatrave. 	<p>ekzistuese.</p> <ul style="list-style-type: none"> Promovimi i zhvillimit dhe rritjes së sipërfaqeve të gjelbëra. 	
AKSESI DHE INFRASTRUKTURA			
<ul style="list-style-type: none"> Kalimi i rrugës trans-evropiane E851 që lidh Shqipërinë dhe Kosovën. Akresi i lehtë dhe I shpejtë me qendrat urbane - qendrat e zhvillimit Lezhë, Shkodër, Kukës) si dhe në kryeqytetin. Kryqëzimi i linjave të tensionit të lartë - ekzistenca e nënstacioneve të energjisë elektrike. 	<p>Lidhje problematike të rrugëve me disa seli të njëjësive administrative dhe shumë fshatra (distanca të gjata kohore).</p> <ul style="list-style-type: none"> Mungesë të rrjetit hekurudhor Cilësi e ulët në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike në fshatra. Mungesë e rrjeteve kolektive të furnizimit me ujë. Infrastrukturë e vjetëruar dhe jo e mjaftueshme rurale (kanalet kulluese të tokës, bujqësia, elektrifikim, etj.). Derdhje e papërpunuar e ujërave të zeza të qytetit në lumenj. Mungesë e një sistemi të organizuar të menaxhimit të mbeturinave. 	<p>Ndërtim - përmirësim i rrugëve që lidhin Bashkinë me zonat e afërta, përveç boshitit A-D (E851).</p> <ul style="list-style-type: none"> Ndërtim i rrjetit hekurudhor dhe stacioneve të mallrave-pasagjerëve brenda Bashkisë. Tubacioni LAP i gazit. Investime - stimuj për zhvillimin e parqeve eolike 	<ul style="list-style-type: none"> Kalimi i njerëzve dhe mallrave nëpërmjet autostradës duke anashkaluar qytetet kryesore të Bashkisë. Pamundësi për të shfrytëzuar - lidhjen me rrjetin e gazit natyror.

1.6. Vizioni i Zhvillimit dhe Strategjia Territoriale

1.6.1. Vizioni i zhvillimit

Shqipëria është një vend mesdhetar. Klima e saj karakterizohet nga dimër i lagësht, i butë dhe verë e nxehtë dhe e thatë. Regjimi i klimës ndikohet herë pas here nga sistemet atmosferike, si përplasje nga Oqeani Atlantik i Veriut dhe Deti Mesdhe, dhe anticiklone që vijnë nga Siberia dhe Azoret. Një faktor tjetër kyç që ndikon në klimën është afërsia me detin.

Duke marrë parasysh faktet reale, si edhe kërkesat që ata kërkojnë, siç edhe u pasqyruan dhe u vlerësuan në Fazën A' të studimit, përfshirë dhe analizën e mëparshme SWOT, përcaktohet vizioni i zhvillimit të Bashkisë për vitin 2032. Vizioni i Zhvillimit të Bashkisë ka për qëllim të trajtojë dhe përballojë dobësitë dhe rreziqet që janë theksuar për rajonin e studimit dhe të shfrytëzojë avantazhet, si ato natyrore, ashtu edhe ato të përfituara nga mundësitë e paraqitura. Vizioni i zhvillimit të Bashkisë Mirditë për vitin 2032 është formuluar si më poshtë:

"Bashkia e Mirditës do të jetë një qendër shërbimi dhe përpunimi, bashkëkohor dhe konkurrues, bazuar në aksin trans-evropian Shqipëri-Kosovë (E851) dhe do të zhvillohet si pol i formave alternative të turizmit, bazuar në rezervat kulturore të shquara dhe burimet e pasura natyrore të saj".

Propozohet ringjallja ekonomike e rajonit, me qëllim që të bëhet një pol turistik bashkëkohor dhe konkurrues. Stimulimi i sektorit të turizmit do të arrihet duke e parë rajonin si një formë e zhvillimit të turizmit alternativ, duke përfituar nga rezervat e pasura kulturore, trashëgimia e veçantë arkitektonike e Bashkisë në kombinim me burimet e saj natyrore dhe duke identifikuar pozicionin kyç të Bashkisë.

Qëllimi i këtij studimi është që Bashkia e Mirditës të jetë një destinacion turistik, duke përfituar nga pozicioni i saj si një urë komunikimi midis bregdetit dhe rajoneve të brendshme të vendit. Në kuadër të nxitjes së zhvillimit të turizmit, propozohet që Bashkia të drejtohet drejt formave alternative të turizmit, të tilla si (a) turizmi - fetar kulturor i cili do të bazohet në monumentet e shumta që Bashkia disponon në rajonin e saj (Orosi është një pol me monumente në këtë zonë) dhe ndërtesat e shquara arkitektonike (Kullat) dhe (b) në turizmin natyror dhe ekoturizmin që do të bazohet në mjedisin e pasur natyror të Bashkisë.

Në të njëjtën kohë, propozohet që të forcohet dhe të organizohet edhe sektori industrial (sektori sekondar) dhe ai i tregtisë (sektori terciar), veçanërisht në afërsi të zonave urbane Rrëshen dhe Rubik. Forcimi sektorëve të mësipërm do të kryhet nëpërmjet zhvillimit të tyre të organizuar, në zona të caktuara ekonomike që do të propozohen dhe me qëllim mbrojtjen e mjedisit dhe menaxhimin racional të burimeve natyrore të Bashkisë.



Së fundi, duhet të mbështetet edhe sektori i bujqësisë, kryesisht në zonat e njësive administrative Rrëshen, Kthellë dhe Selitë, të cilat janë zona me karakteristika rurale të spikatura dhe ku duket një dëshirë dhe vullnet i ruajtjes së veprimtarisë së tyre prodhuese. Në këto zona propozohet forcimi i aktiviteteve rurale përmes promovimit të metodave ekologjike miqësore për prodhimin e produkteve të zonës, koordinimit dhe funksionimit të organizuara (p.sh. përmes kooperativave). Ky prodhim do të mund të zhvillohet dhe me krijimin e njësive agroturistike (të tilla si fermat rurale me gjënë e gjallë, gastronominë, etj.).

Në zhvillimin e rajonit të lart përmendur do të kontribuojë përmirësimi dhe integrimi i infrastrukturës dhe shërbimeve sociale, me synimin që banorët e Bashkisë të jetojnë në një mjedis të përmirësuar në mënyrë të qëndrueshëm, i cili do të jetë tërheqës dhe do të ndihmojë në shmangien, zbutjen e fenomenit të migrimit drejt qyteteve të tjera. Në këtë mënyrë do të ketë mbajtje të numërit të popullsisë dhe përmirësim të cilësisë së jetës. Për më tepër, do të duhet që Bashkia, të jetë në gjendje të ofrojë si për banorët ashtu edhe për vizitorët e zonës mundësitë dhe infrastrukturën përkatëse (energjinë, telekomunikacionin, internet, etj.).

1.6.2. Strategjia e Zhvillimit dhe Objektivat

Parimet kryesore udhëzuese për zbatimin e strategjisë së vizionit dhe zhvillimit të Bashkisë Mirditë janë renditur më poshtë si Objektiva Strategjike. Për çdo Qëllim Strategjik, shënohen në mënyrë treguese parametrat individualë që të çojnë në zbatimin e tij.

Objektivi strategjik 1: Rivitalizimi ekonomik i zonës përmes shfrytëzimit të pozitës kyçe të Bashkisë.

Ky objektivi do të arrihet përmes: (a) zhvillimit turistik të rajonit, (b) nxitjes së sektorit të prodhimit sekondar, (c) zhvillimit të tregtisë tranzitore dhe (d) nxitjes së sektorit primar nëpërmjet shfrytëzimit të burimeve natyrore të bashkisë (prodhimet bujqësore, burimet minerale, etj.).

Objektivi i parë strategjik i propozuar për bashkinë e Mirditës, synon forcimin e ekonomisë lokale të kombinuar me vendndodhjen gjeografike kyçe të qytetit, i cili gjendet në qasje të drejtpërdrejtë me aksin trans-evropian (E851) që lidh Shqipërinë me Kosovën, ndërsa në të njëjtën kohë ajo është një urë komunikimi midis zonës bregdetare dhe asaj në brendësi të vendit, me synimin e krijimit të vende të reja të punës, me qëllimin e parandalimit të fenomenit të rënies së numërit të popullsisë dhe lëvizjen e tij drejt qendrave kryesore urbane të vendit.

Një sektor i rëndësishëm i ekonomisë që propozohet të forcohet është sektori i turizmit. Ky është një sektor që mund të mbështetet si në trashëgiminë e pasur kulturore që bashkia disponon, ashtu edhe në burimet ekzistuese natyrore, me synim nxitjen e formave alternative të turizmit dhe sidomos turizmit fetar - kulturor, turizmin natyror, ekoturizmin dhe turizmin rural në disa zonat të Bashkisë. Kështu,



aktivitetet që do të propozohen në vazhdim, kanë synim përmbushjen e objektivit strategjik të përcaktuar nëpërmjet kombinimit:

1. Mjedisi i pasur antropogjen i Bashkisë, në të cilin përfshihen monumentet kulturore, si ato arkitektonike, historike, fetare etj., ndërtesat e veçanta arkitektonike (kullat, shtëpi të vjetra, etj.), trashëgimia e paprekshme (si këngët, veshjet, dasmat tradicionale, artizanatet, etj.) dhe të gjitha ato elemente që krijojnë karakterin e veçantë kulturor të zonës.
2. Rezerva e pasur natyrore e Bashkisë, ku përfshihet mjedisi natyror i Bashkisë, zonat e shpallura të mbrojtura, monumentet natyrore, formacionet gjeologjike, rrjetet e pasura hidrografike etj. Një burim i rëndësishëm natyror i rajonit është burimi i ujërave termale Kroj të Bardhë, i cili mund të jetë një tërheqje e magjishme turistike.

Për forcimin e sektorit të turizmit, do të duhet të propozohen disa aktivitete plotësuese që do të kenë si qëllim promovimin e produktit turistik të zonës, si psh pikat e informimit, tabela orientimi drejt zonave që duhen promovuar, informim të komunitetit lokal, etj.

Për sektorin primar të zhvillimit rekomandohet mbështetja e duhur, me theks të veçantë prodhimin e produkteve vendore cilësore (vreshta, drurë frutorë, lloje bimësh të cilat janë lehtësisht të prodhuara në këto zona etj.), dhe duke përdorur metoda miqësore me mjedisin, në mënyrë që të mos shkaktohen dëme të pariparueshme mbi të, si për shkak të keqpërdorimit të burimeve natyrore, ashtu edhe për shkak të ndotjes dhe degradimit të tyre.

Në sektorin primar gjithashtu përfshihet edhe prodhimi blegtoral për të cilin propozohet modernizimi i tij.

Sektorin primar gjithashtu përfshin shfrytëzimin e burimeve minerare të Bashkisë. Sipas hartave të PPK rajoni i bashkisë Mirditë është një zonë me rezerva të shumta të bakrit dhe mineraleve jo-metalike dhe përmendet si qendër e nivelit kombëtar për zhvillimin e industrisë përpunuese. Propozohet forcimi i këtij drejtimi, ndërsa paralelisht të merren masat e nevojshme mbrojtëse për të minimizuar ndotjen e mjedisit, burimet ujore, dhe njëkohësisht të merren masat e nevojshme që Bashkia të vjelë përfitimet përkatëse që asaj i takojnë nga përdorimi i nëntokës.

Sektorë të tjerë që duhet të stimulohen janë sektori dytësor, përmes krijimit të zonave të përpunimit të produkteve primare, me qëllim forcimin e sektorit të përpunimit dhe standardizimit të produkteve vendore dhe krijimin e zonave industriale në zonat që konsiderohen të përshtatshme për kryerjen e këtyre aktiviteteve (Rubik dhe Rrëshen). Përveç kësaj, industria e përpunimit do të kombinohet edhe me sektorin e logjistikës, duke përfutur nga pozita kyçe e bashkisë, e cila i siguron qasje të lehtë Bashkisë nga të gjitha drejtimet, në veri drejt Shkodrës, në jug drejt Tiranës, në lindje drejt Kukësit dhe Morinës dhe në perëndim në drejtim të bregdetit dhe portit të Durrësit. Qasja e lehtë dhe e shpejtë nga Bashkia drejt qendrave urbane fqinje dhe kryeqytetit, përveç numrit të konsiderueshëm të njerëzve që ju mundësohet të lëvizin çdo ditë për punë në Bashki, do të mundësohet gjithashtu edhe qarkullimi i produkteve.



Në kuadër të forcimit të pozitës kyçe të Bashkisë, rëndësi ka dhe lidhja e së rajonit me rrjetin hekurudhor të vendit, një vepër, e cila propozohet gjithashtu nga Plani i Përgjithshëm Kombëtar "Shqipëria 2030". Kështu, propozohet një rrjet hekurudhor, që lidh Kukësin dhe Kosovën, në jug do të kalojë përmes Rrëshenit në Klos dhe në fund do të lidhe Tiranën nëpërmjet Rubikut. Në këto zona, brenda Bashkisë Mirditë, propozohet të krijohen zona tregtare me hapësira për magazinimin dhe specifikimet e duhura për forcimin e sektorit të tregtisë.

Objektivi strategjik 2: Mbrojtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore të Bashkisë.

Mjedisi kulturor i Bashkisë, i cili bazohet në trashëgiminë e pasur historike të saj, në rezervën arkeologjike dhe arkitektonike, në aktivitetin kulturor lokal (evente, festime etj.) dhe në gjithë traditën popullore (zakonet dhe traditat, mitet, legjendat etj.), është veçanërisht i mrekullueshëm dhe propozohet të mbrohet dhe të promovohet më tej.

Bashkia disponon elemente të mrekullueshme të trashëgimisë kulturore që janë burime për zhvillimin e butë turistik përmes formave alternative të turizmit si turizmi kulturor, fetar, arkeologjik. Gjithashtu në këtë zonë, e kënaqshme është infrastruktura kulturore e tillë si muzetë, ekspozitat, etj. Përdorimi i burimeve kulturore dhe infrastrukturës pritet të rrisë dukshmërinë, njohjen e rajonit dhe identitetin e tij turistik, duke tërhequr vizitorë - turistë dhe në këtë mënyrë kemi bërë të mundur zgjerimin e ekonomisë lokale të Bashkisë.

Në elementët e trashëgimisë kulturore që propozohen të mbrohen, ose, disa prej tyre tashmë mbrohen, duhet të promovohen në mënyrë të përshtatshme, përfshir këtu burgu në Orosh (Burgu i Spaçit), një monument kombëtar, si edhe shtëpitë e vjetra – kulla të mirënjohura, të cilat janë shembuj të arkitekturës lokale. Një përqendrim i këtyre ndërtesave është identifikuar në ish Bashkinë e Oroshit.

Për më tepër, qëllimi i këtij studimi është promovimi i qytetit të Rrëshenit, i cili është një qendër e rëndësishme e Bashkisë. Për promovimin e qytetit të Rrëshenit, aktualisht janë në zbatim projekte të ndryshme rindërtimi, me synimin e krijimit të një profili më tërheqës dhe më interesant, dhe paralelisht është propozuar forcimi i shërbimeve publike, me qëllimin e mirë që si banorëve ashtu edhe vizitorëve t'ju shërbehet sa më mirë që të jetë e mundur.

Objektivi Strategjik 3: Mbrojtja dhe Menaxhimi i Qëndrueshëm i Mjedisit dhe Burimeve Natyrore.

Bashkia e Mirditës ka një numër të konsiderueshëm burimesh natyrore dhe peizazhe të cilat janë të njohura ose në proces njohje si monumente natyrore dhe që kanë nevojë për mbrojtje dhe promovim. Megjithatë, deri më sot, pasuria natyrore mbeten të pashfrytëzuara dhe ato janë potencial në drejtimin kyç për zhvillimin turistik të zonave.

Sipas situatës aktuale, duket se promovimi i monumenteve të natyrës nuk ka qenë prioritet i planifikimit të zhvillimit. Për këtë arsye, një objektivi i rëndësishëm për Bashkinë është mbrojtja dhe menaxhimi i qëndrueshëm i mjedisit dhe i elementeve të



tij natyrorë, në mënyrë që më vonë të mund të mbështesë veprime të tjera, siç janë format alternative të turizmit.

Përveç zonave të shpallura të mbrojtura propozohet të shpallet si zonë e mbrojtur edhe Mali i Munellës, i cili ndodhet në lindje të bashkisë, së bashku me zonat e tjera të mbrojtura, propozohet një korridor i gjelbër i mbrojtjes, ku një rol kyç do të ketë burime termale, ndërsa në përfundim të Bashkisë propozohet të zgjerohet zona aktuale mbrojtur e Rezervuarit Natyror të menaxhuar të Bërzanës. Qëllimi i studimit është që të ketë një menaxhim më të mirë dhe më efektiv i këtyre zonave natyrore me qëllim mbrojtjen e biodiversitetit dhe habitateve dhe promovimin e formave alternative të turizmit.

Në këtë objektiv strategjik, do të përfshihet gjithashtu edhe toka bujqësore pavarësisht faktit se në zonën e Bashkisë ajo nuk është shumë e përhapur. Sipërfaqet më të shumta bujqësore gjenden në njësitë administrative Rrëshen dhe Kthellë, ato shtrihen kryesisht në zonat anësore të lumenjve dhe përrrenjve. Fushat janë një burim i rëndësishëm ekonomik në rajon dhe për këtë arsye duhet të mbrohen nga çdo shtrirje e mundshme ndërtimi në të ardhmen, nga ndotja për shkak të përdorimit të tepërt të plehrave dhe pesticideve, nga çdo intensifikim i ardhshëm i tepruar në kulturat bujqësore, të cilat do të ulin cilësinë dhe rendimentin e tokës, si edhe nga rreziku i keqpërdorimit të ujit për ujitje.

Si rrjedhim, propozohet që të ketë rregulla përkatëse mjedisore për të mbrojtur mjedisin natyror dhe burimet e tij, por edhe për të adresuar rreziqet natyrore dhe artificiale që ndikojnë negativisht në cilësinë e tokës dhe mjedisit natyror në përgjithësi.

Përveç kësaj, duhet të merren masa për të adresuar problemet e ndotjes së tokës dhe ujërave nëntokësore të identifikuara në bashki, kryesisht për shkak të aktivitetit mineral, të cilat megjithëse nuk janë shqetësuese për zonën e studimit, por duhet të mbahen në vëmendje në të ardhmen.

Objektivi strategjik 4: Përmirësimi i cilësisë së jetës së banorëve.

Për arritjen e këtij qëllimi kërkohet kompletimi i infrastrukturës teknike dhe krijimi i një niveli të lartë të infrastrukturës sociale. Në të njëjtën kohë, banorëve duhet t'u jepen mundësi më të mira punësimi përmes rigjallërimit të ekonomisë së Bashkisë, siç e kemi përmendur në objektivat e mësipërme strategjike.

Ky qëllim strategjik ka për qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës së banorëve në secilën vendbanim, pavarësisht largësisë nga qendrat më të mëdha urbane të Bashkisë. Mjaftueshmëria e të mira materiale, pastërtia dhe higjiena e vendbanimeve, qasja në arsim dhe kujdes shëndetësor, rritja dhe përmirësimi i produktivitetit, mbrojtja dhe promovimi i pasurisë kulturore, do të çojnë në zhvillimin e komuniteteve të qëndrueshme, që do të ruajnë identitetin dhe barazinë e tyre ndaj ligjit.



Përveç kësaj, synohet të përmirësohet cilësia e jetës dhe mirëqenia e banorëve, përmes krijimit të mundësive për të gjithë qytetarët që të marrin pjesë në aktivitetet ekonomike përmes informimit dhe trajnimit profesional të të gjithë profesionistëve, përmes frymës së bashkëpunimit dhe solidaritetit të aktorëve prodhues dhe të gjithë qytetarëve ndërmjet tyre, përmes informimit të gjithë qytetarëve, për teknologjitë e reja të aplikuara dhe realizimin e aktiviteteve të mundshme inovative, në mënyrë që ata, të jenë në gjendje të punojnë në çdo mundësi ekonomike që ju paraqitet, por edhe për t'iu dhënë mundësi për të zhvilluar vet këto potenciale, me qëllim që rajoni të ketë orinetimin drejt zhvillimit ekonomik dhe me një përfitim të dukshëm për të gjithë qytetarët.

Një rol të rëndësishëm në përmirësimin e cilësisë së jetës së banorëve do të luajë përmirësimi i sistemit të infrastrukturës teknike. Do të duhet të zbatohen projektet e duhura për përmirësimin e qasjes së fshatrave më të largëta me bashkinë.

Pozita e bashkisë, siç kemi theksuar më lart, është e favorshme për shkak se përshkohet nga aksi trans-evropian E851, megjithatë do të duhet të tregohet kujdes edhe për qendrat e tjera të banimit të Bashkisë dhe lidhjen e tyre si me qytetin e Rrëshenit, ashtu edhe me rajonin e Lezhës dhe të Tiranës ku jetojnë shumë persona që punojnë në këtë bashki. Përveç kësaj, duhet të kihet kujdes në zgjidhjen e problemeve të identifikuar në seksionet rrugore (mungesa e shtrimit të sipërfaqeve përfundimtare, gjerësi e vogël, rrëshqitje të tokës) kryesisht në fshatrat malore, të cilat paraqesin siguri rrugore të limituar.

Për sa i përket infrastrukturës tjetër teknike, është e nevojshme të krijohet një rrjet i organizuar i kanalizimeve, dhe ndërtimi i një impianti për trajtimin e ujërave të ndotura, posaçërisht për qytetin e Rrëshenit, ndërsa për shkak të morfologjisë së tokës dhe distancave të vendbanimeve dhe madhësive të tyre të popullsisë, kërkohen impiante të trajtimit të ujërave të zeza gjithashtu edhe në Rubik, Fan dhe Kurbnesh. Për sa i përket mbeturinave komunale propozohet të rinovohet vendi i vjetër i deponimit të mbeturinave. Së fundi, për sa i përket infrastrukturës së mbetur teknike, duhet që rrjeti i furnizimit me ujë dhe me energji dhe i telekomunikacioneve të përmbushin nevojat e ardhshme të Bashkisë.

Në lidhje me infrastrukturën sociale, ajo do të duhet të jetë në gjendje t'i shërbejë nevojave themelore të banorëve të bashkisë, të ofrojë mundësi më të mira për punësim dhe strehim, dhe kështu të mund të flasim për një standard të përmirësuar të jetesës dhe mundësi më të mira në arsim, shëndetësi, aktivitete kulturore, etj. Në qytetet Rrëshen dhe Rubik, ku tashmë ekzistojnë disa nga infrastrukturat sociale, ato duhet të stimulohen dhe të përmirësohen, ndërsa në vendbanimet ku ka mangësi, duhet të parashikohet krijimi i tyre.



1.6.3. Parimet dhe politikat kryesore për çdo sistem

Për të arritur objektivat strategjike, që formësojnë strategjinë e zhvillimit dhe vizionin për Bashkinë, kualifikohen akse konkrete prioritetesh dhe politikash, siç po i paraqesim më poshtë.

OBJEKTIVA STRATEGJIKE 1: Rivitalizimi ekonomik i zonës nëpërmjet vlerësimit të pozitës kyç të Bashkisë.

Forcimi i ekonomisë lokale të Bashkisë në kombinim me pozicionin gjeografik të rëndësishëm do të çojnë në rigjallërimin ekonomik të rajonit dhe si rrjedhim në frenimin e fenomenit të shpopullimit dhe transferimit të tyre drejt qendrave të tjera të mëdha urbane në vend. Për zbatimin e Objektivit të Parë Strategjik, propozohen këto akse prioritare:

Aksi prioritar 1: Zhvillimi turistik i zonës.

Zhvillimi turistik i rajonit mbështetet kryesisht tek trashëgimia e pasur kulturore që ka bashkia, por edhe në resurset ekzistuese natyrore. Politikat dhe ndërhyrjet janë:

- Organizimi i formave të buta të turizmit alternativ në bazë të burimeve natyrore, njerëzore dhe kulturore që disponon Bashkia (turizmi malor, turistik, kulturor, fetar, natyror, etj.).
- Zhvillimi i sinergjive midis organizatave alternative të turizmit për menaxhim optimal dhe promovimin e burimeve të ndryshme turistike.
- Përmirësimi i infrastrukturës ndihmëse të turizmit (rrugët e shënuara, qendrat e informacionit, shtigjet, kioskat, etj.) dhe shërbimeve (ushqimi, mikpritja, etj.).
- Promovim i përshtatshëm turistik dhe organizimi i faqes së internetit të të gjitha burimeve të rëndësishme me informata dhe foto të përshtatshme.
- Organizimi i programeve të trajnimit për informimin dhe specializimin e potencialit njerëzor në turizëm.
- Ndërgjegjësimi i komunitetit lokal në lidhje me çështjet e zhvillimit të turizmit.

Aksi prioritar 2: Modernizimi dhe rritja e prodhimit primar.

Përforcimi i prodhimit primar përfshin përmirësimin cilësor të procesit dhe produktit të prodhuar, zvogëlimin e kostove të prodhimit, rritjen e konkurrueshmërisë dhe tregtueshmërisë së produkteve dhe së fundi rritjen e të ardhurave të gjeneruara. Politikat dhe ndërhyrjet individuale janë:

- Specializimi dhe intensifikimi i prodhimit të produkteve bujqësore që konkurrojnë në tregjet e brendshme dhe të jashtme përmes iniciativave të reja të investimeve.
- Kthim tek kulturat e reja alternative, kultivime organike me bimë të reja që prodhojnë produkte me vlera të larta ushqyese dhe farmaceutike, dhe që janë lehtësisht të adaptueshme me kushtet e kësaj zone.



- Ruajtja dhe rritja e varieteteve lokale (rrushi, qershitë, bimët medicinale, etj).
- Krijimi i kooperativave për trajtimin e përbashkët të problemeve të fermerëve, efektivitetin e menaxhimit të tyre, si edhe në porositë për pajisje, plehra, pesticide, etj, por edhe për informacionin dhe trajnimin e përbashkët të tyre.
- Mbështetje dhe trajnim për prodhuesit nga institucionet shkencore/kërkimore (p.sh. eksplorim i kulturave të reja fitimprurëse, cilësisë së tokës, shfrytëzimin e qëndrueshëm të ujit, masa për të përmirësuar cilësinë e produktit).
- Sigurimi i stimujve, veçanërisht për fermerët e rinj për të lehtësuar vendosjen e tyre fillestare dhe përshtatja strukturore e zotërimeve/ kulturave të tyre.
- Projekte konsolidimi në parcelat shumë të vogla të shpërndara, përqendrimin e tyre në të njëjtën zonë dhe bashkimin e parcelave të vogla të shumë pronarëve, në mënyrë që toka e kultivuar të jetë më e shfrytëzueshme.
- Modernizimi i sistemeve të ujitjes, duke respektuar ruajtjen dhe balancimin e burimeve ujore, duke shtuar projektet e menaxhimit të ujit, p.sh. duke krijuar rezervuarë të vegjël.
- Modernizimi i prodhimit të blegtorisë, forcimi i kapitalit blegtoral dhe specializimi i tij, krijimi i zonave të përshtatshme për kullotje dhe kultivim të bimëve për përdorimin e tyre në blegtori dhe menaxhim të qëndrueshëm të mbeturinave nëpërmjet kompostimit me krimba toke.

Aksi prioritar 3: Përforcimi i prodhimit dytësor dhe tregtisë logjistike.

Përforcimi i prodhimit dytësor duhet të përqendrohet si në përpunimin dhe standartizimin e produktit primar edhe në mbështetjen e prodhimit primar, por edhe në zhvillimin e sektorëve tradicionalë. Në të njëjtën kohë, në kontekstin e shfrytëzimit të pozitës kyçe të Bashkisë, propozohet kthesa në sektorin e tregtisë.

Në veçanti, propozohet:

- Krijimi i një zone industriale në një zonë të përshtatshme.
- Përforcimi i përpunimit të produkteve primare nëpërmjet krijimit të njërive agro-përpunuese, standardizimit dhe paketimit.
- Zbatimi i standardeve për rritjen e cilësisë dhe certifikimi i produkteve të përpunuara në lidhje me origjinën, mënyrën e prodhimit dhe përbërësit e tyre.
- Krijimi i një zone logjistike tregtare në një vend të përshtatshëm dhe afër infrastrukturës së nevojshme të transportit.

OBJEKTIVI STRATEGJIK 2: Mbrojtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore të bashkisë.

Trashëgimia e pasur historike e Bashkisë, arkeologjike dhe arkitekturore propozohet të mbrohen dhe forcohen me synim për të përmirësuar njohjen e rajonit dhe shtimin e turistëve. Në drejtim të këtij qëllimi strategjik, propozohen këto aksione prioritare:

Aksi Prioritar 4: Mbrojtja, promovimi dhe reklamimi i të gjitha monumenteve arkeologjike-kulturore të Bashkisë.



Qyteti Mirditës disponon dhe ofron një rezervë të pasur e cila është e rrethuar nga një histori interesante, që ka çuar në krijimin e një arkitekture të shquar (ndërtesa të njohuara si Kulla) dhe monumenteve të tjera me rëndësi lokale dhe kombëtare.

- Regjistrimi i ndërtesave të vlefshme të bashkisë.
- Rehabilitimi dhe përmirësimi i trashëgimisë monumentale me prioritet ndërtesat e mirënjohura të bashkisë (shtëpi të vjetra, Kullat etj).
- Mbrojtja dhe promovimi i monumenteve kulturore të Bashkisë (arkitekture, fetare, historike).
- Marrje e masave për mbrojtjen e monumenteve - përmes shpalljes së tyre, etj.
- Mirëmbajtja e monumenteve të mbrojtura të bashkisë.
- Përdorimi i butë turistik i burimeve kulturore, qofshin vende arkeologjike, gjeologjike, ndërtesa historike, ndërtesa tradicionale, festa lokale etj.
- Promovim dhe shënjim i monumenteve të mbrojtura të bashkisë.
- Zhvillim i sinergjisë me institucionet akademike në mënyrë që studentët të kontribuojnë në proceset e nevojshme për regjistrimin, analizat, dokumentimin, ruajtjen, restaurimin dhe reklamimin e burimeve kulturore.

Aksi prioritar 5: Përforsim, zhvillim dhe shfrytëzim i vendeve kulturore dhe aktiviteteve të reja kulturore.

Qëllimi i këtij aksi është shfrytëzimi i burimeve kulturore të Bashkisë dhe zhvillimi i formave alternative të turizmit (kulturore, fetar, arkeologjik etj.) që çojnë në tërheqjen e grupeve të ndryshme të turistëve. Për këtë qëllim, vëmendje do t'i kushtohet:

- Krijimi i hapësirave muzeale për promovimin e trashëgimisë kulturore të bashkisë.
- Krijimi i intenerarëve që lidhin monumentet e vlefshme kulturore me njëra-tjetrën (p.sh. burgun me 7 kishat, etj.).
- Mirëmbajtje e shtigjeve dhe rrugëve që çojnë në monumentet kulturore.
- Vendosje e kiosave të posaçme për ofrimin e informacionit për vizitorët dhe shitjen e suvenireve.
- Krijimi i broshurave reklamuese për atraksionet turistike në gjuhë të ndryshme.
- Përditësim i faqes së Bashkisë në lidhje me vendet kulturore dhe monumentet në rajonin e saj.
- Organizim i aktiviteteve kulturore (ekspozita, festime, festivale) për shfrytëzimin e burimeve kulturore dhe forcimin e turizmit.

OBJEKTIVI STRATEGJIK 3: Mbrojtja dhe Menaxhimi i Qëndrueshëm i Mjedisit dhe Burimeve Natyrore.

Përveç elementeve të mjedisit kulturor për Bashkinë Mirditë, objektivi strategjik i programit është mbrojtja dhe promovimi i monumenteve të natyrës. Propozohet promovimi i monumenteve natyrore, një veprim i cili ende nuk ka qenë një prioritet



për Bashkinë, në mënyrë që në të ardhmen të mund të mbështesë veprime të tjera në lidhje me format alternative të turizmit. Akset prioritare të propozuara për këtë objektiv strategjik janë si më poshtë:

Aksi prioritar 6: Mbrojtja dhe menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore.

Politikat dhe projektet që mbështesin mbrojtjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore kanë të bëjnë me:

- Përcaktimin e zonave të mbrojtura natyrore (p.sh. mali i Munellës, në lindje të bashkisë, Kunore - Kroj i Bardhë, etj.).
- Mbrojtja e biodiversitetit dhe habitateve nëpërmjet organizimit të duhur hapësinor të aktiviteteve të lejuara.
- Përcaktim i zonave me vlerë të lartë ekologjike dhe estetike për qëllimin e përdorimit të tyre turistik, duke ruajtur cilësinë e tyre të lartë ekologjike.
- Zbatimi i restaurimeve të nevojshme në zonat e privuara, aty ku kërkohet, për shembull, në vende jo të organizuara të deponimit të mbetjeve.
- Rritje e ndërgjegjësimit mjedisor të qytetarëve, në mënyrë që, fillimisht dhe para së gjithash të kuptojnë nevojën për grumbullimin e organizuar dhe deponimin e mbeturinave në vende të organizuara (landfill) dhe në të ardhmen të marrin pjesë në programet e riciklimit të produkteve inerte, plastike, qelqi, metali, letër, por edhe atyre organike komunale të ngurta, në mënyrë që në hapësirat e deponimit të mbeturinave që do të përcaktohet, në të ardhmen të përfundojnë vetëm mbetjet për deponim dhe jo gjithë totali i mbeturinave të ngurta komunale.
- Bashkëpunim ndërbashkiakë në çështje të menaxhimit të burimeve natyrore, me qëllim që të ketë një menaxhim të integruar dhe të qëndrueshëm, pasi është pranuar nga të gjithë se mjedisi dhe burimet natyrore nuk ndërpriten apo përshkohen nga kufijtë administrativë.

Aksi prioritar 7: Mbrojtja dhe përdorimi i qëndrueshëm i ekosistemeve pyjore.
Propozohet:

- Përfundim i plotë dhe zbatim i planeve të menaxhimit të pyjeve në zonat pyjore të mbrojtura (kushte, monitorimi i mbrojtjes etj.)
- Ripyllëzimi - krijimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës pyjore, si dhe mbrojtja nga zjarri.
- Instalimi i sistemeve bashkëkohore të parandalimit të zjarrit me sensorë dhe sistemi i monitorimit nga Bashkia.
- Marrja e masave për mbrojtjen kundër rreziqeve natyrore (siç është erozioni që ndikon negativisht në rigjenerimin natyror të pyjeve) nëpërmjet punimeve të përshtatshme hidrike të malit (p.sh. hartimi i rrjedhave me barriera mbajtëse).
- Monitorimi i zhvillimit të pyjeve me kalimin e kohës përmes imazheve të përshtatshme satelitore dhe sistemeve të informacionit gjeografik (GIS).
- Marrja e masave për mbrojtjen e sipërfaqeve pyjore nga kullotja.



Aksi prioritar 8: Mbrojtja dhe menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve ujore.

Vlera ekologjike, estetike dhe ekonomike e lumit Fan dhe degëzimeve të tij Fan i Vogël dhe Fan i Madh, të cilat paraqesin probleme ndotjeje kryesisht për shkak të ujërave të zeza urbane dhe mbetjeve industriale që derdhen në to, kërkojnë politikat e mëposhtme:

- Trajtimi i qëndrueshëm i ujërave të zeza për vendbanimet me më shumë se 2000 banorë.
- Ndërtimi i gropave septike për përqindjen e popullsisë që nuk mbulohet nga një rrjet kanalizimesh.
- Përdorimi racional i burimeve ujore, nga njëra anë, nëpërmjet projekteve të përshtatshme për rikuperimin e tokës, për ujitje, dhe nga ana tjetër, përmes aplikimit të praktikave bujqësore që synojnë reduktimin e përdorimit të ujit.
- Ndërtimi i rezervuarëve për ruajtjen e ujit, me qëllim reduktimin e përdorimit të ujit nga burime sipërfaqësore ose nëntokësore.
- Promovimi i praktikave të kultivimit (bujqësia organike) për të ndihmuar në uljen e përdorimit të inputeve (plehrave, pesticideve) dhe ndotjen e ujërave nëntokësore.
- Zhvillimi i bashkëpunimit me bashkitë fqinje dhe Drejtorinë e Ujërave të Rajonit për menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve ujore ndërkomunale (lumenjve, liqeneve dhe ujërave nëntokësore) përmes hartimit të një plani dhe programe të përshtatshme për zbatimin e masave specifike.

Aksi Prioritar 9: Mbrojtje dhe përdorim i qëndrueshëm i tokës bujqësore.

Bujqësia, përveç funksionit të saj themelor (prodhim produktesh dhe të tjera), ka një karakter multifunksional dhe ndikon në shumë nivele, si për shembull në mundësitë e punësimit dhe mbajtjen e popullatës lokale, në formësimin e peizazhit, në mbrojtjen e burimeve natyrore etj. Ky fakt bën të domosdoshme veprime e mëposhtme:

- Mbrojtja e tokës bujqësore me planifikim të përshtatshëm për të shmangur lokalizimin e veprimtarive të papërshtatshme rezidenciale, industriale.
- Minimizimi i përdorimit të plehrave dhe pesticideve, përdorimi kronik i tyre kontribuon jo vetëm në ndotjen e burimeve ujore, por edhe në reduktimin e cilësisë së tokës, e cila bëhet më pak produktive.
- Menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve ujore nën Boshtin Prioritar 8, për të mbrojtur pjellorinë e tokës.
- Përforcimi i tokës, me përmirësues toke, do të rezultoj nga kompostimi natyral ose kompostimi i mbeturinave të kafshëve dhe llumit nga impiantet e trajtimit të ujërave të zeza.

Aksi prioritar 10: Sensibilizimi mjedisor i komunitetit lokal.

Parametër katalitik për mbrojtjen e mjedisit natyror është trajnimi i duhur dhe informimi i popullatës lokale mbi çështjet e mbrojtjes dhe menaxhimit. Propozime



- Krijimi i Qendrave të informimit dhe ndërgjegjësimit mjedisor.
- Zbatimi i programeve të edukimit mjedisor në shkolla, duke filluar që me shkollën fillore.
- Organizimi i veprimtarive/degjësave për ndërgjegjësimin e qytetarëve për çështje që kanë lidhje me menaxhimin e burimeve ujore, hedhjen e mbeturinave, menaxhimin e ujërave të zeza dhe rreziqeve që krijohen për shëndetin e njeriut, mjedisin si edhe nga format e pakontrolluara të ndotjes.

OBJEKTIVI STRATEGJIK 4: Përmirësimi i cilësisë së jetës së banorëve.

Qëllimi për zhvillimin e qëndrueshëm të komuniteteve ka të bëjë me riaftësimin e një mjedisi të përmirësuar, cilësor dhe tërheqës ku njerëzit zgjedhin të jetojnë dhe punojnë.

Parimet bazë për arritjen e qëllimit janë plotësimi i infrastrukturës së nevojshme teknike dhe krijimi i një niveli të lartë të infrastrukturës sociale. Përveç kësaj, ajo duhet të ofrojë shërbime me një nivel të tillë që të gjithë banorët e Bashkisë të kenë mundësi të barabarta për punësim, arsim, kujdes shëndetësor, siguri etj. Për të përmirësuar cilësinë e jetës dhe mirëqenien e komunitetit lokal, prioritet u jepet akteve të mëposhtëm:

Aksi Prioritar 11: Përmirësim/modernizim i rrjeteve të shërbimeve urbane në qytet dhe në vendbanimet e tjera, përmirësimi i infrastrukturës teknike mjedisore.

Nevojitet një qasje e integruar e cila do të optimizojë efikasitetin e rrjetit, do të sigurojë shpërndarje të balancuar dhe do të të zvogëlojë ndikimin në mjedis. Në mënyrë të veçantë, propozohet:

- Projektimi dhe ndërtimi i rrjeteve të furnizimit me ujë për të plotësuar nevojat e tanishme dhe në të ardhmen për të gjitha vendbanimet e bashkisë dhe për të siguruar 24 orë furnizim me ujë.
- Projektimi dhe ndërtimi i rrjeteve të kanalizimeve, aty ku është ekonomikisht dhe teknikisht i lejueshëm. Në vendbanimet e zonës së studimit të cilat do të shërbehen nga gropa septike është thelbësore mirëmbajtja dhe hidroizolimi i duhur.
- Projektimi dhe ndërtimi i veprave për kullimin e ujërave të shiut, në bazë të intensitetit dhe kohëzgjatjes së reshjeve, frekuencën e zgjatjes së një përmbytjeje dhe shkallën e mbledhjes së ujërave. Është e nevojshme të merren parasysh fenomenet ekstreme të motit të ndodhura në vitet e fundit, si rezultat i ndryshimeve klimatike globale dhe në rast të mungesës së të dhënave për reshjet, propozohet përdorimi i metodave të pacaktuara (Fuzzy Logic), me qëllim të vlerësohet besueshmëria e mbledhjes së ujërave të shiut.
- Ndërtimi i sistemeve moderne të trajtimit të ujërave të zeza, të përshtatshme për ti shërbyer dhe vendbanimeve me popullsi të vogël.
- Për sa i përket menaxhimit të mbetjeve, janë të nevojshëm këto hapa:



- përcaktimi i alternativës më të mirë të asaj që parashikon Plani Kombëtar i Mbetjeve për Shqipërinë (Plani Kombëtar për Menaxhimin e Mbetjeve) dhe menaxhimin e mbetjeve në nivel vendor bashkiak;
 - kryerjen e studimeve të menaxhimit të mbetjeve në nivel rajonal (për secilin rajon), për shkak se menaxhimi i mbetjeve duhet të jenë i decentralizuar, por edhe strategjik (nuk është ekonomikisht i qëndrueshme ekzistenca e një landfill-i sanitar për çdo qytet apo bashki dhe për shkak të morfologjisë së terrenit, sasisë së vogël të mbetjeve,
 - një landfill sanitar mund të mbulojë disa qytete , pra më shumë se një bashki, nga ana tjetër menaxhimi i mbetjeve duhet të decentralizohet sepse nuk është ekonomikisht i qëndrueshëm transporti i mbetjeve larg nga burimi i tyre të prodhimit).
- Studimet Rajonale të Menaxhimit të Mbetjeve do të vlerësojnë sasinë e prodhimit të mbeturinave nga të dhëna të besueshme – dhe kjo është shumë e rëndësishme - dhe do të zbatojnë objektivat strategjike të Planit Kombëtar të Mbetjeve për landfillet, riciklimin dhe kompostimin. Për këtë arsye, do të përcaktojmë numrin dhe vendndodhjen e landfilleve të nevojshme që do të ndërtohen dhe do të përcaktojë objektivat për parandalimin e mbetjeve, minimizimin e mbetjeve, riciklimin dhe kompostimin e tyre. Është theksuar se komunat duhet të bashkëpunojnë në procesin e Studimit Rajonal të Menaxhimit të Mbetjeve për disa arsye: ky studim rajonal duhet të pranohet nga shoqëria, duke mbuluar në mënyrë të qëndrueshme nevojat e të gjitha qyteteve për administrimin e mbetjeve; dhe studimi rajonal do të zbatohet duke ndërtuar të gjithë infrastrukturën e nevojshme, për të mirën e bashkive dhe komunitetit vendas. Prandaj, është propozuar që duhet të ketë një transformim ligjor në mënyrë që bashkitë të mund të formojnë ndërmarrjet bashkiake për menaxhimin e mbetjeve në nivel vendor.
 - Rritja e ndërgjegjësimit publik dhe vetëdijes mjedisore, në mënyrë që të bëjë qytetarët të marrin pjesë në programet e riciklimit të produkteve të plastikës, qelqit, metalit, letrës dhe mbetjeve të ndërtimit, si dhe mbeturinave organike urbane (biosolide), me qëllimin e minimizimit të mbetjeve që do të hidhen në landfill-in e ardhshëm.
 - Përmirësim/modernizim i rrjetit energjetik.
 - Përmirësim/modernizim i rrjetit të telekomunikacionit.

Aksi prioritar 12: Përmirësimi, modernizimi i infrastrukturës dhe sistemeve të transportit.

Duke pasur parasysh se rrjeti rrugor është në shumicën e rasteve në një gjendje të keqe të pashtuar dhe problematikë në lidhjen ndërmjet pjesës perëndimore dhe asaj lindore, modernizimi i infrastrukturës së transportit është i një rëndësie të madhe dhe jetike. Lëvizje e qëndrueshme do të thotë transport pasagjerësh dhe mallrash të shpejtë, të sigurt dhe efikas, përmbushjen e të gjitha nevojave të transportit, daljen



nga izolimi gjeografik nëpërmjet transportitj dhe minimizimin e kostove të jashtme (rreziqe mjedisore, aksidente, etj.). Konsiderohen të nevojshme sa më poshtë:

- Modernizimi i rrjetit rrugor kryesor me punime asfaltimi, rindërtimi, përmirësimi të karakteristikave gjeometrike të rrugës dhe në veçanti të mirëmbajtja, si edhe hapjen e rrugëve të reja.
- Sigurimi i qasjes në mjediset e arsimit për të gjithë nxënësit, mësuesit
- Ndërtimi, restaurimi dhe përmirësimi i seksioneve rrugore brenda qytetit të Rreshënit dhe Rubikut.
- Krijimi i një sistemi transporti me Mjete të Transport Masiv, midis vendbanimeve dhe lidhja e tyre edhe me zonat e largëta.

Aksi prioritar 13: Përmirësimi i infrastrukturës sociale në të gjithë vendin sipas nevojës.

Në veçanti, propozohen veprimet e mëposhtme:

- Rindërtimi i ndërtesave shkollore që kanë nevojë për përmirësim/ riparime/ modernizim/ ngrohje.
- Ndërtimi i shkollave të reja, infrastrukturës shëndetësore, qendra kulturore etj. në varësi të nevojave dhe madhësive të parashikuara të popullsisë.
- Përmirësimi i mjedisve sportive aty ku është e nevojshme.

Aksi prioritar 14: Mbrojtja dhe përmirësimi i mjedisit të banimit/ndërtimet.

Për përmirësimin e mjedisit rezidencial, i cili ka të bëjë me funksionalitetin dhe estetikën, propozohen si në vijim:

- Rikonstrukcione/ rikualifikime urbane.
- Ruajtja e një ambienti të pastër urban, nëpërmjet menaxhimit të duhur të mbeturinave (nga asgjësimi i kazanëve aktual dhe furnizimi dhe i tyre përfundimtar referuar ricikilimit të produkteve).
- Promovimi i lëvizjes urbane të qëndrueshme (shëtitorët e këmbësorëve, korridoret për biçikleta, infrastrukturë për personat me aftësi të kufizuara etj.).
- Reformimi i zonave komunale (si parqe, terrene lojrash etj.).
- Shtimi i gjelbërimit urban aty ku ka mungesë.
- Sistemimi i përrrenjve që kalojnë pranë zonave të banuara.
- Ndërhyrjet në ndërtesat ekzistuese, me anë të restaurimit të fasadave termike, por jo vetëm etj.

Aksi prioritar 15: E-qeverisja dhe përmirësimi i infrastrukturës elektronike.

E-qeverisje i referohet futjes së teknologjisë së informacionit në administratën publike me qëllim që korrespondenca, menaxhimi dhe arkivimi i dokumenteve të bëhet tashmë në mënyrë elektronike.

Nëpërmjet këtij procesi do të minimizohen kostot e dërgimit dhe pranimit të shkresave ndërmjet organeve qeveritare, dhe si rrjedhim do të luftohet burokracia, do



të rritet transparencja, ndërkohë që qytetarët dhe bizneset do të shërbehen plotësisht dhe më lehtë, sidomos ata që janë larg nga qyteti Rreshënit.

Për këtë qëllim, është propozuar:

- Të zhvillohet infrastruktura për lidhjen e gjithë njësive administrative me rrjet interneti të teknologjisë bashkëkohore.
- Përforsim i infrastrukturës teknike dhe teknologjike në çështje të teknologjisë dhe kompjuterëve në shërbimet e bashkisë
- Përzgjedhja e programit të duhur software për të gjetur zbatim e-qeverisje.
- Trainimi i stafit të bashkisë për përdorimin e softuerit të ri.
- Krijimi i një baze të integruar të të dhënave për menaxhimin territorial të bashkisë.
- Të krijohet një Zyrë për Shërbimin e Qytetarëve në çdo njësi administrative, për të siguruar që të gjithë qytetarët dhe banorët e zonave të largëta do të kenë qasje në portoline-qeverisje, pavarësisht nga mosha dhe niveli i arsimimit të tyre.

1.6.4. Parashikime demografike

Në këtë paragraf paraqiten të dhënat e popullsisë për Bashkinë e Mirditës të zonës së studimit nga viti 2001 deri në vitin 2011 (regjistrimi i fundit zyrtar Census). Në veçanti, tabelat e mëposhtme tregohem të gjitha shifrat e popullsisë gjatë kësaj periudhe kohore, të cilat konfirmojnë një rënie të madhe të popullsisë. Paraqitja e këtyre të dhënave është bërë në diagramat 1.6.4.1 dhe 1.6.4.2. Nga të dhënat e tabelave, por dhe nga pamjet grafike dallohet në mënyrë karakteristike prirja e qartë e rënies së popullsisë në nivelin total të popullsisë së bashkisë Mirditë dhe të rajonit të saj. Kjo ulje justifikohet nga gjendja akute që paraqiten në ekonomi, si edhe prej mungesës së infrastrukturës dhe fondeve të investimeve si në nivel kombëtar ashtu edhe në këtë bashki objekt studimi. Faktet që kontribuojnë në rritjen e normës së emigracionit të qytetarëve drejt vendeve fqinje apo drejt qendrave kryesore urbane të vendit lidhen me kërkimin e kushteve më të mira të jetesës dhe gjetjes së një vendi pune.

Në mënyrë të veçantë, në Tabelën 1.6.4.1, vihet re një ulje e madhe e popullsisë së Bashkisë Mirditë dhe e njësive bashkiake që e përbëjnë atë. Bashkia Mirditë regjistroi një rënie prej -40.35% në regjistrimin e vitit 2011 në krahasim me regjistrimin e vitit 2001. Në lidhje me njësitë bashkiake, Selita ka shënuar rënien më të madhe në popullsi në krahasim me njësitë e tjera bashkiake të Bashkisë së Mirditës, të shkallës 70.56%, pastaj vjen Kaçinari me reduktim në shkallën-65.19%, Oroshi me -52.21%, Fani me -47.78%, Kthella me -39.68%, Rubiku me -34.82% dhe së fundi Rrëshen me -23.02%. Për sa i përket rajonit të Lezhës në të cilin bën pjesë kjo bashki, vihet re një rënie prej -12,07%. Si rrjedhim, është e kuptueshme se bashkia Mirditë, regjistron normën më të madhe të ndryshimit nga ajo e rajonit Lezhës, me 28.28%.



	Census 2001	Census 2011	Ndryshimi 2001-2011 (%)
FAN	5701	2977	-47,78
KAÇINAR	2919	1016	-65,19
KTHELLË	3662	2209	-39,68
OROSH	3974	1899	-52,21
RRËSHEN	11435	8803	-23,02
RUBIK	6833	4454	-34,82
SELITË	2531	745	-70,56
Bashkia MIRDITË	37055	22103	-40,35
Qarku LEZHË	158920	139733	-12,07

Tabela 1.6.4.1: Ndryshimi i popullsisë në Bashkinë Mirditë (regjistrimi 2001 dhe 2011), Burimi: INSTAT



Diagrama 1.6.4.1: Ndryshimi i popullsisë së Bashkisë Mirditë (regjistrimet 2001 & 2011), Burimi: INSTAT






Diagrama 1.6.4.2.: Ndryshimi i popullsisë në njësitë bashkiake të Bashkisë Mirditë (Burimi: INSTAT)

Sipas të dhënave të INSTAT, për sa i përket parashikimeve për popullsinë në një periudhë prej 20 vjetësh, shumica e prefekturave parashikohet të përballesh me një rënie të niveleve të lindjeve. Së bashku me rritjen e vdekjeve në të gjithë Shqipërinë, pritet të përballet me një rënie natyrore të popullsisë në të ardhmen.

Për sa i përket rajonit të Lezhës, është parashikuar të ketë një rënie natyrore (-0,001 në vitin 2031), duke reflektuar fillimin e hershëm të tranzicionit të fertilitetit, së bashku me migrimin masiv të brendshëm dhe të jashtëm që rajoni përballet deri në ditët e sotme. Më poshtë paraqitet një tabelë në nivel rajonal për Lezhën, ku përfshihet edhe bashkia që po studiohet, me evoluimin e popullsisë në një thellësi prej 20 vjetësh përmes tre (3) skenarëve.

	2011	Skenari 2031					
		high conc.	high deconc.	constant conc.	constant deconc.	low conc.	low deconc.
		MMMHC	MMMHD	MMMCC	MMMCD	MMMLC	MMMLD
Totali i popullsisë	139.733	115.816	112.079	116.345	113.536	116.776	114.999
Raporti i popullsisë 2031 me popullsinë 2011		0,83	0,8	0,83	0,81	0,84	0,82
% Popullsia e Shqipërisë	5	4	4	4	4	4	4

Tabela 1.6.4.2. Parashikime të popullsisë në thellësi të 20 vjeçarit për prefekturën Lezhë (Burimi: INSTAT)

Shënim: HC = migrimi i brendshëm i lartë dhe i përqendruar në hapësirë,
 HD = migrimi i brendshëm i lartë dhe i dekoncentruar në hapësirë,
 CC = migrimi i brendshëm konstant dhe i përqendruar në hapësirë,
 LC = migrimi i brendshëm i ulët dhe i përqendruar në hapësirë
 LD = migrimi i brendshëm i ulët dhe i dekoncentruar në hapësirë

Sipas tabelës së mësipërme, rajoni i Lezhës mund të ballafaqohet me një rënie të popullsisë prej 16.43% në 17.70% në skenarin optimist, nga 16.74% në 18.75% në skenarin e mesëm dhe 17.12% në 19, 79% në skenarin e pafavorshëm.



Sipas faktit që në rajon ashtu edhe në bashkinë nën studim, regjistrohet një rënie e popullsisë gjatë viteve deri në 2032 (sipas të dhënave të INSTAT-it), konsiderohet e nevojshme të merret parasysh mundësia e rritjes së vogël dhe graduale e popullsisë dhe në thelb të simulohet skenari më i keq.

Për simulimin e skenarit më të keq, fillimisht u krye reduktim i të dhënave të popullsisë, me qëllim për të simuluar shifrat e popullsisë në vitin aktual (2017), duke marrë parasysh dy versionet A dhe B.

- Në Versionin A, u krye vlerësimi i popullsisë, duke marrë parasysh ndërtesat. Në veçanti, u regjistrua numri i ndërtesave të banuara, në territorin e bashkisë, për ish njësitë bashkiake. Numri i ndërtesave u shumëzua me numrin e personave për familje (sipas të dhënave të INSTAT-it për Njësi Bashkiake). Pallatet (ndërtesa me më shumë se 2 kate) janë llogaritur veçmas për qytetet Rrëshen, Rubik dhe Reps, në mënyrë që të ketë më shumë saktësi në përllogaritje.
- Në Versionin B, popullsia u vlerësua duke marrë parasysh nxënësit. Kështu, në bazë të të dhënave të analizës (faza A), u regjistruan nxënësit e shkollave nëntë vjeçare të Bashkisë, sipas njërive bashkiake. U supozua se këta nxënës përbëjnë 10% të popullsisë dhe për rrjedhojë u përllogarit popullsia për çdo Njësi bashkiake.

Versionet A dhe B janë përdorur për shkak se të dhënat e regjistrimit të INSTAT nuk përputheshin me të dhënat e regjistrimit civil dhe për të pasur një qasje më realiste bazuar në të dhënat e analizës së mëtejshme. Në vazhdim të sa më lart, tabelat e mëposhtme tregojnë shifrat e popullsisë, pas reduktimit të tyre, për vitin referues 2017.

Versionin A	
	Popullsia 2017
FAN	5400
KAÇINAR	1700
KTHELLË	3400
OROSH	2900
RRËSHEN	9200
RUBIK	4900
SELITË	1500
Bashkia MIRDITË	29000

Versionin B	
	Popullsia 2017
FAN	2890
KAÇINAR	450
KTHELLË	1680
OROSH	1260
RRËSHEN	10800
RUBIK	3500
SELITË	1620
Bashkia MIRDITË	22200

Tabela 1.6.4.3: Të dhëna të popullsisë për bashkinë Mirditë, bazuar në versionin A dhe B, viti 2017

Për të simuluar skenarin më të keq, duke marrë parasysh si vit reference 2017, u përdor formula e interesit kompleks për parashikimin e evolucionit të popullsisë në të ardhmen. Mbulimi i skenarit më të keq konsiderohet i nevojshëm, pasi zhvillimi i



popullsisë do të përcaktojë nevojat e tanishme dhe të ardhshme për strehim. Si rrjedhim, parashikimi për një kërkesë më të lartë në të ardhmen do të mbulojë një kërkesë të vogël të mundshme, ndërsa e kundërta nuk mund të ndodhë dhe në të kundërtën do të shkaktojë probleme serioze.

Duke kombinuar rezultatet e metodës së komponentëve kryesore për popullsinë që paraqesin pakësim të popullsisë (sipas të dhënave të INSTAT) me dëshirën për të mbuluar skenarin më të keq, vlerësohet një rritje vjetore në një masë prej + 0.5% për Njësi Administrative shumë të vogla. Përsa u përket Njësi Administrative Fan, Kthellë, Rubik dhe Selitë vlerësohet një masë prej 0.8%, pasi parashikohet rritje më e lartë e popullsisë, në përputhje me vizionin e zhvillimit të Bashkisë dhe investimet që parashikohen të bëhen në vitet e ardhme. Përrjashtim bën Njësia Administrative e Rrëshenit, e cila rezulton me një normë më të lartë rritjeje të barabartë me + 1.0%. Kjo i detyrohet faktit se Njësia Administrative e Rrëshenit ka një popullsi më të madhe dhe diferencohet nga ana sociale dhe ekonomike prej Njësi të tjera Administrative, pori dhe përbën qendrën ekonomike të bashkisë në studim. Më konkretisht, ofron shërbime të ndryshme dhe veprimtari ekonomike (punëtori, zanatçinj të vegjël, dyqane, ofrim shërbimesh, etj.) më të shumta në krahasim me Njësitë e tjera administrative.

Formula e interesit kompleks është dhënë nga ekuacioni matematikor në vijim:

$$E_v = E_0 \cdot (1 + \rho)^v$$

Ku:

Ev: popullsia e parashikuar

Eo: popullsia e vlerësuar bazuar në dy versionet A dhe B

ρ : rritja vjetore e popullsisë

v: vitet për të cilat do të kryhet parashikimi

Referohet se parashikimet e projeksioneve të popullsisë bëhen çdo pesë vjet duke filluar nga viti bazë 2017, pas trajtimit të të dhënave të popullsisë në bazë të versioneve A dhe B, me parashikimin e parë për vitin 2022 dhe më pas në një thellësi prej 15 vjetësh, dmth deri në vitin 2032. Si rrjedhim parashikimi i popullsisë sipas tipit të interesit kompleks do të realizohet bazuar në vitin referencë 2017 (gjendja aktuale) fillimisht për vitin 2022 (faza A) dhe më pas në thellësi prej 15 vjetësh 2032 (Faza B).

Nga tabela 3 e këtij seksioni janë marrë vlerat e popullsisë së njësisë administrative që përbëjnë zonën e studimit për vitin bazë 2017. Më poshtë paraqiten analitikisht përllogaritjet për bashkinë në studim. Nga zbatimi i formulës së interesit kompleks rezulton:



Versioni A

Njësia Administrative Fan

$$E_0 = 5.400 \text{ banorë}$$

$$\rho = 0,8\%$$

$$v_1 = 2022-2017 = 5 \text{ (Faza A')}$$

$$v_2 = 2032-2017 = 15 \text{ (Faza B')}$$

$$E_{2022} = 5.400 \cdot \left(1 + \frac{0.8}{100}\right)^5 = 5.619,48 \approx 5.619$$

$$E_{2032} = 5.400 \cdot \left(1 + \frac{0.8}{100}\right)^{15} = 6.085,58 \approx 6.086$$

Bëhet rumbullakimi i vlerave, pasi nuk është e mundur të shprehet numri i banorëve me numra dhjetorë.

Njësia Administrative Kaçinar

$$E_0 = 1.700 \text{ banorë}$$

$$\rho = 0,5\%$$

$$v_1 = 2022-2017 = 5 \text{ (faza A')}$$

$$v_2 = 2032-2017 = 15 \text{ (faza B')}$$

$$E_{2022} = 1.700 \cdot \left(1 + \frac{0.5}{100}\right)^5 = 1.742,93 \approx 1.743$$

$$E_{2032} = 1.700 \cdot \left(1 + \frac{0.5}{100}\right)^{15} = 1.832,06 \approx 1.832$$

Njësia Administrative Kthellë

$$E_0 = 3.400 \text{ banorë}$$

$$\rho = 0,8\%$$

$$v_1 = 2022-2017 = 5 \text{ (faza A')}$$

$$v_2 = 2032-2017 = 15 \text{ (faza B')}$$

$$E_{2022} = 3.400 \cdot \left(1 + \frac{0.8}{100}\right)^5 = 3.538,19 \approx 3.538$$

$$E_{2032} = 3.400 \cdot \left(1 + \frac{0.8}{100}\right)^{15} = 3.831,66 \approx 3.831$$



Njësia Administrative Orosh

$E_0 = 2.900$ banorë

$\rho = 0,5\%$

$v_1 = 2022-2017 = 5$ (faza A')

$v_2 = 2032-2017 = 15$ (faza B')

$$E_{2022} = 2.900 \cdot \left(1 + \frac{0.5}{100}\right)^5 = 2.973,23 \approx 2.973$$

$$E_{2032} = 2.900 \cdot \left(1 + \frac{0.5}{100}\right)^{15} = 3.125,28 \approx 3.125$$

Njësia Administrative Rrëshen

$E_0 = 9.200$ banorë

$\rho = 1,0\%$

$v_1 = 2022-2017 = 5$ (faza A')

$v_2 = 2032-2017 = 15$ (faza B')

$$E_{2022} = 9.200 \cdot \left(1 + \frac{1.0}{100}\right)^5 = 9.669,29 \approx 9.669$$

$$E_{2032} = 9.200 \cdot \left(1 + \frac{1.0}{100}\right)^{15} = 10.680,91 \approx 10.681$$

Njësia Administrative Rubik

$E_0 = 4.900$ banorë

$\rho = 0,8\%$

$v_1 = 2022-2017 = 5$ (faza A')

$v_2 = 2032-2017 = 15$ (faza B')

$$E_{2022} = 4.900 \cdot \left(1 + \frac{0.8}{100}\right)^5 = 5.099,16 \approx 5.099$$

$$E_{2032} = 4.900 \cdot \left(1 + \frac{0.8}{100}\right)^{15} = 5.522,10 \approx 5.522$$

Njësia Administrative Selitë

$E_0 = 1.500$ banorë

$\rho = 0,8\%$

$v_1 = 2022-2017 = 5$ (faza A')

$v_2 = 2032-2017 = 15$ (faza B')



$$E_{2022} = 1.500 \cdot \left(1 + \frac{0.8}{100}\right)^5 = 1.560,97 \approx 1.561$$

$$E_{2032} = 1.500 \cdot \left(1 + \frac{0.8}{100}\right)^{15} = 1.690,97 \approx 1.691$$

E njëjta procedurë ndiqet për gjetjen e popullsisë edhe për versionin B. Rezultatet e parashikimit të popullsisë së Njërive Bashkiake nga zbatimi i formulës komplekse janë paraqitur në tabelën më poshtë.

Versionin A				
	Popullsia 2017	Parashikimi	Parashikimi	Rritja vjetore e popullsisë (p)
		2022	2032	
FAN	5400	5619	6086	0.8%
KAÇINAR	1700	1743	1832	0.5%
KTHELLË	3400	3538	3832	0.8%
OROSH	2900	2973	3125	0.5%
RRËSHEN	9200	9669	10681	1.0%
RUBIK	4900	5099	5522	0.8%
SELITË	1500	1561	1690	0.8%
Bashkia MIRDITË	29000	30203	32768	
Versionin B				
	Popullsia 2017	Parashikimi	Parashikimi	Rritja vjetore e popullsisë (p)
		2022	2032	
FAN	2890	3007	3257	0.8%
KAÇINAR	450	461	485	0.5%
KTHELLË	1680	1748	1893	0.8%
OROSH	1260	1292	1358	0.5%
RRËSHEN	10800	11351	12538	1.0%
RUBIK	3500	3642	3944	0.8%
SELITË	1620	1686	1826	0.8%
Bashkia MIRDITË	22200	23188	25302	

p: rritja vjetore e popullsisë (0,5%, 0,8% dhe 1%)

Tabela 1.6.4.4. Parashikimi i popullsisë për Bashkinë e Mirditës sipas tipit të interesit kompleks

Kështu, vërejmë se ka dy parashikime të popullsisë për vitin 2032, me versionin A popullsia do të jetë 32,768 persona dhe me versionin B popullsia e bashkisë do të jetë 25,302 banorë. Për shkak se diferenca midis dy skenarëve është e madhe, llogaritet mesatarja e dy rezultateve. Kështu, për vitin 2032 në Bashkinë e Mirditës propozohet që të krijohet infrastruktura sociale për një popullsi prej 29,035 banorë.



1.6.5. Rezervat e strehimit

Kjo pjesë do të japë informacion mbi gjendjen aktuale të banimit në Bashkinë Mirditë dhe në njësitë administrative që e përbëjnë atë. Do të bëhet një analizë e stokut të banesave që paraqet Bashkia e studimit dhe do të identifikohen nevojat për strehim në të ardhmen, sipas parashikimeve të rritjes të popullsisë në një periudhë prej 15 vjetësh ashtu siç është bërë në pjesën e mëparshme.

Për shkak të mungesës së të dhënave për situatën e strehimit në Bashkinë e studimit për vitin 2017, janë marrë si të supozuara të dhënat e inventarit të studimit të INSTAT-it për vitin 2011 (popullsia dhe strehimi) për analizimin e mëtejshëm të stokut të banesave. Më konkretisht:

- Përsa i përket ndërtesave të banimit, konsiderohet se në tërësinë e tyre mbeten të qëndrueshme nga viti 2011 deri në vitin 2017.
- Përsa i përket përqindjes të anëtarëve për familje, konsiderohet të jetë e qëndrueshme nga viti 2011 deri në vitin 2017.

Në vazhdim të supozimeve të mësipërme vazhdojmë me analizën e stokut të banesave.

Bazuar në të dhënat analitike, 41.32% e të gjitha banesave nuk janë të banuara, ndoshta për shkak të zhvendosjes së banorëve nga zonat rurale në ato urbane. Më konkretisht, Selita zotëron përqindjen më të madhe të banesave të pabanuara të vendit 64.92% e ndjekur nga Kaçinari me 58.66%, Fani me 52.65%, Oroshi me 51.48%, Kthellë me 50.84%, Rubiku me 30.95% dhe më në fund Rrësheni me 29.43%.

Tabela 1.6.5.1 paraqet banesat sipas përdorimit të tyre në Bashkinë e studimit.

Bashkia/Komuna	Statusi i banimit Occupancy status			
	Gjithsej	Banesë e banuar nga persona me vendbanim të zakonshëm	Banesë e banuar nga persona që nuk përfshihen në census ose destinuar për qëllime dytësore apo sezonale	Banesë e pabanuar
FAN	1166	550	8	608
KACINAR	554	229	87	238
KTHEJELLE	1007	492	0	515
OROSH	943	457	3	483
RRESHËN	2980	2080	30	870
RUBIK	1633	1126	18	489
SELITE	475	166	1	308
Total	8758	5100	147	3511

Tabela 1.6.5.1: Strehimi dhe lloji i përdorimit në bashkinë Mirditë, burimi: INSTAT

Në Bashkinë Mirditë nga 8,758 banesa (konvencionale) të listuara, 5,100 banesa janë banesa kryesore, 147 janë dytësore ose sezonale, ndërsa 3,511 banesa janë bosh. Më konkretisht, në Fan nga 1,166 banesa të regjistruara, 550 banesa janë kryesore, 8 janë dytësore ose sezonale, ndërsa 608 janë bosh. Në Kaçinar, nga 554 banesa të regjistruara, 229 banesa janë kryesore, 87 banesa janë dytësore ose sezonale, ndërsa 238 janë bosh. Në Kthellë nga 1.007 banesa të regjistruara 492 banesa janë kryesore, ndërsa 515 janë bosh. Në Orosh nga 943 banesa të regjistruara 457 banesa janë kryesore, 3 banesa janë dytësore ose sezonale, ndërsa 483 janë bosh. Në Rrëshen nga



2.980 banesa të regjistruara 2.080 banesa janë kryesore, 30 banesa janë dytësore ose sezonale, ndërsa 870 janë bosh. Në Rubik nga 1.633 banesa të regjistruara 1.126 banesa janë kryesore, 18 banesa janë dytësore ose sezonale, ndërsa 489 janë bosh. Në Selitë nga 475 banesa të regjistruara 166 banesa janë kryesore, 1 banese është dytësore ose sezonale, ndërsa 308 janë bosh. Siç u përmend më lart, numri i madh i banesave bosh në Bashkinë e Mirditës vjen ndoshta për shkak të faktit se është një bashki rurale dhe një pjesë e madhe e popullsisë është zhvendosur në zonat urbane.

Në lidhje me ekonominë familjare, pas analizës së kryer gjatë fazës së parë të studimit, vërehet se në shumicën dërmuese të njësive ekonomike familjare jeton një familje e vetme. Më konkretisht, në Bashkinë Mirditë, 82.12% (4.291) e njësive ekonomike familjare përbëhen nga një bërthamë familjare, pasuar nga njësitë ekonomike familjare me dy (2) ose më shumë bërthama familjare me një përqindje prej 9.65% (504). Përkatësisht, e njëjta situatë vërehet edhe në Njësitë Administrative të saj.

Bashkia/Komuna M	Lloji i NJEF-së				
	Gjithsej	NJEF-të pa bërthamë familjare	NJEF-të me një bërthamë familjare	NJEF-të me dy ose më shumë bërthama familjare	NJEF-të me bërthamë jo të vlefshme
FAN	2974	60	2275	471	168
KACINAR	1016	33	819	146	18
KTHEJELLE	2206	53	1707	376	70
OROSH	1899	52	1552	250	45
RRESHEN	8796	213	7353	1150	80
RUBIK	4452	117	3601	646	88
SELITE	745	23	592	114	16

Tabela 1.6.5.2: Numri i anëtarëve dhe lloji i NjEF (Burimi INSTAT)

Nga tabelat e mësipërme rezultojnë raportet e popullsisë dhe banesave në bashkinë e studiuar dhe Njësitë Administrative që e përbëjnë atë si dhe raporti i popullsisë sipas llojit të njësisë ekonomike familjare. Më konkretisht, bashkisë Mirditë i korrespondojnë 2.50 banorë për banesë, ndërsa çdo njësie ekonomike familjare i korrespondojnë 4.25 banorë. Aktualisht kemi Njësitë Administrative që e përbëjnë Bashkinë Mirditë, Fani 2.54 banorë për banesë dhe 5.37 për familje, Fan Kacinari 1.83 banorë për banesë dhe 4.44 për familje, Kthejella 2.18 banorë për banesë dhe 4.43 për familje, Oroshi 2.01 banorë për banesë dhe 4.15 për familje, Rrësheni 2.88 banorë për banesë dhe 4.08 për familje, Rubiku 2.72 banorë për banesë dhe 3.94 për familje dhe në fund Selita 1.57 banorë për banesë dhe 4.46 për familje. Në të gjitha Njësitë Administrative duket se ka banesa të mjaftueshme për të plotësuar nevojat për strehim. Megjithatë duhet të merret parasysh, banimi i dy ose më shumë familjeve në një njësi ekonomike familjare, ndoshta për shkak të kushteve të vështira ekonomike, pasi në rastin e rimëkëmbjes të ekonomisë, shumë familje kërkojnë banesë të pavarur.



REZULTATET KRAHASUESE TË POPULLSISË - STREHIMIT

Kjo pjesë paraqet rezultatet krahasuese bazuar në skenarët e analizuar më sipër, në lidhje me zhvillimin e popullsisë dhe gjendjen e strehimit në bashkinë Mirditë. Përveç kësaj, norma vjetore e rritjes së popullsisë llogaritet në mënyrë që të mbulojë mjaftueshmërinë e banesave në një periudhë prej 15 vjetësh nga viti bazë, që është viti 2017. Përsa i përket situatës të strehimit, siç u përmend më lart, janë marrë parasysh të dhënat e përfituara nga inventari i studimit të INSTAT 2011 pasi nuk ka të dhëna për vitin 2017. Raportohet gjithashtu se për nevojat e analizës si më poshtë u trajtuan të dhënat e popullsisë në raport me përqindjen e anëtarëve për njësi ekonomike familjare në mënyrë që të rezultojë përafërsisht numri i njësi ekonomike familjare për vitin 2017.

Për gjetjen e popullsisë për mbulimin e nevojave të strehimit në bashkinë e studimit, u përdorën 2 (dy) skenarë të ndryshimit të popullsisë (p). Skenari i parë ndjek modelin e evolucionit të popullsisë INSTAT, me një rënie të popullsisë prej -0.5%, ndërsa skenari i dytë është skenari më i keq me rritjen vjetore të popullsisë prej 0.5%, 0.8% ose 1%. Tabelat e mëposhtme tregojnë rezultatet krahasuese të popullsisë-strehimit, sipas skenarëve të përmendur më lartë për bashkinë e studimit dhe Njësitë Administrative që e përbëjnë atë, bazuar në versionet A dhe B, analizuar më parë.



Versioni A

	2011	2031 Scenario					
		high - conc.	high - deconc.	constant - conc.	constant - deconc.	low - conc.	low - deconc.
		MMMHC	MMMHD	MMMCC	MMMCD	MMMLC	MMMLD
Totali i popullsisë	139.733	115.816	112.079	116.345	113.536	116.776	114.999
Të gjitha banesat		45.419					
Raporti i të gjitha vendbanimeve për popullsi	3,08	2,55	2,47	2,56	2,50	2,57	2,53
Raporti i tanishëm i anëtarëve të familjes në familje		4,22					
Totali i ekonomive familjare	33.112	27.445	26.559	27.570	26.904	27.672	27.251
Raporti i të gjitha banesave për ekonomitë familjare	0,73	0,60	0,58	0,61	0,59	0,61	0,60
MIRDITE (Bashkia)							
	2017	Projection 2022		Projection 2032		p	
Totali Popullsia e përgjithshme (projeksion me -0.5)	29.000	28.282		26.900		-0,5%	
Të gjitha banesat		8.853					
Raporti i të gjitha vendbanimeve për popullsi	3,28	3,19		3,04			
Raporti i tanishëm i anëtarëve të familjes në familje		4,25					
Totali i ekonomive familjare	6.824	6.655		6.329			
Raporti i të gjitha banesave për ekonomitë familjare	0,77	0,75		0,71			



MIRDITE (Bashkia)				
	2017	Projection 2022	Projection 2032	ρ
Totali Popullsia e përgjithshme (projeksion me -0.5)	29.000	30.203	32.768	0,8%
Të gjitha banesat			8.853	
Raporti i të gjitha vendbanimeve për popullsi	3,28	3,41	3,70	
Raporti i tanishëm i anëtarëve të familjes në familje			4,25	
Totali i ekonomive familjare	6.824	7.107	7.710	
Raporti i të gjitha banesave për ekonomitë familjare	0,77	0,80	0,87	
MIRDITE (Bashkia)				
	2017	Projection 2022	Projection 2032	ρ
Totali Popullsia e përgjithshme (projeksion me -0.5)	29.000	31.643	37.675	1,76%
Të gjitha banesat		8.853		
Raporti i të gjitha vendbanimeve për popullsi	3,28	3,57	4,26	
Raporti i tanishëm i anëtarëve të familjes në familje			4,25	
Totali i ekonomive familjare	6.824	7.446	8.865	
Raporti i të gjitha banesave për ekonomitë familjare	0,77	0,84	1,00	

Tabela 1.6.5.3: Rezultatet krahasuese të popullsisë -banesave me përqindje ndryshimi të popullsisë (-0.5% dhe 0.5%), gjetja e popullsisë për të mbuluar strehimin për bashkinë Mirditë, versioni A

Tabela 1.6.5.3 paraqet të dhëna për Mirditën në nivel Qarku dhe Bashkie. Në nivel Qarku (Lezhë), sipas studimit të Institutit të Statistikës Shqiptar (INSTAT), popullsia mund të ulet nga 16.43% deri 19.79%. Duke pasur parasysh mjaftueshmërinë e strehimit ekzistues, vlerësohet se në vitin 2011 kemi një raport 1(një) banesë për 3.08 banorë, ndërsa për një periudhë 20 vjeçare ky raport parashikohet të arrijë nga 2.57 deri në 2.47 banorë për banesë. Kjo do të thotë se do të ketë një rritje të banesave bosh në të gjithë qarkun.

Përveç kësaj, në bazë të mesatares të anëtarëve për familje (4.22 banorë / njësi ekonomike familjare), llogaritet evolucioni i njësive ekonomike familjare dhe rrjedhimisht raporti ndërmjet banesave dhe njësive ekonomike familjare në një periudhë prej 20 vjetësh. Tabela tregon se në vitin 2011, rreth 73% e banesave në qark përdoren për qëllime banimi. Kjo përqindje mund të arrijë nga 61% deri në 58% në 20 vjet, duke shënuar një rënie prej -12% dhe -15% respektivisht.

Më konkretisht, në lidhje me bashkinë Mirditë, u krijuan dy skenarë. Skenari i parë ndjek modelin e rritjes të popullsisë sipas studimit të INSTAT-it, me një normë të reduktimit të popullsisë prej -0.5%, ndërsa skenari i dytë është skenari më i keq në të cilin parashikohet rritja vjetore e popullsisë prej 0.5%, 0.8% ose 1%. Duke simuluar modelin e zhvillimit të popullsisë në nivel bashkie, u konstatua se përqindja e



banesave që përdoren sot është 77% mund të reduktohet në 71%, duke shënuar një ndryshim prej -6% në 15 vjet. Përkundrazi, sipas skenarit më të keq, i cili parashikon rritjen e popullsisë, përqindja e përdorimit të banesave pritet të rritet nga 77% në 83%, duke shënuar një rritje prej 6%.

Megjithëse, sipas skenarit më të keq, vërehet një rritje e përdorimit të banesave, ekziston një përqindje banesash prej 17%, që mbeten të pashfrytëzuar. Për të bërë një vlerësim të plotë të riskut në lidhje me mjatushmërinë e strehimit, bazuar në rritjen e popullsisë në një periudhë prej 15 vjetësh, u përrllogarit ritmi i ndryshimit të popullsisë në mënyrë që të ketë mbulim total të strehimit në një periudhë prej 15 vjetësh, që është 1,76% për bashkinë Mirditë.

Në përputhje me modelin e mësipërm, janë bërë llogaritjet për Njësitë Administrative që përbëjnë bashkinë në studim. Tabelat e mëposhtme tregojnë përqindjen e ritmit të ndryshimit të popullsisë që kërkohet për të mbuluar banesat, për Njësitë Administrative që përbëjnë bashkinë e studimit sipas versionit A.

FAN				
	2017	projeksion 2022	projeksion 2032	p
Totali Popullsia e përgjithshme (projeksion me -0.5)	5400	5681	6288	1.02%
Të gjitha banesat	1170			
Raporti i të gjitha vendbanimeve për popullsi	4.62	4.86	5.37	
Raporti i tanishëm i anëtarëve të familjes në familje	5.37			
Totali i ekonomive familjare	1006	1058	1171	
Raporti i të gjitha banesave për ekonomitë familjare	0.86	0.90	1.00	
KAÇINAR				
	2017	projeksion 2022	projeksion 2032	p
Totali Popullsia e përgjithshme (projeksion me -0.5)	1700	1923	2462	2.50%
Të gjitha banesat	554			
Raporti i të gjitha vendbanimeve për popullsi	3.07	3.47	4.44	
Raporti i tanishëm i anëtarëve të familjes në familje	4.44			
Totali i ekonomive familjare	383	433	555	
Raporti i të gjitha banesave për ekonomitë familjare	0.69	0.78	1.00	
KTHELLË				
	2017	projeksion 2022	projeksion 2032	p
Totali Popullsia e përgjithshme (projeksion me -0.5)	3400	3730	4489	1.87%
Të gjitha banesat	1013			
Raporti i të gjitha vendbanimeve për popullsi	3.36	3.68	4.43	



Raporti i tanishëm i anëtarëve të familjes në familje	4.43			
Totali i ekonomive familjare	767	842	1013	
Raporti i të gjitha banesave për ekonomitë familjare	0.76	0.83	1.00	
OROSH				
	2017	projeksion 2022	projeksion 2032	p
Totali Popullsia e përgjithshme (projeksion me -0.5)	2900	3207	3920	2.03%
Të gjitha banesat	944			
Raporti i të gjitha vendbanimeve për popullsi	3.07	3.40	4.15	
Raporti i tanishëm i anëtarëve të familjes në familje	4.15			
Totali i ekonomive familjare	699	773	945	
Raporti i të gjitha banesave për ekonomitë familjare	0.74	0.82	1.00	
RRËSHEN				
	2017	projeksion 2022	projeksion 2032	p
Totali Popullsia e përgjithshme (projeksion me -0.5)	9200	10187	12492	2.06%
Të gjitha banesat	3058			
Raporti i të gjitha vendbanimeve për popullsi	3.01	3.33	4.08	
Raporti i tanishëm i anëtarëve të familjes në familje	4.08			
Totali i ekonomive familjare	2255	2497	3062	
Raporti i të gjitha banesave për ekonomitë familjare	0.74	0.82	1.00	
RUBIK				
	2017	projeksion 2022	projeksion 2032	p
Totali Popullsia e përgjithshme (projeksion me -0.5)	4900	5373	6460	1.86%
Të gjitha banesat	1638			
Raporti i të gjitha vendbanimeve për popullsi	2.99	3.28	3.94	
Raporti i tanishëm i anëtarëve të familjes në familje	3.94			
Totali i ekonomive familjare	1244	1364	1640	
Raporti i të gjitha banesave për ekonomitë familjare	0.76	0.83	1.00	
SELITË				
	2017	projeksion 2022	projeksion 2032	p
Totali Popullsia e përgjithshme (projeksion me -0.5)	1500	1684	2122	2.34%
Të gjitha banesat	476			



Raporti i të gjitha vendbanimeve për popullsi	3.15	3.54	4.46
Raporti i tanishëm i anëtarëve të familjes në familje	4.46		
Totali i ekonomive familjare	336	378	476
Raporti i të gjitha banesave për ekonomitë familjare	0.71	0.79	1.00

p: rritja vjetore e popullsisë

Tabela 1.6.5.4: Rezultatet krahasuese të popullsisë -banesave me ritmin e duhur të ndryshimit, gjendja e popullsisë për të mbuluar strehimin në Njësitë Administrative të bashkisë Mirditë, sipas versionit A

Për Njësinë Administrative Fan, duke simuluar modelin e evolucionit të popullsisë, u konstatua se përqindja e banesave të përdorura që sot është 86% mund të reduktohet në 80%, duke shënuar një ndryshim prej -6% në një periudhë prej 15 vjetësh. Në të kundërt, sipas skenarit më të keq, i cili parashikon rritjen e popullsisë, përdorimi i banesave pritet të rritet nga 86% në 93%, duke shënuar një rritje prej 7%. Edhe pse, sipas skenarit më të keq, ka një rritje në përdorimin e banesave, ekziston një përqindje banesash prej 7%, të cilat mbeten të pashfrytëzuara. Për të bërë një vlerësim të plotë të riskut në lidhje me mjatushmërinë e strehimit, bazuar në rritjen e popullsisë në një periudhë prej 15 vjetësh, u përllogarit ritmi i ndryshimit të popullsisë në mënyrë që të ketë mbulim total të strehimit në një periudhë prej 15 vjetësh, që është 1,02% për Njësinë Administrative Fan.

Për Njësinë Administrative Kaçinar, duke simuluar modelin e evolucionit të popullsisë, u konstatua se përqindja e banesave të përdorura që sot është 69% mund të reduktohet në 64%, duke shënuar një ndryshim prej -5% në një periudhë prej 15 vjetësh. Në të kundërt, sipas skenarit më të keq, i cili parashikon rritjen e popullsisë, përdorimi i banesave pritet të rritet nga 69% në 74%, duke shënuar një rritje prej 5%. dhe pse, sipas skenarit më të keq, ka një rritje në përdorimin e banesave, ekziston një përqindje banesash prej 26%, të cilat mbeten të pashfrytëzuara. Për të bërë një vlerësim të plotë të riskut në lidhje me mjatushmërinë e strehimit, bazuar në rritjen e popullsisë në një periudhë prej 15 vjetësh, u përllogarit ritmi i ndryshimit të popullsisë në mënyrë që të ketë mbulim total të strehimit në një periudhë prej 15 vjetësh, që është 2,50% për Njësinë Administrative Kacinar.

Për Njësinë Administrative Kthellë, duke simuluar modelin e evolucionit të popullsisë, u konstatua se përqindja e banesave të përdorura sot që është 76% mund të reduktohet në 70%, duke shënuar një ndryshim prej -6% në një periudhë prej 15 vjetësh. Në të kundërt, sipas skenarit më të keq, i cili parashikon rritjen e popullsisë, përdorimi i banesave pritet të rritet nga 76% në 82%, duke shënuar një rritje prej 6%. Edhe pse, sipas skenarit më të keq, ka një rritje në përdorimin e banesave, ekziston një përqindje banesash prej 18%, të cilat mbeten të pashfrytëzuara. Për të bërë një vlerësim të plotë të riskut në lidhje me mjatushmërinë e strehimit, bazuar në rritjen e popullsisë në një periudhë prej 15 vjetësh, u përllogarit ritmi i ndryshimit të popullsisë në mënyrë që të ketë mbulim total të strehimit në një periudhë prej 15 vjetësh, që është 1,87% për Njësinë Administrative Kthellë.



Për Njësinë Administrative Orosh, duke simuluar modelin e evolucionit të popullsisë, u konstatua se përqindja e banesave të përdorura sot që është 74% mund të reduktohet në 69 %, duke shënuar një ndryshim prej -5% në një periudhë prej 15 vjetësh. Në të kundërt, sipas skenarit më të keq, i cili parashikon rritjen e popullsisë, përdorimi i banesave pritet të rritet nga 74% në 80%, duke shënuar një rritje prej 6%. Edhe pse, sipas skenarit më të keq, ka një rritje në përdorimin e banesave, ekziston një përqindje banesash prej 20%, të cilat mbeten të pashfrytëzuara. Për të bërë një vlerësim të plotë të riskut në lidhje me mjatushmërinë e strehimit, bazuar në rritjen e popullsisë në një periudhë prej 15 vjetësh, u përllogarit ritmi i ndryshimit të popullsisë në mënyrë që të ketë mbulim total të strehimit në një periudhë prej 15 vjetësh, që është 2,03% për Njësinë Administrative Orosh.

Për Njësinë Administrative Rrëshen, duke simuluar modelin e evolucionit të popullsisë, u konstatua se përqindja e banesave të përdorura sot që është 74% mund të reduktohet në 68 %, duke shënuar një ndryshim prej -6% në një periudhë prej 15 vjetësh. Në të kundërt, sipas skenarit më të keq, i cili parashikon rritjen e popullsisë (në rastin e Rrëshenit 1%), përdorimi i banesave pritet të rritet nga 74% në 86%, duke shënuar një rritje prej 10%. Edhe pse, sipas skenarit më të keq, ka një rritje në përdorimin e banesave, ekziston një përqindje banesash prej 14%, të cilat mbeten të pashfrytëzuara. Për të bërë një vlerësim të plotë të riskut në lidhje me mjatushmërinë e strehimit, bazuar në rritjen e popullsisë në një periudhë prej 15 vjetësh, u përllogarit ritmi i ndryshimit të popullsisë në mënyrë që të ketë mbulim total të strehimit në një periudhë prej 15 vjetësh, që është 2,06% për Njësinë Administrative Rrëshen.

Për Njësinë Administrative Rubik, duke simuluar modelin e evolucionit të popullsisë, u konstatua se përqindja e banesave të përdorura sot që është 76% mund të reduktohet në 70 %, duke shënuar një ndryshim prej -6% në një periudhë prej 15 vjetësh. Në të kundërt, sipas skenarit më të keq, i cili parashikon rritjen e popullsisë përdorimi i banesave pritet të rritet nga 76% në 82%, duke shënuar një rritje prej 6%. Edhe pse, sipas skenarit më të keq, ka një rritje në përdorimin e banesave, ekziston një përqindje banesash prej 18%, të cilat mbeten të pashfrytëzuara. Për të bërë një vlerësim të plotë të riskut në lidhje me mjatushmërinë e strehimit, bazuar në rritjen e popullsisë në një periudhë prej 15 vjetësh, u përllogarit ritmi i ndryshimit të popullsisë në mënyrë që të ketë mbulim total të strehimit në një periudhë prej 15 vjetësh, që është 1,86% për Njësinë Administrative Rubik.

Për Njësinë Administrative Selitë, duke simuluar modelin e evolucionit të popullsisë, u konstatua se përqindja e banesave të përdorura sot që është 71% mund të reduktohet në 66 %, duke shënuar një ndryshim prej -6% në një periudhë prej 15 vjetësh. Në të kundërt, sipas skenarit më të keq, i cili parashikon rritjen e popullsisë përdorimi i banesave pritet të rritet nga 71% në 76%, duke shënuar një rritje prej 5%. Edhe pse, sipas skenarit më të keq, ka një rritje në përdorimin e banesave, ekziston një përqindje banesash prej 14%, të cilat mbeten të pashfrytëzuara. Për të bërë një vlerësim të plotë të riskut në lidhje me mjatushmërinë e strehimit, bazuar në rritjen e popullsisë në një periudhë prej 15 vjetësh, u përllogarit ritmi i ndryshimit të popullsisë në mënyrë që të



ketë mbulim total të strehimit në një periudhë prej 15 vjetësh, që është 2,34% për Njësinë Administrative Selitë.

Version B

	2011	2031 Scenario					
		high - conc.	high - deconc.	constant - conc.	constant - deconc.	low - conc.	low - deconc.
		MMAMHC	MMAMED	MMAMCC	MMAMCD	MMAMLC	MMAMLD
Totali i popullsisë	139733	115816	112079	116345	113536	116776	114999
Të gjitha banesat		45419					
Raporti i të gjitha vendbanimeve për popullsi	3.08	2.55	2.47	2.56	2.50	2.57	2.53
Raporti i tanishëm i anëtarëve të familjes në familje		4.22					
Totali i ekonomive familjare	33112	27445	26559	27570	26904	27672	27251
Raporti i të gjitha banesave për	0.73	0.60	0.58	0.61	0.59	0.61	0.60
MIRDITË (Bashkia)							
	2017	Projection 2022		Projection 2032		p	
Totali Popullsia e përgjithshme (projeksion me -0.5)	22200	21651		20592		-0.5%	
Të gjitha banesat		8853					
Raporti i të gjitha vendbanimeve për popullsi	2.51	2.45		2.33			
Raporti i tanishëm i anëtarëve të familjes në familje		4.25					
Totali i ekonomive familjare	5224	5094		4845			
Raporti i të gjitha banesave për ekonomitë familjare	0.59	0.58		0.55			
MIRDITË (Bashkia)							
	2017	Projection 2022		Projection 2032		p	
Totali Popullsia e përgjithshme (projeksion me -0.5)	22200	23188		25302		0.87%	
Të gjitha banesat		8853					
Raporti i të gjitha vendbanimeve për popullsi	2.51	2.62		2.86			
Raporti i tanishëm i anëtarëve të familjes në familje		4.25					
Totali i ekonomive familjare	5224	5456		5953			
Raporti i të gjitha banesave për ekonomitë familjare	0.59	0.62		0.67			
MIRDITË (Bashkia)							
	2017	Projection 2022		Projection 2032		p	
Totali Popullsia e përgjithshme (projeksion me -0.5)	22200	26469		37626		3.58%	
Të gjitha banesat		8853					
Raporti i të gjitha vendbanimeve për popullsi	2.51	2.99		4.25			
Raporti i tanishëm i anëtarëve të familjes në familje		4.25					
Totali i ekonomive familjare	5224	6228		8853			
Raporti i të gjitha banesave për ekonomitë familjare	0.59	0.70		1.00			

p: rritja vjetore e popullsisë

Tabela 1.6.5.5: Rezultatet krahasuese të popullsisë-banesave sipas ritemit të ndryshimit të popullsisë (-0,5% dhe 0,5%), gjendja e popullsisë për të mbuluar strehimin për Mirditë, sipas versioni B.

Përsa i përket Bashkisë Mirditë, sipas Skenarit B, u krijuan dy skenarë. Skenari i parë ndjek modelin e rritjes të popullsisë të INSTAT-it, me një normë reduktimi të popullsisë prej -0,5%, ndërsa skenari i dytë është skenari më i keq në të



parashikohet një rritje vjetore e popullsisë prej 0.5%. Duke simuluar modelin e zhvillimit të popullsisë në nivel bashkiak, u gjet se përqindja e banesave të përdorura sot që është 59% mund të reduktohet në 55% duke shënuar një ndryshim prej -4% në një periudhë prej 15 vjetësh. Në të kundërt, sipas skenarit më të keq, i cili parashikon rritjen e popullsisë, përdorimi i banesave pritet të rritet nga 59% në 64%, duke shënuar një rritje prej 5%.

Megjithëse, sipas skenarit më të keq, vërehet një rritje në përdorimin e banesave, megjithatë, ka një përqindje banesash prej 36%, që mbeten të pashfrytëzuara. Për të bërë një vlerësim të plotë të riskut, në aspektin e mjaftueshmërisë së banesave, bazuar në rritjen e popullsisë në një periudhë prej 15 vjetësh, norma e ndryshimit të popullsisë është llogaritur në mënyrë që të ketë mbulim total të strehimit në një periudhë prej 15 vjetësh, që është 3.58% për bashkinë Mirditë.

Në përputhje me modelin e mësipërm, janë bërë llogaritjet për Njësitë Administrative që përbëjnë bashkinë e studimit. Tabelat e mëposhtme tregojnë përqindjen e normës së ndryshimit të popullsisë që kërkohet për mbulimin e banesave, për Njësitë Administrative që përbëjnë bashkinë sipas versionit B.

FAN				
	2017	projeksion 2022	projeksion 2032	ρ
Totali Popullsia e përgjithshme (projeksion me -0.5)	2890	3745	6289	5.32%
Të gjitha banesat	1170			
Raporti i të gjitha vendbanimeve për popullsi	2.47	3.20	5.37	
Raporti i tanishëm i anëtarëve të familjes në familje	5.37			
Totali i ekonomive familjare	538	697	1171	
Raporti i të gjitha banesave për ekonomitë familjare	0.46	0.60	1.00	
KAÇINAR				
	2017	projeksion 2022	projeksion 2032	ρ
Totali Popullsia e përgjithshme (projeksion me -0.5)	450	793	2463	12.00%
Të gjitha banesat	554			
Raporti i të gjitha vendbanimeve për popullsi	0.81	1.43	4.45	
Raporti i tanishëm i anëtarëve të familjes në familje	4.44			
Totali i ekonomive familjare	101	179	555	
Raporti i të gjitha banesave për ekonomitë familjare	0.18	0.32	1.00	
KTHELLË				
	2017	projeksion 2022	projeksion 2032	ρ
Totali Popullsia e përgjithshme (projeksion me -0.5)	1680	2331	4488	6.77%
Të gjitha banesat	1013			
Raporti i të gjitha vendbanimeve për popullsi	1.66	2.30	4.43	
Raporti i tanishëm i anëtarëve të familjes në familje	4.43			



Totali i ekonomive familjare	379	526	1013	
Raporti i të gjitha banesave për ekonomitë familjare	0.37	0.52	1.00	
OROSH				
	2017	projeksion 2022	projeksion 2032	p
Totali Popullsia e përgjithshme (projeksion me -0.5)	1260	1839	3920	7.86%
Të gjitha banesat		944		
Raporti i të gjitha vendbanimeve për popullsi	1.33	1.95	4.15	
Raporti i tanishëm i anëtarëve të familjes në familje		4.15		
Totali i ekonomive familjare	304	443	945	
Raporti i të gjitha banesave për ekonomitë familjare	0.32	0.47	1.00	
RRËSHEN				
	2017	projeksion 2022	projeksion 2032	p
Totali Popullsia e përgjithshme (projeksion me -0.5)	10800	11334	12483	0.97%
Të gjitha banesat		3058		
Raporti i të gjitha vendbanimeve për popullsi	3.53	3.71	4.08	
Raporti i tanishëm i anëtarëve të familjes në familje		4.08		
Totali i ekonomive familjare	2647	2778	3059	
Raporti i të gjitha banesave për ekonomitë familjare	0.87	0.91	1.00	
RUBIK				
	2017	projeksion 2022	projeksion 2032	p
Totali Popullsia e përgjithshme (projeksion me -0.5)	3500	4293	6460	4.17%
Të gjitha banesat		1638		
Raporti i të gjitha vendbanimeve për popullsi	2.14	2.62	3.94	
Raporti i tanishëm i anëtarëve të familjes në familje		3.94		
Totali i ekonomive familjare	888	1090	1640	
Raporti i të gjitha banesave për ekonomitë familjare	0.54	0.67	1.00	
SELITË				
	2017	projeksion 2022	projeksion 2032	p
Totali Popullsia e përgjithshme (projeksion me -0.5)	1620	1773	2123	1.82%
Të gjitha banesat		476		
Raporti i të gjitha vendbanimeve për popullsi	3.40	3.72	4.46	
Raporti i tanishëm i anëtarëve të familjes në familje		4.46		
Totali i ekonomive familjare	363	398	476	
Raporti i të gjitha banesave për ekonomitë familjare	0.76	0.84	1.00	

p: rritja vjetore e popullsisë

Tabela 1.6.5.6: Rezultatet krahasuese popullsi- banesa sipas normës së kërkuar të ndryshimit, gjetja popullsisë për t'i populluar banesat në bashkinë Mirditë, versioni B



Për Njësinë Administrative Fan, duke simuluar modelin e evolucionit të popullsisë, është gjetur se përqindja e banesave që përdoren sot është 46% dhe mund të reduktohet në 43%, duke shënuar një ndryshim prej -3% në një periudhë prej 15 vjetësh. Përkundrazi, sipas skenarit më të keq, i cili parashikon rritjen e popullsisë, përdorimi i banesave pritet të rritet nga 46% në 50%, duke shënuar një rritje prej 4%. Edhe pse, sipas skenarit më të keq, ka një rritje në përdorimin e banesave, ekziston një sasi prej 50%, që mbetet e pashfrytëzuar. Për të bërë një vlerësim të plotë të riskut, në aspektin e mjaftushmërisë së banesave, bazuar në rritjen e popullsisë në një periudhë prej 15 vjetësh, norma e ndryshimit të popullsisë është llogaritur në mënyrë që të ketë mbulim total të strehimit në një periudhë prej 15 vjetësh, që është 5.32% për Njësinë Administrative Fan.

Në Njësinë Administrative Kaçinar, duke simuluar modelin e evolucionit të popullsisë, u konstatua se përqindja e strehimit që përdoret sot është 18% dhe mund të reduktohet në 17%, duke shënuar një ndryshim prej -1% në një periudhë prej 15 vjetësh. Në të kundërt, sipas skenarit më të keq, i cili parashikon rritjen e popullsisë, përdorimi i banesave pritet të rritet nga 18% në 20%, duke shënuar një rritje prej 2%. Edhe pse, sipas skenarit më të keq, ka një rritje në përdorimin e banesave, megjithatë, ekziston një përqindje strehimi prej 80%, e cila mbetet e pashfrytëzuar. Për të bërë një vlerësim të plotë të riskut, në aspektin e mjaftushmërisë së banesave, bazuar në rritjen e popullsisë në një periudhë prej 15 vjetësh, norma e ndryshimit të popullsisë është llogaritur në mënyrë që të ketë mbulim total të strehimit në një periudhë prej 15 vjetësh, që është 12.00% për Kaçinar.

Në Njësinë Administrative Kthellë, duke simuluar modelin e evolucionit të popullsisë, është gjetur se përqindja e banesave të përdorura sot është 37% dhe mund të reduktohet në 35% me një ndryshim prej -2% në një periudhë prej 15 vjetësh. Në të kundërt, sipas skenarit më të keq, i cili parashikon rritjen e popullsisë, përdorimi i banesave pritet të rritet nga 37% në 40%, duke shënuar një rritje prej 3%. Edhe pse, sipas skenarit më të keq, ka një rritje në përdorimin e banesave, megjithatë, ekziston një përqindje strehimi prej 60%, e cila mbetet e pashfrytëzuar. Për të bërë një vlerësim të plotë të riskut, në aspektin e mjaftushmërisë së banesave, bazuar në rritjen e popullsisë në një periudhë prej 15 vjetësh, norma e ndryshimit të popullsisë është llogaritur në mënyrë që të ketë mbulim total të strehimit në një periudhë prej 15 vjetësh, që është 6,77% për Kthellë.

Në Njësinë Administrative Orosh, duke simuluar modelin e evolucionit të popullsisë, u konstatua se përqindja e banesave që përdoren sot është 32% dhe mund të reduktohet në 30%, duke shënuar një ndryshim prej -2% në një periudhë prej 15 vjetësh. Në të kundërt, sipas skenarit më të keq, i cili parashikon rritjen e popullsisë, përdorimi i banesave pritet të rritet nga 32% në 35%, duke shënuar një rritje prej 3%. Edhe pse, sipas skenarit më të keq, ka një rritje në përdorimin e banesave, megjithatë, ka një përqindje të strehimit prej 65%, e cila mbetet e pashfrytëzuar. Për të bërë një vlerësim të plotë të riskut, në aspektin e mjaftushmërisë së banesave bazuar në rritjen e popullsisë në një periudhë prej 15 vjetësh, norma e ndryshimit të popullsisë u



Ilogarit në mënyrë që të ketë mbulim total të strehimit në një periudhë prej 15 vjetësh, që është 7.86% për Njësinë Administrative Orosh.

Në Njësinë Administrative Rrëshen, duke simuluar modelin e evolucionit të popullsisë, u konstatua se shkalla e banimit të përdorur sot është 87% dhe mund të reduktohet në 80%, duke shënuar një ndryshim prej -7% në një periudhë prej 15 vjetësh. Në të kundërt, sipas skenarit më të keq, i cili parashikon rritjen e popullsisë (ne rastin e Rrëshenit 1%), përdorimi i banesave pritet të rritet nga 87% në 100%, duke shënuar një rritje prej 13%. Sipas skenarit më të keq, vërehet mbipopullimi i banesave. Për të bërë një vlerësim të plotë të riskut, në kushtet e mjaftueshmërisë së banesave bazuar në rritjen e popullsisë në një periudhë prej 15 vjetësh, u llogarit shkalla e ndryshimit të popullsisë në mënyrë që të ketë mbulim të plotë (100%) të banesave në një periudhë prej 15 vjetësh, që është 0.97 % për Njësinë Administrative Rrëshen.

Është vërejtur se në Rrëshen, përqindja e banesave të përdorura është shumë e lartë në krahasim me pjesën tjetër të Njesive Administrative, me një rritje të popullsisë prej 0.97% që sjell si rezultat popullimin e banesave ekzistuese të përdorura për qëllime banimi. Për shkak të faktit se Rrësheni është qendra metropolitane e bashkisë, kjo rritje ka të ngjarë të ndodhë në Rrëshen brenda një periudhe 15 vjecare, me zbatimin e investimeve të planifikuara në zonë dhe zhvillimin e sektorit të turizmit dhe atij bujqësor.

Prandaj, çështja e mjaftueshmërisë së banesave në Rrëshen duhet të shqyrtohet me kujdes, pasi rimëkëmbja e mundshme ekonomike e bashkisë do të ketë si rezultat tërheqjen e biznesit dhe, në mënyrë të vazhdueshme të banorëve në Rrëshen. Gjithashtu, duhet të merret parasysh banimi i dy ose më shumë familjeve në një njësi ekonomike familjare, ndoshta për shkak të kushteve të vështira ekonomike, dhe në rastin e rimëkëmbjes ekonomike shumë familje mund të kërkojnë një banesë të pavarur.

Në Njësinë Administrative Rubik, duke simuluar modelin e evolucionit të popullsisë, u konstatua se përqindja e strehimit që përdoret sot është 54% dhe mund të reduktohet në 50%, duke shënuar një ndryshim prej -4% në një periudhë prej 15 vjetësh. Në të kundërt, sipas skenarit më të keq, i cili parashikon rritjen e popullsisë, përdorimi i banesave pritet të rritet nga 54% në 58%, duke shënuar një rritje prej 4%. Edhe pse, sipas skenarit më të keq, ka një rritje në përdorimin e banesave, ekziston një përqindje banesash prej 42%, e cila mbetet e pashfrytëzuar. Për të bërë një vlerësim të plotë të riskut, në kushtet e mjaftueshmërisë së banesave, bazuar në rritjen e popullsisë në një periudhë prej 15 vjetësh, norma e ndryshimit të popullsisë u llogarit në mënyrë që të ketë mbulim total të strehimit në një periudhë prej 15 vjetësh, që është 4.17% për Rubikun.

Në Njësinë Administrative Selitë, duke simuluar modelin e evolucionit të popullsisë, u konstatua se përqindja e banesave të përdorura që sot është 76% mund të reduktohet në 71%, duke shënuar një ndryshim prej -5% në një periudhë prej 15 vjetësh. Përkundrazi, sipas skenarit më të keq, i cili parashikon rritjen e popullsisë, përdorimi



i banesave pritet të rritet nga 76% në 82%, duke shënuar një rritje prej 6%. Edhe pse, sipas skenarit më të keq, ka një rritje në përdorimin e banesave, ekziston një përqindje banesash prej 18%, e cila mbetet e pashfrytëzuar. Për të bërë një vlerësim të plotë të riskut, në kushtet e mjaftueshmërisë së banesave bazuar në rritjen e popullsisë në një periudhë prej 15 vjetësh, norma e ndryshimit të popullsisë u llogarit në mënyrë që të ketë mbulim total të strehimit në një periudhë prej 15 vjetësh, që është 1,82% për Seliten.

KONKLUZIONE

Popullsia në Qarkun e Lezhës dhe në Bashkinë Mirditë parashikohet të bjerë ndjeshëm gjatë një periudhe 20-vjeçare (të dhënat e INSTAT-it), për shkak të rënies së lindjeve dhe rënies natyrore të popullsisë, si dhe për shkak të migrimin ndërkombëtar dhe të brendshëm drejt qendrave të mëdha ekonomike. Përkundër rënies së madhe të parashikuar në një periudhë prej 20 vjetësh, u gjykua e nevojshme të simulohet një skenar më i keq, me përdorimin e formulës së përbërë për të parashikuar evolucionin e popullsisë në të ardhmen. Mbulimi i skenarit më të keq konsiderohet i nevojshëm, pasi parashikimi për një kërkesë më të lartë në të ardhmen do të mbulojë një kërkesë të vogël të mundshme, ndërsa nuk mund të ndodhë e kundërta pasi do të krijojë probleme serioze.

Më konkretisht, është parashikuar që në Qarkun e Lezhës popullsia gjatë 20 viteve të ardhshme të reduktohet nga 16.43% në 19.79%. Sipas gjendjes ekzistuese të strehimit në qark, ka mjaftueshmëri të banesave boshe të rendit prej 30.45% të numrit të përgjithshëm të banesave Ky fakt tregon se përqindja e banesave bosh do të rritet. Në të kundërt, gjatë 20 viteve të fundit është vërejtur një shtim i ndërtimeve për qëllime banimi në qarkun e Lezhës, i cili, i kombinuar me rënien e madhe të popullsisë, ka rritur situatën ekzistuese të strehimit. Megjithatë, në Bashkinë Mirditë, ngritja e ndërtesave të banimit nuk ndjek modelin e qarkut, pasi gjatë 20 viteve të fundit është vërejtur se ka rënie në krahasim me 20 vitet e mëparshme, ndoshta për shkak të pakësimit të numrit të popullsisë.

Për Bashkinë Mirditë, janë marrë parasysh të dy (2) versionet, A dhe B, për të simuluar popullsinë në vitin aktual (2017). Në Versionin A, siç u përmend më lart, popullsia ndryshon duke marrë parasysh ndërtesat ekzistuese, ndërsa në Versionin B, popullsia ndryshon duke marrë parasysh nxënësit e shkollave 9-vjeçare në vitin 2017.

Më konkretisht, u simulua një model i evolucionit të popullsisë, në një periudhë prej 15 vjetësh nga viti bazë (2017), me një normë vjetore të ndryshimit prej -0.5% në mënyrë që të jenë në përputhje me të dhënat e INSTAT dhe një skenar më i keq, sipas formulës së përbërë, në mënyrë që të analizohet mjaftueshmëria e strehimit në rastin e rritjes së popullsisë me një normë ndryshimi prej 0.5%.

Në të dyja rastet, dhe në veçanti në rastin e skenarit më të keq, i cili paraqet interesin më të madh në aspektin e analizës së nevojave për strehim të ardhshëm, vërehet se mjaftueshmëria e banesave për familje në Versionin A është 17% për Bashkinë, ndërsa në Versionin B, është 36%.



Përveç kësaj, për vlerësimin e përgjithshëm të riskut dhe kuptimin më të mirë të nevojave për strehim në të ardhmen, u llogarit shkalla e evolucionit të popullsisë në një periudhë prej 15 vjetësh, në mënyrë që të sigurohet plotësia e banimit në nivel bashkie. Në mënyrë që të ketë plotësi në ndërtesat e përdorura për qëllime banimi, norma e ndryshimit të popullsisë në Versionin A duhet të jetë 1.76%, dhe në Versionin B deri 3.58% në vit. Siç mund të shihet, shkalla e ndryshimit e llogaritur për bashkinë e studimit është mjaft e madhe dhe nuk është në përputhje me zhvillimet aktuale të popullsisë në Shqipëri.

Në nivelin e Njësi Administrative që formojnë Bashkinë Mirditë, ndiqet i njëjti model në të gjitha Njësitë Administrative të Bashkisë. Më konkretisht, sipas versionit A, shkalla e ndryshimit të popullsisë, në mënyrë që të ketë plotësi në ndërtesat që përdoren për qëllime banimi, duhet të arrijë 1.02% për Fanin, 2.50% për Kacinarin, 1.87% për Kthellën, 2.03% për Oroshin, 2.06% për Rrëshenin, 1.86% për Rubikun dhe 2.34% për Selitën, ndërsa, sipas versionit B, shkalla e ndryshimit të popullsisë, në mënyrë që të ketë plotësi në ndërtesat e përdorura për qëllime banimi, duhet të arrije në 5.32% për Fanin, 12.00% për Kaçinarin, 6.77% për Kthellën, 7.86% për Oroshin, 4.17% për Rubikun dhe 1.82% për Selitën.

Përjashtim bën Njësia Administrative Rrëshen, ku sipas metodologjisë dhe analizës së mëparshme, shkalla e ndryshimit të popullsisë, për të pasur plotësi në ndërtesat e përdorura për qëllime banimi, duhet të jetë 0.97% shkallë rritje që Njësia Administrative mund të ketë me zbatimin e investimeve të planifikuara gjatë viteve të ardhshme, të cilat kanë për qëllim përmirësimin e infrastrukturës të zonës dhe zhvillimin e sektorit të turizmit dhe të bujqësisë, tërheqjen e biznesit të ri dhe rritjen e popullsisë, pasi Njësia Administrative Rrëshen është qendra metropolitane e bashkisë Mirditë, ku grumbullohet një numër i madh biznesesh dhe i shërbimeve për qytetarët.

Në përfundim, sipas të dhënave të përpunuara të popullsisë, të dhënave të INSTAT-it për situatën e strehimit si dhe metodologjisë dhe analizave të përdorura në seksionet e mësipërme në lidhje me evoluimin e popullsisë në krahasim me banesat ekzistuese, në periudhë 15 vjet, vihet re se sipas versionit A nuk ka nevojë të ndërtohen ndërtesa te reja për qëllime banimi për të mbuluar nevojat për strehim të ardhshëm.

Sipas versionit B, vihet re se nuk ka nevojë për ndërtimin e ndërtesave të reja rezidenciale për të mbuluar nevojat për strehim në të ardhmen, me përjashtim të Njësisë Administrative Rrëshenit, ku bashkia duhet të marrë parasysh me kujdes probabilitetin e rritjes së popullsisë me një ritëm më shumë se 0.97% për Rrëshenin, për të shmangur problemet e mjaftueshmërisë së banesave në vitet e ardhshme.

Gjithashtu, duhet të merret parasysh data e ndërtimit të banesave dhe gjendja e tyre, që janë faktorë të rëndësishëm që ndikojnë në mjaftueshmërinë dhe cilësinë e banesave dhe që veprojnë negativisht me kalimin e kohës.



1.6.6. Parashikimet financiare

Në mënyrë që parashikojmë planet e investimeve sipas prioriteteve, po analizojmë se si kanë lëvizur investimet e brendëshme dhe të huaja direkte në Shqipëri, në vitet e fundit. Në veçanti, në nivel vendi, niveli i investimet e huaja direkte, ka regjistruar në vitin 2013, krahasuar me vitin 2012, një rritje të konsiderueshme prej 41.90% (pas një rritjeje prej 5.62% në vitin e mëparshëm 2011). Në veçanti, vlera e investimet e huaja direkte në vitin 2013 arriti në 944.76 milionë euro ose rreth 10% të PBB. Sipas statistikave të fundit të publikuara nga Banka e Shqipërisë, shuma e investimeve të huaja direkte (FDI stock) në Shqipëri në vitin 2013 arriti në € 4,2 miliardë, duke shënuar një rritje prej 8% në krahasim me vitin 2012, ndërsa për të njëjtën periudhë fluksi i investimeve të huaja direkte arriti në 944.76 milionë euro, duke shënuar një rritje rreth 42% krahasuar me vitin 2012.

Investimet e Huaja Direkte (Stock) në Shqipëri 2003-2013, në milion €											
	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012*	2013*
IHD (Stock)	382,33	614,22	865	1.056,98	1.829,58	2.061,15	2.261,44	2.435,97	3.399,90	3.892,90	4.187,51
Transf.% vitin e mëparshëm		61%	41%	22%	73%	13%	10%	8%	40%	15%	8%

Tabela 1.6.6.1: Investime të Huaja direkte (Stock) në Shqipëri 2003-2013, në milionë € (Burimi: Banka e Shqipërisë)

Flukset hyrëse të investimeve të huaja direkte në Shqipëri 2003-2013, në milion €											
	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013**	semestri i parë 2014
Flukset hyrëse IHD	278,4	212,56	258,6	481,13	665,15	716,91	793,33	630,35	665,78	944,76	379,99
Transf.% vitin e mëparshëm		-24%	22%	86%	38%	8%	11%	-21%	6%	42%	

Tabela 1.6.6.2: Fluksi i Investimeve të Huaja Direkte në Shqipëri 2003-2013, në milionë € (Burimi: Banka e Shqipërisë)

Vlen të përmendet se gjatë 10 viteve të fundit shuma e përgjithshme e stoqeve të Investimeve të Huaja Direkte (IHD) u rrit me shpejtësi. Nga 382,33 milionë euro në vitin 2003, ajo ishte parashikuar në 4,2 miliardë euro në vitin 2013. Norma e rritjes së IHD në Shqipëri, edhe pse në rritje kjo shifër luhatet sepse është varësi e kushteve ekonomike ndërkombëtare dhe vendore.

Greqia është investitori kryesor i huaj në Shqipëri, duke zënë një pozicion të qëndrueshëm nga 2007 në 2013, me përjashtim të vitit 2011.

Në bazë të shifrave të rishikuara për vitin 2013, Greqia zotëron 26% të të gjitha IHD stoqeve në Shqipëri. Për të njëjtën periudhë, vende të tjera me përqindje të konsiderueshme të stokut total të IHD janë Kanadaja (19%), Italia (12%), Austria (10%), Holanda (9%) dhe Turqia 9%) dhe më pas vinë Gjermania, Qipro, Zvicra dhe Franca.

Pjesa më e madhe e stokut të IHD në Shqipëri kanë të bëjnë me transportin, magazinimin dhe komunikacionin (27%), ndërmjetësimin financiar (20%), minierat dhe guroret (18%). Me një përqindje më të ulët paraqiten sektorët e industrive të tjera (9%), të industrisë (8%), pasuri të patundshme (7%), ndërtim (3%), shitje me shumicë (3%), hotele dhe restorante (2%), ndërkohë që të gjithë sektorët e tjerë kalojnë pak ose nuk kalojnë shifrën prej 1% secila. Për sa i përket sektorit të investimeve, i cili parashikohet të jetë prezent në periudhën e ardhshme, dhe në veçanti gjatë pesë viteve të ardhshme, mendojmë se do të përqendrohet në:

1. Në programet evropiane (për shembull Balkan Med etj) që pritet të realizohen në periudhën tjetër të programimit
 - o IPA II (2014-2020)
 - o Shqipëria – kontributi financiar në kuadër të IPA II
 - o Interreg IPA CBC “Italy – Albania – Monstenegro” 2014-2020
 - o Interreg V-B “Mediterranean (MED)” Programme 2014-2020
2. Nga investimet nepermjet programit te investimeve publike që parashikohet se do të kryhen nga pushteti vendor.
3. Në investimet direkte të reja, që parashikohen se do të zbatohen në periudhën e ardhshme, nëpërmjet financimeve të tjera (p.sh. Banka Botërore, BEI, BERZH, investimet greko-shqiptare, investimet italiane-shqiptare etj.) dhe së fundi
4. Në investimet e pushtetit vendor- bashkitë e zonës së studimit që do të planifikojnë të ardhurat e veta, përmes formave të ndryshme të parashikuara ligjore dhe të reciprocitetit.

Për këtë qëllim, ne analizojmë veprimet e mësipërme në mënyrë që të njohim fushat e veprimit në të cilat bashkitë e zonës së studimit mund të përqendrohen.

A. Programe evropiane që do të zbatohen në periudhën e ardhshme programore

A.1 IPA II (2014-2020)

Instrumenti i Ndhmës së Para-Anëtarësimit (IPA) është instrumenti me të cilin BE mbështet reformat në "vendet e zgjerimit" me ndihmë financiare dhe teknike. Fondet e IPA forcojnë aftësitë e vendeve përgjatë gjithë procesit të pranimit, me rezultat zhvillime pozitive progresiste në rajon. Për periudhën 2007-2013, IPA kishte një buxhet prej rreth 11.5 miliardë euro, pasardhësi i tij, IPA II, do të mbështetet në rezultatet e arritura tashmë duke kushtuar 11.7 miliardë euro për periudhën 2014-2020.

Përfituesit e sotëm janë Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Maqedonia, Kosova, Mali i Zi, Serbia dhe Turqia.

Fondet e para-aderimit në BE janë një investim i shëndoshë në të ardhmen si për vendet e zgjerimit, ashtu edhe të vetë BE-së. Ato ndihmojnë përfituesit të ndërmarrin reforma politike dhe ekonomike, duke i përgatitur ata për të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga anëtarësimi në BE. Këto reforma duhet të ofrojnë tek qytetarët e tyre mundësi më të mira dhe të lejojnë zhvillimin e standardeve të barabartë me ato që



gëzojmë si qytetarë të BE-së. Fondet e para-aderimit ndihmojnë, gjithashtu që BE të arrijë objektivat e saj për sa i përket rimëkëmbjes së një ekonomie të qëndrueshme, furnizimin energjetik, transportet, mjedisin dhe ndryshimet klimatike, etj.

IPA II përcakton një kuadër të ri për ndihmën e para-anëtarësimit për periudhën 2014-2020. Risia më e rëndësishme e IPA II është fokusi i saj strategjik. Dokumentet e Strategjisë për çdo vend janë dokumentet specifike të planifikimit strategjik që janë përgatitur për secilin përfitues gjatë periudhës 7-vjeçare. Ato do të sigurojnë autonomi më të madhe nga përfituesit përmes integritit të programeve të tyre reformuese dhe të zhvillimit. Një dokument strategjik shumëkombësh do të shqyrtojë prioritetet për bashkëpunimin rajonal ose bashkëpunimin territorial.

Mekanizmi IPA II synon reformat brenda zonave të paracaktuara. Këta sektorë mbulojnë fusha të lidhura ngushtë me strategjinë e zgjerimit, të tilla si demokracia dhe qeverisja, shteti i së drejtës apo zhvillimi dhe konkurrenca. Kjo qasje sektoriale promovon reforma strukturore që do të ndihmojnë transformimin e një sektori të caktuar dhe përshtatjen e tij me standardet e BE. Lejon kalimin drejt një ndihme më të synuar, duke siguruar efektivitetin, qëndrueshmërinë dhe duke u fokusuar në rezultatet.

IPA II gjithashtu lejon një përdorim më sistematik të mbështetjes sektoriale të buxhetit. Së fundmi, i jep më shumë rëndësi matjes së performancës: treguesit e rënë dakord nga përfituesit do të ndihmojnë për të vlerësuar deri në çfarë mase janë arritur rezultatet e pritshme.

Shqipëria – kontributi financiar në kuadër të IPA II

Shpërndarja e financimit 2014-2020: 649.4 milionë euro. Fushat prioritare për financim gjatë kësaj periudhe janë: demokracia dhe qeverisja, shteti i së drejtës dhe të drejtat themelore, veprimi për mjedisin dhe klimën, transporti, konkurrenca dhe inovacioni, arsimi, punësimi dhe politikat sociale, bujqësia dhe zhvillimi rural, rajonal dhe bashkëpunimi territorial.

A2. Programi “Interreg IPA CBC Italy – Albania – Montenegro” 2014-2020

Programi "Interreg IPA CBC Itali-Shqipëri-Mal i Zi" është një program tre-palësh CBC bashkë-financuar nga Bashkimi Evropian përmes Instrumentit të Para-Anëtarësimit (IPA) gjatë periudhës së programimit 2014-2020. Programi është hartuar në kuadër të strategjisë evropiane për zhvillim të maturuar, gjithëpërfshirës dhe zhvillim të qëndrueshëm (Europa 2020). Ai synon të ndihmojë vendet pjesëmarrëse për të arritur objektivat e tyre kombëtare për vitin 2020, promovimin e bashkëpunimit ndërkufitar në të gjithë Mesdheun, në kuadër të ndihmës integruese të Shqipërisë dhe Malit të Zi për në Bashkimin Evropian. Programi është në përputhje me Strategjinë e gjerë makro-rajonale të BE për rajonin e Adriatikut dhe Jonit (EUSAIR) dhe ndihmon zonat e Adriatikut-Jonit, të Italisë, të Shqipërisë dhe Malit të Zi të arrijnë zhvillimin bazuar në katër akset e EUSAIR, zhvillimin blu, lidhjen e zonës, cilësinë e mjedisit dhe turizmin e qëndrueshëm.



Zona përfituese e programit mbulon një total prej 66.365 km² dhe një popullsi prej 7,805,809 banorësh, dhe përfshin:

Italia	Rajoni PUGLIA: provinca e Bari, BAT Barletta-Andria-Trani, Brindisi, Foggia, Lecce, Taranto RAJONE MOLISE: provincat e Campobasso dhe Isernia
Shqipëria	Të gjithë vendin
Mali I Zi	Të gjithë vendin

Buxheti i përgjithshëm i Programit arrin shumën prej 92,707,558.00 €.

Programi bashkë financohet nga instrumenti ndihmës i para anëtarësimit (IPA) me 85% dhe kërkohet një pjesë në bashkë-financimin shtetëror prej 15%. Objektivi kryesor i programit Interreg IPA CBC Itali-Shqipëri-Mal të Zi është forcimi i bashkëpunimit në rajonin e programi për trajtimin e sfidave të përbashkëta me qëllim forcimin dhe integrimin e zhvillimit territorial. Qëllimi i tij është për tu mundësuar autoriteteve rajonale dhe lokale, nga rajone të përzgjedhura, të ndajnë njohuritë dhe përvojën, të zhvillojnë dhe të zbatojnë projekte pilot, të testojnë realizueshmërinë e politikave të reja, produkteve dhe shërbimeve, dhe mbështetje të investimeve në fusha të interesit. Me zbatimin e programit do të shtohet numri i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, do të përmirësohet atraktiviteti i të mirave natyrore dhe kulturore me ofertën e shtuar të produkteve dhe shërbimeve të reja risi, do të përmirësohet mbrojtja e mjedisit, do të përmirësohet mënyra e menaxhimi të ujrave, do të ketë parandalim të fenomeneve bregdetare në pjesën e brendshme dhe mbrojtje të biodiversitetit; do të ketë rritje të qasjes ndërkufitare nëpërmjet shërbimeve dhe objekteve të transportit të qëndrueshëm, efikas dhe cilësor.

A3. Programi Interreg V-B "Mediterranean (MED)" Programme

Programi MED është një nga instrumentet për zbatimin e politikës së kohezionit të BE. Me këtë politikë, BE synon zhvillimin harmonik duke forcuar kohezionin ekonomik, social dhe territorial dhe duke inkurajuar zhvillimin në rajonet e BE dhe vendeve pjesëmarrëse. Programi është një vazhdim i programit transnacional të bashkëpunimit MED 2007-2013, i cili ka financuar 150 projekte për bashkëpunim në fushën e inovacionit, mjedisit, transportin detar dhe qeverisjen Mesdhetare. Udhëzimet e përgjithshme për vitet në vazhdim janë përcaktuar në strategjinë "Bashkimi Evropian 2020" me synim që BE të transformohet në një ekonomi të zgjuar, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse duke ofruar nivele të larta të punësimit, produktivitetit dhe kohezionit social.

Strategjia "Evropa 2020" së bashku me Axhendën Territoriale 2020, përbën kuadrin e përgjithshëm strategjik për politikën e kohezionit të BE për periudhën 2014-2020 dhe, si rrjedhim, për programin e MED. Programi ndërkombëtar MED mbështet shkëmbimin e përvojave, njohurive dhe përmirësimin e politikave publike midis autoriteteve kombëtare, rajonale dhe lokale dhe organeve tjera territoriale të rajoneve të përzgjedhura të rajonit MED. Përfshin 57 rajone nga 10 vende të ndryshme të BE



dhe 3 vende kandidatë. Financohet nga Fondi Rajonal European për Zhvillim (ERDF) me € 224.322.525 për periudhën kohore 2014-2020.

Për të gjithë sektorin e bashkëpunimit zbatohet një normë bashkëfinancimi prej 85% të ERDF.

Programi i kushton vëmendje të veçantë katër llojeve të sektorëve që përfaqësojnë sfida të rëndësishme për shkak të burimeve të tyre, të potencialit të tyre të zhvillimit ose vështirësisë financiare. Ato janë:

- Zona bregdetare me një nivel të lartë tërheqës, përqendrim të konsiderueshëm të operacioneve dhe brishtësi të burimeve natyrore dhe kulturore.
- Zona urbane, si qendra inovacioni dhe aktivitete socio-ekonomike të cilat përballen me sfida të forta në lidhje me ndotjen e mjedisit dhe emetimin e gazeve serë.
- Ishujt që mbulojnë 4% të Mesdheut dhe përfaqësojnë një dimension të madh ekonomik, mjedisor dhe kulturor të rajonit të MED. Të dyja janë të vendosura në udhëkryqin e akseve kryesore të komunikimit dhe në një situatë izolimi gjeografik.
- Zonat rurale dhe të largëta, janë të karakterizuara nga aktivitete rurale me dendësi të ulët të popullsisë. Zhvillimi i tyre pengohet nga izolimi gjeografik dhe/ose ndryshimet demografike dhe mjedisore. Kjo zonë karakterizon dhe bashkinë e Mirditës.

Objektivi kryesor i programit MED është që të kontribuojë në zhvillimin afatgjatë të rajonit të Mesdheut dhe në forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar midis rajoneve dhe vendeve të përfshira.

B. Investimet nga Plani i Investimeve Publike që parashikohen të kryhen

Nga të dhënat e disponueshme nga vitet e kaluara, vërehet se një pjesë e madhe e të ardhurave buxhetore të bashkisë janë drejtuar drejt investimeve në infrastrukturë, veçanërisht në fushat e arsimit, bujqësisë, pastrimit, ambienteve sportive të shkollave dhe mirëmbajtjes së rrjetit rrugor, me qëllim përmirësimin e këtyre shërbimeve në dobi të qytetarëve.

Vlerësimi i të ardhurave të Bashkisë së Mirditës bazohet në parashikimin e periudhave të mëpasme, në normën e inflacionit, në zhvillimin e popullsisë, në gjendjen e përgjithshme ekonomike, politikat e qeverisë së përgjithshme dhe pjesëmarrjen në zbatimin e programeve evropiane dhe të tjera. Parashikimet e të ardhurave për 15 vitet e ardhshme 2018-2032 janë paraqitur në tabelën më poshtë. Në veçanti, konsiderohet se të ardhurat totale të Bashkisë deri në vitin 2020 do të ndjekin parashikimin, siç është dhënë edhe nga vet Bashkia. Në vazhdim besojmë se rritja e të ardhurave do të jetë rreth 1.5% në vit, duke u bazuar në supozimet që japim deri në vitin e fundit e referencës që është 2032. Siç mund të shohim të ardhurat nga 468.62 milionë Lekë në vitin 2018 pritet për të arrijnë në 623.98 milionë Lekë në vitin 2032.

Shifrat e mësipërme janë paraqitur edhe në grafikun më poshtë, duke treguar lëvizjen e të ardhurave në vitet përkatëse.






Figura 1.6.6.1: Të ardhurat e Bashkisë për çdo tip të ardhurash në 15 vjeçarin 2018-2032 (në 000/ ALL)



	Mirdite															Totali
	Parashikimi 2018	Parashikimi 2019	Parashikimi 2020	Parashikimi 2021	Parashikimi 2022	Parashikimi 2023	Parashikimi 2024	Parashikimi 2025	Parashikimi 2026	Parashikimi 2027	Parashikimi 2028	Parashikimi 2029	Parashikimi 2030	Parashikimi 2031	Parashikimi 2032	
Te ardhura nga taksa	41103.50	41309.01	41515.56	42138.29	42770.37	43411.92	44063.10	44724.05	45394.91	46075.83	46766.97	47468.48	48180.50	48903.21	49636.76	673462.46
Te ardhura nga tarifat	44987.82	45212.76	45438.82	46120.40	46812.21	47514.39	48227.11	48950.51	49684.77	50430.04	51186.49	51954.29	52733.61	53524.61	54327.48	737105.32
Te ardhura nga shporta e prones dhe dhema me qera	2512.50	3525.06	2557.69	2575.76	2614.39	2653.61	2693.41	2733.81	2774.82	2816.44	2858.69	2901.57	2945.09	2989.27	3034.11	42166.22
Te ardhura nga ndërmarrjet e ndryshme	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Te ardhura te tjera	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Te ardhura te kushtezuara. Pakushtezuar	380022.00	405494.00	432396.00	438881.94	445465.17	452147.15	458929.35	465813.29	472800.49	479892.50	487090.89	494397.25	501813.21	509340.41	516980.31	6941464.17
Totali	468625.82	495540.83	521888.07	529716.39	537662.14	545727.07	553912.98	562221.67	570654.99	579214.82	587903.04	596721.59	605672.41	614757.50	623978.86	8394198.17

Tabela 1.6.6.3: Të ardhurat e Bashkisë për çdo tip të ardhurash në 15 vjeçarim 2018-2032 (në 000/ ALL)

	Mirdite															Totali
	Parashikimi 2018	Parashikimi 2019	Parashikimi 2020	Parashikimi 2021	Parashikimi 2022	Parashikimi 2023	Parashikimi 2024	Parashikimi 2025	Parashikimi 2026	Parashikimi 2027	Parashikimi 2028	Parashikimi 2029	Parashikimi 2030	Parashikimi 2031	Parashikimi 2032	
Shp. Per personelin	255441.00	269567.00	284474.00	288741.11	293072.23	297468.31	301930.33	306459.29	311056.18	315722.02	320457.85	325264.72	330143.69	335095.85	340122.28	4575015.8
Shp. Te tjera korrente	112523.00	118746.00	125313.00	127192.70	129100.59	131037.09	133002.63	134997.69	137022.66	139078.00	141164.17	143281.63	145430.85	147612.32	149826.50	2015329.8
Shpenzimet totale (me prapashum të investimeve)	367964.00	388313.00	409787.00	415933.81	422172.81	428565.40	434932.99	441456.98	448078.83	454800.02	461622.02	468546.35	475574.54	482708.16	489948.78	6590344.6
Shp. per invest	100661.82	107227.83	112101.07	113782.59	115489.32	117221.66	118979.99	120764.69	122576.16	124414.80	126281.02	128175.24	130097.87	132049.34	134030.08	1803853.4
Totali i shpenzimeve & investimeve	468625.82	495540.83	521888.07	529716.39	537662.14	545727.07	553912.98	562221.67	570654.99	579214.82	587903.04	596721.59	605672.41	614757.50	623978.86	8394198.1

Tabela 1.6.6.4: Shpenzimet e Bashkisë për çdo tip të ardhurash në 15 vjeçarim 2018-2032 (në 000/ ALL)



Kategoritë kryesore të shpenzimeve lidhen me kostot operacionale, detyrimet afatshkurtra dhe investimet.

Vlerësimet e kostove rezultojnë nga parashikimet e faktorëve që ndikojnë në shpenzimet e bashkisë, si gjendja e përgjithshme ekonomike, politikat drejtuese të qeverisë së përgjithshme, masat e miratuara për reduktimin e shpenzimeve të bashkisë, si edhe nga analiza e kërkesave të bashkisë për periudhën aktuale dhe vlerësimin e zhvillimeve të pritshme. Për sa i përket parashikimeve për 15 vitet e ardhshme 2018-2032, ne konsiderojmë se kostot totale të kësaj periudhe kohore do të ndjekin parashikimin, siç ai është dhënë nga vet bashkia, deri në vitin 2020, pasi më parë janë zbritur investimet. Në vazhdim konsiderojmë se rritja e shpenzimeve do të jenë e rendit prej 1.5% në vit, bazuar në supozimet e bëra deri në vitin e fundit referues që është në vitin 2032.

Nga të dhënat në tabelën e mësipërme, mund të shohim se për vitin 2018 shpenzimet e përgjithshme të vitit pritet të arrijnë në 367,96 milionë Lekë, ndërsa pritet të arrijnë afërsisht 489,95 milionë Lekë në vitin 2032. Këto shifra tregohen edhe në tabelë më poshtë, ku është paraqitur rrjedha e shpenzimeve në vitet përkatëse.




Figura 1.6.6.2: Shpenzimet e Bashkisë për periudhën kohore prej 15 vjetësh 2018-2032 (në 000/ ALL)

Totali i parashikuar i të ardhurave, bazuar në parashikime, pritet të jetë gjithsej 8.354 miliardë Lekë, ndërsa shpenzimet totale, për të njëjtën periudhë kohore, parashikohet të arrijnë në 6.59 miliardë Lekë, konstatohet se do të ketë një sufiçit pozitiv prej 1.803 miliardë Lekë, fakt i cili do të ndihmojë në masë të madhe, në zhvillimin e bashkisë, përmes investimeve edhe nga vet të ardhurat e saj. Rezultati neto që rezulton nga analiza e mësipërme, është shuma e investimeve që parashikohen të shpenzohet për periudhën kohore të viteve 2018-2032.



Duke pasur parasysh të gjitha, sa më sipër, vazhdojmë në prezantimin e investimeve të planifikuara për periudhën kohore të 15 viteve të ardhshme (2018-2032), me qëllim që të demonstrohet totali i investimeve në bashkinë e zonës së studimit.

Bazuar në të dhënat e bashkisë ne besojmë se investimet do të ndjekin parashikimin, siç ai është dhënë nga vet bashkia, deri në vitin 2020. Në vazhdim konsiderojnë se rritja e investimeve do të jetë rreth 1.5% në vit, bazuar në supozimet tona që parashikojmë të kemi deri në vitin e fundit referues, që është 2032.

Në bazë të të dhënave të mësipërme, investimet e pritshme janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Investime të parashikuara në milion ALL	
Viti	Mirditë
2018	100.661.820,00
2019	107.227.830,00
2020	112.101.070,00
2021	113.782.586,05
2022	115.489.324,84
2023	117.221.664,71
2024	118.979.989,68
2025	120.764.689,53
2026	122.576.159,87
2027	124.414.802,27
2028	126.281.024,30
2029	128.175.239,67
2030	130.097.868,26
2031	132.049.336,29
2032	134.030.076,33
Totali	1.803.853.481,82

Tabela 1.6.6.3: Investime të parashikuara për Bashkinë Mirditë për periudhën kohore të 15 viteve të ardhshme

Siç tregohet në tabelën e mësipërme, investimet totale, pritet të kalojë 1.8 miliardë ALL, një fakt i tillë pasqyrohet edhe në diagramin e mëposhtëm.






Figura 1.6.6.3: Investime të parashikuara për 15 vitet e ardhshme (në milion ALL)

C. Investimet e reja të drejtpërdrejta që do të realizohen në periudhën e ardhshme kohore, përmes rrugëve të tjera

Përveç investimeve që vijnë nga programet evropiane të financimit dhe programi i investimeve publike të Shqipërisë, parashikohen investime që nuk mund të përcaktohen sot dhe rrjedhin nga investimet e huaja direkte, përmes marrëdhënieve ndërkufitare, pjesë e të cilave do të zhvillohen edhe në bashkinë Mirditës.

Qeveria vendos në dispozicion të njësive administrative Fondin e Zhvillimit Rajonal (FZHR). Ky fond u krijua në Nëntor 2009 me ligjin nr. 10190 dhe që nga viti 2010 ka qenë përdorur për të mbështetur investimet në nivel rajonal dhe lokal. Qasja në financimin nga FZHR është e administruar nga një grant i dhënë i sistemit konkurruese (grantet konkurruese). Projektet vlerësohen mbi bazën e një rrjeti të vlerësimit, duke përdorur tregues të ndryshëm dhe rezultatet e tyre përkatëse, duke marrë parasysh rëndësinë e tyre për prioritetet strategjike të zhvillimit të Njësive Administrative. Një nga kriteret e vlerësimit është prania e bashkëfinancimit nga Bashkia. Ky nuk është një kusht i domosdoshëm pasi mungesa e mundësisë për bashkë-financim nuk është arsye e mjaftueshme për të përjashtuar financimin e një projekti nga ana e FZHR, por prania e tyre është sigurisht një element avantazhues. Sugjerohet, për këtë arsye, të përdoren fondet lokale, relativisht të pakta, për të bashkëfinancuar projektet që do i paraqiten për shqyrtim Fondit të Zhvillimit Rajonal. Qeveria vendos në dispozicion të njësive administrative Fondin e Zhvillimit Rajonal (FZHR).



D. Investime të bashkive të rajonit të studimit që do të vijnë nga vet të ardhurat, përmes formës së përfitimit

Investimet mund të rrjedhin edhe nga rritja e të ardhurave hyrëse të bashkisë përmes tarifave që mund të kontribuojnë në zhvillimin e ekonomisë lokale, rritjen e punësimi



dhe përmirësimin e infrastrukturës totale të zonës. Rritja e investimeve të kësaj kategorie ka të bëjë ekskluzivisht me politikat që do të zbatohen nga ana e Bashkisë dhe për çdo rast funksionojnë në mënyrë plotësuese, në totalin e programit të përgjithshëm të investimeve të saj dhe kontribuojnë në përmirësimin e infrastrukturës.

Konkluzione

Duke analizuar totalin e gjithë kategorive të investimeve, bëhet e qartë se gjatë 15 viteve të ardhshme, priten investime që do të tejkalojnë shifrën e 2,78 miliardë Lekë dhe do të vijnë kryesisht nga investime përmes:

1. Programeve evropiane të periudhës së tanishme dhe në të ardhmen.
2. Programit të investimeve publike.
3. Investimeve të huaja dhe rrugëve të tjera (p.sh. Banka Botërore, Banka Evropiane e Investimeve, Investimet italo-shqiptare etj).
4. Nga të ardhurat e veta, nëpërmjet formës së reciprocitetit apo partneriteti privat- publik.

Këto investime kryesisht pritet që të drejtohen:

- në sektorët e mjedisit (ujë, kanalizime, impiante trajtimi të ujërave të zeza, sisteme menaxhimi të mbetjeve, infrastruktura e transportit etj.).
- në zhvillimin e bizneseve të reja dhe përmirësimin/modernizimin e atyre ekzistuese dhe në promovimin e teknologjive inovative dhe praktikave pioniere.
- në zhvillimin e projekteve të efikasitetit energjetik dhe optimizimit.
- në investimet në zhvillimin turistik të bashkisë.
- në rritjen e konkurrencës përmes zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në sektorët e tregtisë dhe të shërbimeve.

Të cilat mund të japin një kontribut vendimtar në ndryshimin e peizazhit të rajonit.

Si përfundim, investimet e planifikuara pritet të jenë pole tërheqëse dhe faktor për zhvillimin e aktiviteteve të biznesit, si edhe një mjet për forcimin e kohezionit social. Bazuar në të dhënat e mësipërme, Bashkia do të zhvillojë dhe zbatojë një strategji specifike zhvillimi, e përshtatur plotësisht dhe në përputhje me fizionominë dhe nevojat e saj specifike. Komponentët kryesorë të strategjisë ekonomike do të bazohen në:

1. Zbatimin e një plani për rehabilitimin gradual ekonomik – vetë mbështetje ekonomike e cila do të përfshijë:
 - Uljen e kostos së shërbimeve dhe shpenzimeve
 - Përshtatjen e shpenzimeve me normat e rritjes së të ardhurave
 - Krijimin e infrastrukturës, stimujve dhe iniciativave për stimulimin e ekonomisë lokale
 - Shfrytëzimin e programeve kombëtare dhe evropiane për zhvillimin e infrastrukturës së zhvillimit
 - Njohjen dhe zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit



2. Shfrytëzimi i mundësive - perspektivave për zhvillimin e turizmit që do të përfshijë:
 - Shfrytëzimin dhe promovimin e thesareve, monumenteve natyrore dhe historike.
 - Krijimin e institucioneve kulturore, sportive dhe tregtare dhe infrastrukturave të fushës ndërkomunale dhe kombëtare.
3. Burimet e shfrytëzimit - ristrukturimi dhe përmirësimi cilësor i bazës prodhuese vendore që do të përfshijë:
 - Përkrahjen, promovimin dhe reklamimin e produkteve dhe shërbimeve vendore
 - Rritjen e sipërmarrjes lokale në të gjithë sektorët e prodhimit përmes trajnimeve dhe veprimeve të integruara
 - Shfrytëzimin e potencialit lokal në hulumtimin dhe inovacionin sipërmarrës.
4. Forcimi i qeverisjes lokale që do të përfshijë:
 - Përmirësimin e kapacitetit të vetëqeverisjes - shfrytëzimin e aftësive të qeverisjes elektronike.
 - Drejtimin e veprimeve përgatitore për ndërhyrjet zhvillimore - veprimet e rrjetëzimit dhe forcimin e pozitës së bashkisë në nivel ndër-rajonal.
 - Inkurajimin e Shoqërisë Civile

Objektivat e përgjithshme të zhvillimit të brendshëm (përmirësimi i kapaciteteve administrative të secilës bashki) synojnë përmirësimin e karakteristikave të mjedisit të brendshëm të saj dhe në fund të fundit përmirësimin e:

- efektivitetin (dmth, se sa rezultatet e secilit veprim të Bashkisë devijojnë nga objektivat e përcaktuara në Programin Operacional)
- efikasitetin (dmth, se sa veprimet e secilës bashki japin maksimumin e mundshëm të rezultatit me koston minimale të mundshme dhe në kohën minimale të mundshme) dhe
- legjitimitetin e funksionit të saj, dmth, se sa objektivat e secilës bashki ndryshojnë nga nevojat, vlerat dhe pritjet e të gjithë atyre që janë të përfshirë nga mjedisi i jashtëm dhe i brendshëm i saj.

1.6.7. Struktura e ndërtimeve

Bazuar në udhëzimet e PPK, objektivat e përgjithshme dhe ato specifike të këtij studimi dhe parashikimet mbi popullsinë dhe ekonominë, përcaktohen udhëzimet për zhvillimin e vendbanimeve dhe përmirësimin e mjedisit urban.

Kërkohet rritja e lidhjes dhe qasjes në dy nivele: qendrës së bashkisë me vendbanimet e mëdha dhe qendrat ekonomike të Shqipërisë, qytetet - porte të vendit dhe kryqëzimet kombëtare të transportit. Ndërkohë, i rëndësishëm është bashkëpunimi, si në nivel kombëtar (me pushtetin vendore dhe qendror, OJQ) ashtu edhe me bashkitë



fqinje dhe Prefekturën (në mënyrë të veçantë me këto) në drejtim të forcimit të pozitës dhe rritjes së saj duke maksimalizuar dhe stabilizuar përfitimet që do të rezultojnë nga zbatimi i strategjive dhe projekteve të propozuara.

Mjedisi i strukturuar i Bashkisë së Mirditës karakterizohet nga zhvillimi i shpërndarë i ndërtimit të banesave në tërë territorin e bashkisë. Duhet të ketë një kontroll mbi ndërtimet përmes ndalimit ose kufizimit të zhvillimit të banimit në zona të ndjeshme ose të papërshtatshme, ku krijohet një konflikt me përdorime konkurruese (p.sh. miniera, turizmi).

Bazuar në hierarkinë e rrjetit rezidencial nga PPK, vendbanimet e Bashkisë ndahen në tri nivele:

- Rrëshen: *qendër terciare*
- Rubik: *qendër lokale e specializuar*
- Vendbanime të tjera: *lokalitete*

Duke u fokusuar në nivelin vendor dhe në bazë të analizës dhe strategjisë së propozuar, kjo hierarki mbahet dhe stabilizohet roli i tyre bazuar në këtë nivel hierarik. Megjithatë, disa lokalitete, që kanë një rol të veçantë mund të përfitojnë një peshë specifike më të lartë nga zhvillimi lokal. Bëhet fjalë për qendrat e selive të njësive administrative dhe disa fshatra me elemente të rëndësishëm historik, kulturor dhe natyror (asete kulturore, historike dhe natyrore).

Gjithashtu, propozohet organizimi dhe koordinimi i dy rrjeteve rezidenciale, me qendër Bashkinë. Në nivelin e parë qendrat e njësive administrative do të funksionojnë në mënyrë plotësuese si qendra multifunksionale, por me orientim të ndryshëm zhvillimi. Në nivelin e dytë vendbanimet brenda çdo njësie administrative do të funksionojnë si një rrjet i hapur me infrastrukturë dhe operacione shtesë. Qëllimi është që të ketë sinergji në mes tyre (me mundësinë për tu integruar në rrjete, p.sh. kulturore, urbane, historike, turistike) dhe të kenë ndikim të shumëfishtë për komunitetin lokal.

Më konkretisht, për qendrën e Bashkisë, **Rrëshen**, drejtimet kryesore janë përforcimi dhe rigjenerimi, me theksin drejt qendrës. Ndërhyrjet për përmirësimet dhe rigjenerimet kanë të bëjnë me:

- (a) zonat qendrore të qytetit. Ky proces është në zhvillim e sipër dhe përfshin si hapësirat e strukturuarashtu edhe ato të lira,
- (b) zonat joaktive ose të degraduara, si ato afër përrenjve dhe lumenjve të cilat kanë mbetur të pashfrytëzuara, për shkak të rrezikut nga përmbytjet, por edhe për shkak se këto hapësira konsideroheshin të një rëndësie të vogël,
- (c) hapësirat komunale (p.sh. terrene sportive, kënde lojrash, parqe) të shpërndara në lagje të ndryshme,
- (ç) zonat e vjetra industriale të cilat aktualisht janë braktisur në masë të madhe dhe në kushte të caktuara mund të përdoren për aktivitete të reja ekonomike (si venddepozitime, njësi agro-përpunuese etj.)

(d) promovimi i vlerave historike dhe kulturore, siç është katedralja dhe historia e saj në këtë zonë, por jo vetëm, varrezat e dëshmorëve.

(e) ndërtimin e infrastrukturës moderne urbane dhe sidomos atë të energjisë dhe telekomunikacionit.

Mjedisi urban i përmirësuar është një faktor i rëndësishëm në rritjen e popullsisë dhe të biznesit. Për sa i përket stokut ekzistues të ndërtesave të cilat janë të braktisura apo degraduara, propozohet që të ripërdoret në rastet kur është e mundur (ose përndryshe të shfrytëzohet trualli) dhe/ose përmirësimi i tij, përmes aplikimit të mjeteve të përshtatshme dhe përcaktimit të përdorimeve të tokës dhe kushteve të zhvillimit.

Në të njëjtën kohë, propozohen pajisj të qendrës urbane me funksione dhe shërbime të plota dhe të nivelit të lartë:

- financiar
- tregtar
- social
- arsimor
- rekreativ dhe turistik
- bujqësor
- administrativ
- kulturor
- shëndetësor

Për sa i përket kufijve të qytetit dhe dendësisë së saj, promovohet dendësimi dhe rindërtimi i zonave më të reja rezidenciale, në mënyrë që të fitojnë një strukturë dhe formë të identifikueshme, të përmirësohet funksionimi i tyre dhe të bashkohen duke eliminuar ndërprerjet hapësinore. Zgjerimi me zona të reja, nëse është e nevojshme, duhet të bëhet me kujdes duke siguruar ndërlidhjen me qytetin dhe qendrën e tij dhe në pajtueshmëri me peizazhin.

Rubik është një qytet koheziv me dinamikë të konsiderueshme në sektorin terciar. Sipërfaqja e tij është e përcaktuar në mënyrë strikte, pasi ajo është e rrethuar nga elementë të qartë dhe pjesërisht të mbrojtur, natyrorë (lumi Fan, mali) dhe kulturor (zona e mbrojtjes së monumenteve). Në të njëjtën kohë, këto kufizime, janë gjithashtu dhe asete vendimtare për përmirësimin e cilësisë së jetës dhe tërheqjen e investimeve. Duke marrë parasysh sa më sipër, si drejtim kryesor për rigjenerimin dhe rizhvillimin është:

- Rigjenerimi për drejtimin e qendrave dhe zonave bregore nëpërmjet unifikimit në lagje, nëpërmjet përmirësimit të shërbimeve dhe hapësirave të ndryshme publike.
- Kërkohe përmirësimi i stokut ekzistues të ndërtesave dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm i hapësirave jo aktive.
- Transferimi i funksioneve të papajtueshme dhe funksioneve që kërkojnë sipërfaqe të madhe nga qendra drejt periferisë së qytetit, do të çlirojë hapësira të mëdha, si për krijimin e njësive të reja të banimit, ashtu edhe të hapësirave komunitare.



- Pajisja e qytetit me infrastrukturë të gjelbër do të reduktojë presionet mbi mjedisin, do të përmirësojë kushtet e jetesës dhe do të lehtësojë - pasurojë qasjen e banorëve dhe të vizitorëve në zonat e vlefshme natyrore dhe kulturore dhe në aktivitetet rekreative.
- Zona e fabrikave të vjetra, pas përdorimit të saj, do të shfrytëzohet si hapësirë pritjeje për infrastrukturën teknike dhe zonat e gjelbra dhe rekreative.

Lokalitetet në përgjithësi tregojnë një pamje të ngjashme në lidhje me strukturën hapësinore (përbëhen nga pjesë të ndara - lagje, të distancuara midis tyre dhe jo të lidhura drejtpërdrejt), dendësi (e shpërndarë, e rrallë, me hapësira të unifikuara të kultivuara), me madhësinë (popullsia e vogël) dhe me nivelin e shërbimit (pothuajse rezidenca ekskluzive dhe objekte rurale). Zhvillimi në Lokalitete duhet të respektojë dhe të jetë në përputhje me karakterin e tyre rural, por gjithashtu ti shërbejë, me disa kushte, zhvillimit turistik të formave alternative. Kjo gjë që është e mundur në disa fshatra. Për të përmirësuar strukturën, formën dhe funksionin duhet konsolidimi i tyre duke ndjekur paralelisht kufizimin etendencës së shpërndarjes, në mënyrë që të përmirësohet infrastruktura sociale dhe teknike dhe të krijohet një ind lidhor. Zgjerimet e strehimit duhet të jenë të kufizuara në varësi të gravitetit dhe rolit të vendbanimit. Përfundimisht mund të ketë infrastruktura që i shërben prodhimit bujqësor dhe blegtoral.

Përveç kësaj, propozohen strategji të:

- ndërhyrjeve urbane si ato të zgjeruara, sikundër është përmirësimi i qendrës, ose në pika të caktuara, sikundër është krijimi i hapësirës së sheshit të përbashkët dhe/ose i këndit të lojrave për fëmijë, ndërtimi i hapësirës komunitare (multifunksionale, sociale apo kulturore), mirëmbajtja-përmirësimi i infrastrukturës së shëndetit dhe arsimit.
- ndërhyrjeve mjedisore, p.sh. përcaktim kufijsh - mbrojtje e zonës së bregut të lumit , mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore/rreziqet (të tilla si erozioni), restaurim i ndërtesave të mirënjohura për vlerat e tyre - monumente kulturor.

Në përgjithësi, mbrojtja dhe promovimi i monumenteve kulturore dhe ruajtja e karakterit arkitektonik do të nxisë zhvillimin e turizmit përmes tërheqjes së vizitorëve dhe si pasojë rritjen e sipërmarrjes lokale.

1.6.8. Niveli i cilësisë së mjedisit

Zhvillimi i qëndrueshëm i zonës lidhet drejtpërdrejt me nivelin e lartë të mbrojtjes dhe përmirësimit të cilësisë së mjedisit. Me fjalë të tjera, proceset e zhvillimit, nuk duhet të rrezikojnë cilësinë e jetës së gjeneratave të ardhshme nga pikëpamja e mjedisit natyror dhe burimeve natyrore të cilat nuk janë të pashtershme. Prandaj, bazuar në udhëzimet e qëndrueshmërisë, si mjedis natyror cilësor për Bashkinë Mirditë, do të konsiderohet sigurimi i ujrave të pastra (nëntokësore dhe sipërfaqësore) mungesa e ndotësve të ajrit, tokat pjellore, kufizimi i zhurmës dhe peizazhi natyror i padëmtuar.



Përcaktimi i nivelit të cilësisë së mjedisit, kërkon ekzistencën e disa standardeve, në rastin më të mirë atyre kombëtare, evropiane ose ndërkombëtare.

Cilësia e ujit

Sa i përket cilësisë së ujit, kjo varet në masë të madhe nga menaxhimi i mbeturinave dhe ujërave të zeza të zonave urbane dhe industriale. Mbeturinat urbane ose industriale depozitohen pa kontroll menaxhues gjithëandej, transportohen nga uji dhe ajri dhe shpërndahen në një sipërfaqe më të madhe. Menaxhimi i tyre deri më sot ka çuar në rëndimin e gjendjes dhe uljen e cilësisë së ujit, ajrit. Për këtë arsye konsiderohet i nevojshëm menaxhimi i mbeturinave, i cili do të synojë në largimin e mbeturinave dhe depozitimin e tyre në Landfille, duke respektuar të gjitha kushtet e nevojshme mjedisore.

Uji, duke pasur shkëmbime të vazhdueshme të lëndës me pjesën tjetër të mjedisit, pasurohet me metale toksike të rënda si zhiva dhe plumbi, me kimikate të rrezikshme për jetën, me pesticide dhe plehra kimike, të gjitha produkte dhe nënprodukte të aktivitetit bujqësor. Në shtretërit e ujërave që përdoren për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet, në 6 pika aktive, bëhet nxjerrja e inerteve (rërë, zhavorr). Banimi relativisht i kufizuar i Bashkisë Mirditë (me prirje në rënie të popullsisë), aktiviteti i kufizuar bujqësor si dhe veprimtaria pothuajse inekzistente industriale, ndikojnë në mënyrë të favorshme, të paktën në çështjen e mjaftueshmërisë së burimeve ujore.

Në Bashkinë Mirditë, theks i veçantë i kushtohet numrit në rritjetë digave që ndeshen në të gjithë zonën. Në veçanti, me ndërtimin e digave dhe rezervuarëve në vendet ku gjeomorfologjia, gjeologjia dhe tektonika e lejojnë, bëhet përqendrimi i një vëllimi të madh uji që përdoret për aktivitete njerëzore dhe për nevojat për ujitje, furnizim me ujë, prodhimin e energjisë elektrike. Megjithatë, ekzistenca e disa digave të njëpasnjëshme, përgjatë lumit mund të ndikojë negativisht në faunën e peshkut si dhe të pengojë lëvizjen e lirë të tyre në ujë, përveç nëse janë parashikuar hapjet e duhura në afërsi të digave për të lejuar kalimin nëpër to, të një pjesë prej tyre.

Në mënyrë që të sigurohet një nivel i lartë i cilësisë së mjedisit dhe mbrojtjes së ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, propozohet krijimi i një kuadri ligjor që synon menaxhimin e integruar dhe të qëndrueshëm të burimeve ujore. Në veçanti, ky objektivi mund të arrihet përmes një sërë politikash udhëzuese:

- Programe operacionale për monitorimin e situatës (kimike, ekologjike, morfologjike, sasiore) të ekosistemeve ujore.
- Analiza e karakteristikave të secilës zonë, me vlerësimin e presioneve dhe ndikimeve në mjedisin ujor.
- Krijimi i regjistrit të zonave të mbrojtura në rezervuarët dhe basenet e lumenjve, me theks në pjesën jugore të Bashkisë.

Cilësia e ajrit



Një çështje e rëndësishme mjedisore është ndotja e ajrit pasi lidhet drejtpërdrejt me probleme të tjera serioze mjedisore. Në nivel kombëtar, Shqipëria ka miratuar vlera kufi për ndotësit atmosferikë, si me vendimin nr. 803 të lëshuar më 4 dhjetor 2003, në bazë të nenit 5 të Ligjit nr.8897 lëshuar më 16 maj 2002. Ndotësit kryesore atmosferikë që monitorohen janë SO₂, NO₂, NO_x, PM, CO.

Parashikimi total i emetimit GHG për gazrat në atmosferë paraqitet në ton CO₂ ekuivalente (CO₂-e), dhe bëhet sipas metodologjisë së Konventës së OKB-së “Konventa mbi Ndryshimet Klimatike” (UNFCCC). Performanca IFC, Standardi 3, për parandalimin dhe reduktimin e ndotjes, si edhe Kërkesa e Performancës 3 për parandalimin dhe pakësimin e ndotjes e EBRD, thekson se pragu është 100.000 ton CO₂-ekuivalente në vit për një projekt të vetëm ose zhvillimi.

Për Bashkinë Mirditë, ndotja e ajrit takohet kryesisht përgjatë rrugës kombëtare E851, në të cilën lëviz një numëri madh automjesh. Gjithashtu, ndotje serioze në ajër shkaktohet nga aksi SH30, i cili përshkon vertikalisht Bashkinë. Gjithashtu, edhe djegia e drurit (që është burimi kryesor i ngrohjes për banorët vendas) është përgjegjëse për shkarkimin e sasive të konsiderueshme të mikrogricave dhe ndotësve të gaztë, por pa qenë e mundur të bëhet një vlerësim i përgjithshëm i ndikimeve.

Mekanizmat e auditimit për pajtueshmërinë me limitet e shkarkimeve në sektorët e industrisë dhe transportit, si dhe mekanizmat e kompensimit, mund të parandalojnë një fenomen të tillë dhe të mbajnë ndotjen e ajrit në nivele të ulëta. Është i nevojshëm zhvillimi i menjëhershëm i një sistemi monitorimi dhe informacioni të pajisur mirë dhe miratimi politikave për të mbrojtur ajrin. Së fundi, rezultate shumë të mira për nivelet mjedisore të Bashkisë mund të sjellin politikat e përshtatshme, sipas të cilave qëllimi kryesor do të jetë verifikimi i origjinës së Grimcave të Shkarkuara dhe përmirësimi i Planit Kombëtar të Veprimit ekzistues, për zvogëlimin e mëtejshëm të përqendrimit të Grimcave të Shkarkuara në atmosferë. Plani Veprimit duhet të marrë parasysh gjithashtu edhe sektorë të veçantë siç janë transporti rrugor, guroret e nxjerrjes të inerteve etj.

Cilësia e tokës

Toka ka një rol si një habitat dhe shërben si një platformë për aktivitetet e njeriut, peizazhit dhe trashëgimisë dhe vepron si një ofrues i lëndëve të para. Këto funksione janë të denja për tu mbrojtur për shkak të rëndësisë së tyre socio-ekonomike dhe mjedisore.

Për vlerësimin e tokës interes paraqesin parametrat e mëposhtëm:

- Mbetjet në 105°C në total;
- Fraksionimi në sitë me diametër 2 mm me bazë të thatë në 105°;
- Metale të rënda (Al, Sb, As, Be, Cd, Co, Cr, Fe, Mn, Hg, Ni, Pb, Cu, Se, Ta dhe Zn);
- Totali i Karburanteve të Naftës (TPHs);
- Bifenile të Polikloruara (PCBs);
- Hidrokarburet aromatike policiklike (PAHs)

Mbrojtja e burimeve territoriale është me rëndësi të madhe për zhvillimin ekonomik të Bashkisë, pasi është baza mbi të cilën zhvillohet ekonomia rurale dhe pasuria pyjore. Ekskluzivisht për Bashkinë nuk ka të dhëna të mjaftueshme sasiore. Tokat e Bashkisë janë të ngarkuara me nikel (Ni) baker (Cu), krom (Cr), Hekur (Fe), Zink (Zn) dhe Manganez (Mn). Për më tepër, ngarkesa e tokës nga këto metale të rënda mund të çojë në degradimin e burimeve të ujërave nëntokësore.

Problemet në tokë janë shkaktuar edhe nga erozioni i saj, që çon në reduktimin e prodhimit bujqësor dhe zhdukjen e burimeve pyjore. Ekzistojnë disa faktorë që kontribuojnë në përshpejtimin e erozionit të tokës, midis të cilëve përfshihen ata natyrorë (p.sh. reshjet e parregullta, tokat e cekëta, pjerrësitë e larta, brishtësia e materialit të tokës) dhe faktorët njerëzorë si braktisja e tokës, shpyllëzimi etj. Një formë tjetër e degradimit është rrëshqitja e tokës, gjë që redukton ndjeshëm jo vetëm qëndrueshmërinë e bujqësisë, por edhe sigurinë afatgjatë të vendbanimit rural.

Cilësia e peizazhit

Në zonën e Bashkisë ndërhyrjet më të shpeshta të bëra nga njeriu në peizazhin natyror, të cilin e përbëjnë masivet malore dhe luginat e lumenjve, si dhe rrafshnaltat me kullota dhe sipërfaqe tëkultivuara, janë rezervuarët artificialë dhe guroret. Përveç kësaj, nxjerrjet e mëdha të inerteve nga shtretërit e lumenjve dhe strukturat shoqëruese (kantieret e ndërtimit, makineritë, etj.), por dhe digat në lumenj, sjellin ndryshime në peizazhin natyror.

Ndikimet e ndërhyrjeve të mësipërme në peizazh janë të ndryshme dhe lidhen me ndryshime në mikroklimën dhe ekosistemet ujore (digat), ndërhyrjet në reliev (gërmimet, kantieret e ndërtimit) etj.

Së fundmi, ndërhyrje në peizazh janë edhe hapja e autostradës E851, e cila ndikoi jo vetëm në territorin në të cilin kalon, por edhe në zonat fqinje, për shkak të punimeve teknike shoqëruese, por edhe për shkak të aktiviteteve që ka gjeneruar në anët e saj.

Cilësia e mjedisit akustik

Mjedisi akustik është rezultat i karakteristikave territoriale të zonës nga e cila mblidhen mostrat e zhurmës. Nivelet e larta të zhurmës janë vërejtur në zonat me popullsi të dendur dhe në akset rrugore.

Në nivel kombëtar, indeksi i zhurmës në Shqipëri është mesatar (51.25, 100 është niveli më i lartë) sipas matjeve të 2017¹⁰. Në përgjithësi, burimet kryesore të zhurmës janë autostrada, rrugët e tjera të rëndësishme, zonat me rrjet hekurudhor, zonat industriale dhe zonat tregtare, dyqanet, ndërtesat rekreative, disa objekte sportive dhe infrastruktura turistike.

Burimet kryesore të zhurmës në zonën e studimit janë për shkak të rrugëve automobilistike kryesore, siç është autostrada evropiane E851 e cila kalon përmes Bashkisë, dhe që fillon nga Mali i Zi, kalon Shqipërinë e veriut dhe përfundon në

¹⁰ www.numbeo.com



Kosovë, si dhe rrugët e tjera të Bashkisë (rrjeti rrugor kryesor dhe dytësor). Përveç kësaj, në qytetin Rrëshen (selia e Bashkisë), zhurma karakterizohet nga një nivel mesatar në të lartë në një pjesë të madhe të tij, për shkak të tranzitit të akseve kryesore rrugore, ndërsa në pjesën tjetër të tij lëvizin nga niveli mesatar në të ulët, për shkak të përqendrimit të shërbimeve, dyqaneve, zonave rekreative me nivel të ulët të ndotjes etj. Raste të izoluara të ndotjes, përbëjnë guroret dhe zonat e minierave, apo industrinë e tjetra të rënda, e cila zakonisht gjendet larg zonave të banuara.

Meqenëse burimi kryesor i ndotjes së zhurmës është rrjeti rrugor, drejtimet e përgjigjeve të pyetorit janë të përqendruara në këtë drejtim. Trajtimi i problemit të zhurmës mund të realizohet me ndërtimin e një lloji asfaltimi specifik dhe me vendosjen e barrierave për mbrojtjen nga zhurmat, por edhe me mbjelljen e një bimësie të përshtatshme. Pra, nëpërmjet ndërhyrjeve të lehta, emisionet e zhurmës pritet të reduktohen në të ardhmen.

1.7. Ndryshimet mundshme të sistemeve

Duhet të kuptohet se strategjia e propozuar territoriale, e cila ka si objekt kryesor zhvillimin e qëndrueshëm të bashkisë dhe që do të zbatohet përmes një sërë projektsh dhe veprimesh të propozuara (plani i veprimit), do të rezultojë në një ndryshim të sistemeve ekzistuese territoriale (bujqësor, natyror, ujor, urban dhe infrastrukturor) siç përcaktohet në VKM Nr.671, datë 29.07.2015 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit". Ky ndryshim është i dëshirueshëm dhe shpesh i nevojshëm, pasi synon:

- mbrojtjen e mëtejshme të mjedisit (natyror dhe kulturor) dhe të peizazhit
- shuarjen e konflikteve dhe sigurimin e përputhshmërisë dhe vlerësimin e përdorimit të tokës
- sigurimin e infrastrukturës teknike që është i nevojshëm për të hequr ose kufizuar situatat negative që janë krijuar
- përmirësimin e kushteve të jetesës dhe punës për sigurimin e një niveli të lartë për të gjithë popullsinë, i cili pritet të rritet gjatë 15 viteve të ardhshme.

Këto ndryshime në sistemet territoriale (shih Tabelën 1.7.1) mund të ndodhin si për shkak të projekteve/veprimeve të propozuara ashtu edhe prej angazhimeve institucionale që rezultojnë nga legjislacioni i përgjithshëm ose ai i specifik. Kufijtë dhe pozicionet e ndryshimeve të mundshme janë treguar në hartën U06. Përfundimi i tyre do të thellohet më tej në fazën e tretë përse i përket organizimit përfundimtar të territorit të Bashkisë dhe përcaktimin përfundimtar të kushteve të zhvillimit.

Në mënyrë të veçantë, bazuar në vendndodhjen kyç të Bashkisë dhe me miratimin e udhëzimeve të PPK, propozohen infrastruktura të reja teknike me rëndësi kombëtare përgjatë rrugës E-851: vijë hekurudhore dhe stacione pasagjerësh, tregtarësh dhe gazsjellësi IAP. Bëhet fjalë për ndërhyrje afatgjata dhe komplekse të një periudhe të gjatë kohore, të cilat do të finalizohen pas një sërë studimesh të specializuara. Kështu,

përcaktimi i tyre dhe vlerësimi i ndryshimeve, që do të krijohen, bëhen vetëm në nivel paraprak dhe nuk është definitiv.

Ndërhyrje të rëndësishme, kryesisht me rëndësi lokale, janë propozuar për zonën rreth qendrave urbane Rrëshen dhe Rubik, të cilat janë qendra të rëndësishme në sistemin kombëtar të banimit dhe nyje kryesore të zhvillimit lokal. Kështu, përcaktohen zona për akomodimin e njësive industriale dhe komerciale dhe propozohen infrastruktura kritike teknike mjedisore (impiante të trajtimit të ujërave të zeza). Megjithatë, për këtë qëllim do të bëhet një përpjekje për të shfrytëzuar zonat jo aktive ose të mbingarkuara pas rizhvillimit të tyre.

Ka të ngjarë të rezultojnë ndryshime të kufizuara në kufijtë e zonave urbane, për shkak si të racionalizimit të kufijve tashmë të miratuara në bazë të VKM Nr.5, datë 29.12.2014 ashtu edhe për shkak të përcaktimit të kufijve të zonave ekzistuese (me ndërtime të dendura apo të rralla) që u treguan si vendbanime apo vende ekonomike dhe nuk disponojnë kufi.

Bazuar në sa më sipër, vlerësohet një rritje e vogël e sistemit urban dhe infrastrukturor.

Për sa i përket tokës bujqësore, propozohet forcimi i produktivitetit dhe rentabilitetit përmes ndërtimit të infrastrukturës mbështetëse (p.sh. rezervuarëve) në bazë të një strategjie të integruar.

Në lidhje me rrjetin hidrografik, objektivi është ruajtja dhe mbrojtja e trupave ujorë sipërfaqësorë.

Së fundi, në sistemin natyror propozohet, nga njëra anë, shtrirja e statusit të zonave të mbrojtura në disa zona të reja, zbatimi i planeve praktike të menaxhimit, dhe nga ana tjetër, zhvillimi i aktiviteteve rekreative alternative dhe infrastrukturës së kufizuar, me konstruksion parafabrikatë të lehtë, me qëllim rritjen dhe promovimin e ekoturizmit në zonat me monumente të mbrojtura.

Sistemi Territorial	Sipërfaqja e vlerësuar pas aplikimit të projekteve të propozuara (përqindja %)	Ndryshimi (%)
Sistemi natyror	90,47	-0,08
Sistemi ujor	1,28	0
Sistemi bujqësor	6,21	-0,28
Sistemi urban	1,19	0,92
Sistemi infrastrukturor	0,86	10,72

Tabela 1.7.1: Sistemi Territorial pas aplikimit të projekteve të propozuara

Për zbutjen dhe kufizimin e ndikimeve të mundshme negative nga ndryshimet e mundshme në sistemet territoriale, do të parashikohen masa të përshtatshme dhe do të jepen udhëzime përkatëse në fazën e ardhshme. Sidoqoftë, ndërhyrjet e propozuara,



strategjitë dhe rregulloret e propozuara të PPV do të vlerësohen nga VSM që do të hartohet në vazhdimësi. Së fundmi, theksohet se legjislacioni aktual parashikon kontroll mjedisor dhe liçensim të projekteve para zbatimit të tyre.



2. PLANI I VEPRIMEVE STRATEGJIKE/ PRIORITARE DHE PROJEKTET PILOT TË ZHVILLIMIT

2.1. Plani i Veprimit

Për mbështetjen e vizionit dhe zbatimin e objektivave strategjike propozohet Plani i Veprimit me projekte dhe veprime konkrete që konsiderohen të nevojshme dhe do të mbështesin zhvillimin e bashkisë gjatë 15 viteve të ardhshme (2018-2032). Ky është një program kuadër në të cilin do të bazohet hartimi i listës vjetore të prioriteteve, por edhe programet afatmesme të Bashkisë. Krijimi i këtij rrjeti koherent të projekteve bazohet:

- në përfundimet e analizës, sikurse u vlerësuan dhe u dokumentuan duke përdorur metodën SWOT, të cilat u paraqitën më lart,
- në rezultatet e konsultimeve me të gjithë aktorët, shërbimet e Bashkisë dhe banorët dhe sipërmarrësit e bashkisë,
- në planifikimin aktual afatshkurtër dhe afatmesëm të bashkisë, siç pasqyrohet në vendimin e Bordit Drejtues për miratimin e Listës së investimeve prioritare për vitin 2017 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2018-2020.

Projektet/veprimet ndahen në tre kategori bazuar në rëndësinë dhe fushëveprimin që pritet të kenë: lokale, ndër-komunale/ndër-rajonale dhe kombëtare. Disa janë përzgjedhur për t'u realizuar si projekte pilot, pasi ato mund të veprojnë si katalizatorë të rritjes, me një kosto të ulët dhe ndikim të lartë. Gjithashtu, projektet e propozuara gjenden në një fazë tjetër të zbatimit dhe kanë një shkallë të ndryshme të pjekurisë.

Në Tabelën e mëposhtme përshkruhen të gjitha projektet e propozuara të ndara në kategori të përgjithshme dhe duke iu referuar një sërë informacionesh si më poshtë:

- kodi
- titulli, aksi i prioritetit në të cilin është integruar projekti. Një projekt mund ti shërbejë më shumë se një prioriteti.
- Buxheti i vlerësuar. Si bazë për vlerësimin e tyre, u përdorën projektet sipas studimeve të fundit në bashki, projektet e ngjashme në territorin shqiptar dhe eksperiencia e bashkisë dhe Qarkut në investime e projekteve. Theksohet se kostoja është treguese, pasi nuk mund të bëhet një vlerësim i saktë i saj në kuadër të këtij studimi, si projekt ide, përveç rasteve ku ndonjë ndërhyrje është në një fazë të pjekur dhe bashkia apo institucioni kompetent kanë përparuar tashmë në parashikimin e buxhetit bazuar në draft projektet apo projektet finale të hartuara sipas burime të mundshme të financimit. Si bazë për vlerësimin e financuesve u konsideruan praktikat, mundësitë aktuale dhe planifikimi i bashkisë. Vlen të theksohet se lista e burimeve të financimit nuk është e plotë, por përmban vetëm burimet kryesore.




- institucioni me përgjegjësinë kryesore, kompetencën për planifikim, hartim dhe zbatimin e ndërhyrjes. Në shumicën e projekteve, të cilat janë në kuadrin lokal, kompetencën e ka vet bashkia, si palë e interesuar drejtpërdrejtë.
- prioritetet e zbatimit, të ndara në katër periudha (në përputhje me databazën e RIT).
- tregues për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të ndërhyrjeve.
- vlerësim për nevojën e ndryshimeve institucionale dhe ligjore.
- burime njerëzore, në nivel të organit kompetent, i cili do të ngarkohet me planifikimin, hartimin dhe zbatimin e ndërhyrjes. Nisur nga fakti se përgjegjësinë primare për shumicën e projekteve e ka Bashkia, siç edhe u përmend më lart, personeli i bashkisë është ai që do të kryejë realizimin e pjesës më të madhe të këtij Plani Aktivitetesh(Veprimi).
- vërejtje të përgjithshme që nxjerrin në pah veçoritë specifike ose shpjegojnë përmbajtjen për pjesët plotësuese të veprave.

Vërehet se Plani i Veprimit shërben dhe mbështet planifikimin strategjik në kontekstin e zhvillimit të qëndrueshëm. Është e qartë se përveç kësaj ekzistojnë një sërë projektesh dhe veprimesh që kanë të bëjnë me punën e përditshme të bashkisë, shërbimin e qytetarëve dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës, e cila nuk është përfshirë në Planin aktual.

Bashkia mund të modifikojë Planin e Veprimit për të përshtatur veprimin e saj me realitetin në ndryshim të vazhdueshëm, duke marrë parasysh mundësitë dhe kufizimet e reja. Megjithatë, rishqyrtimi i tij propozohet të jetë i dokumentuar dhe të bëhet një herë në vit kur hartohet programi buxhetor vjetor.

Plani i Veprimit është një mjet shumë i rëndësishëm për funksionimin e brendshëm dhe të saktë të bashkisë dhe në të njëjtën kohë, përbën një mjet zhvillimi, përmes të cilit mund të kërkohen fonde dhe investime dhe ndihmon pjesëmarrjen e saj në skema (PPP) dhe iniciativa investimesh.



Kodi	Titulli i Projekteve	Përfshihet në akset e prioritetit me numër	Nësitë administrative që i preket	Buxheti i nevojshëm	Burimet e mundëshme të financimit	Përgjegjës për zbatimin	Burimet njerëzore	Prioritet				Treguesi për matjen, monitorimin e zbatimit	Ndryshimet e nevojshme institucionale dhe ligjore	Shënime
								I: '18	II: '20	III: '21- '27	IV: '28- '32			
Rigjenerim dhe sisteme urbane														
